

EQREM ÇABEJ

## STUDIME RRETH ETIMOLOGJISË SË GJUHËS SHQIPE XVII

## P

**për**, parafjalë, prefiks e preverb. Boppi (f. 503v). është'i pari që rrethshkroi përdorimin e saj si parafjalë e si element formativ përbrenda shqipes e në rendin indoeuropian, dhe që caktoi edhe afërinë e drejtë të saj, kryesisht me ind. e vj. *pári* «rreth e rreth, shumë, përtej, përreth» e me gr. *περί περί* «përreth, krejt, përtej». Kështu edhe Kamarda I 320 v. G. Meyeri ka ndruar mendim disa herë për burimin e fjalës. Në fillim (BB VIII, 1883, f. 189) shihte aty një fjalë të trashëguar, e afër me fjalët inde e greke, me lat. *per*, umbr. *per* etj. Më vonë (1888), në AG e në Gr. Gr. I § 62, e spiegon nga lat. *per*. Poashtu dhe te EW 332 (1891), vetëm se këtu krahas me *për-* in e burimit latin pranon dhe një *për* të vetë shqipes, e afër kjo me fjalën latine, e përbrenda shqipes dhe me *prej pej pe*. Te mendimi i përparmë i burimit autokton kthehet ai në AS III 30, studim i vitit 1892. Burimi latin pëlqehet te Meyer-Lübke Gr Gr. I<sup>2</sup> 1057, te Puçariu EW 1293 e te Weigandi 68. Po e kundërshton ndërkaq Pedersen (Rom. Jber. IX I 213), duke gjetur përsëri një fjalë të gurravet autoktone. Ky gjykim është bërë sot pothuajse i përgjithshëm: Boisacq 772, Walde-Pokorny II 30, Walde-Hofmann II 284, Pokorny I 810, Hofmann GEW 264. Khs. dhe Philippide II 650 e Tagliavini 213 v. Edhe Jokli (IF 37, 108 v. e 113, Zbornik Belić 70, Reall. d. Vorgesch. I 89, Streitberg-Festgabe 180, WuS XII 89 v.) gjen te *për* një fjalë të fondit të trashëguar të shqipes, po refleksin jo të një parafjale të vetme, po të indoeur. *per*, *peri* e *pro*; këtë të fundit ndër të tjera te *përdhé*, *përdhesë*, *përpósh*, *përanë pranë*, *përbri*, *përderës*, *i përfushtë*, *përgjáj*, më fort me funksionin e afërsisë, afërisë e krahasimit, si te *i përthjermë* «si i përhimë» krahas me *i thjermë*; me këto funksione e krahason *për-*in me trak. -dak. *pro-* në emrin e bimës *προπέδιλα* «Potentilla reptans» (:«bimë rrëshqanëse për tokë») e me sllav. *pri* si në çek. *přičernalý* «si i zi, ziosh», *přičervenálý* «i kuqërrem», rus. *pričernъ* etj.

E mbarë gjuhës. Sikundër e kemi treguar dhe në BSS 4(1955) 113 vv., është një nga ato parafjalë të shqipes që përdoren me më se një rasë, kjo konkretisht me tri rasa: kallëzore të pashquar e të shquar, «vendore» e rrjedhore: Buzuku (XIII e shpeshherë; XXXVII, Isaia 60, 4; IXL, b, Oratio: LVIII/2, Gjoni 11, 19; LIV, Danieli 13, 22 e 26) *për jetë të jetësë* «in saecula saeculorum»; *e bijatë e tū vinjënë pr anë tande* «et filiae tuae de latere surgent»; *përse na qi për të dërejtë për katetë tonë na jemi munduom* «ut qui iuste pro peccatis affligimur»; *E shumë n Xhudhishit ishnë ardhunë... , ata me i ngushlluom për të vëllat* «Multi autem ex Iudaeis venerant... , ut consolarentur eas de fratre suo»; *U për gjithë enëshit jam ngjëruom me të idhunë* «Angustiae sunt mihi undique»; *rynë për deret mbrapa* «irruerunt per porticum»,

khs. dhe për së dytë, për së largu, përsëriu te ky autor si edhe gjetkë, forma që te së-ja e tyre ruajnë shenjën e rrjedhës, tosk. *për së ligu*, te G. Meyeri 97 për *s'esull*, që është = rum. *pe nemincate*. Te përdorimi lokal, kauzal e instrumental: *Bafshinë ujënatë shpirtëna të gjalla e shtansë qi të fluturonjënë për qiell* «*Producant aquae reptile animae viventis, et volatile super terram sub firmamento caeli*»; e i *dërgou kā dy e kā dy përpara vetëveti për gjithë qytet e për gjithë vise qi aj kish me votë* «*et misit illos binos ante faciem suam in omnem civitatem et locum, quo erat ipse venturus, E ju t inishpūm përpara regjënjet e përpara zotënviet për muo*» «*Et ad praesides ed ad reges ducenimi propter me*», *porsī kle fjala e Tinëzot, qi kish folë për Illinë* «*iuxta verbum Domini, quod locutus fuerat in manu Eliae, secondo la parola che il Signore aveva detto per mezzo di Elia*» (LIX/2 = LXIX/2, Gjenezë 1, 20; LXXXII/2 = CII/2, Luka 10, 1; poaty, Mateu 10, 18; XLVII/2, Mbretërit III 17,16) ndihet te ky shkrimtar ndikimi i teksteve latine e italiane, me gjithë se duhet thënë që përdorimi lokal e kauzal nuk është i huaj për shqipen, khs. *për trolli, për tokë, për dhë, për fundi*, dibr. *përkiet* (për kryet) «*lart, në majë*» e *për punë të tij* «*për shkak të tij*», *mos të të vijë keq për këto fjalë*. Budi (DC 59 v., 61, SC 7,8) e *me e ditunë për zot, e për krijuos, e për të parë; ...e marrë ndëpër gojë mā të shumënë ...për kafshë të mbrasëta, se për kafshë të mira...; i denjë për ndonjë pagëtyrë; janë për të vum roe e për të ditunë se janë për një të madh gazimend e ngushëllim*. Bardhi *Per Për, Per medium Për gjymsë, Per caput meum Për kryet tem, Per Deum Super Caelos Per Tenëzonë bë(?) Qiellt, Peregre Prudhë, Perennis Për gjithë jetët, Perflare Me frým për gjithë, Perfugere Me ikunë për dimë, Pergere Me votë prudhë, Perpetim Për jetë, Persalutare Me u falunë pr emënë gjithëve, Perscindere Me e prēm për gjysmë, Pertrahere Me e hjekunë për mbrapa, Pervertere Me e këthyem përfundit e përsipëri, Pro Për, Pro te Për tÿ, Propter Për, Propterea Prashtu, f. 203 Për bukët, e për krypët* «*Per panem, et salem*», *Për venët gjë pīmë* «*Per vinum quod bibimus*», *Për kryet e Perëndisë* «*Per caput Imperatoris*», *Për shpatët qi bānj* «*Per gladium quem adhibeo*». Bogdani (I 55, 1; 102, 21) *jo për volëndetë nierëzet anshtë kjanë dhanë Profetia* «*Non voluntate humana allata est aliquando Prophetia*»; e *njofti Davidinë për zānë* «*e conobbe David per la voce*». Për përdorimin e fjalës si parafjalë sh. sidomos Pedersen 176, FGS, tani sëfundi Xhuvani SF XVIII(I) 1, 1964, 44 vv.; për disa funksione me karakter ballkanik Sandfeld 138, 191 shën. 2. Për përdorimin si prefiks në emra, mbiemra, ndajfolje, parafjalë e lidhëza, e si preverb, sh. Xhuvani-Çabej BSS 4(1956) 88 vv.; khs. dhe *prandaj, pranë, prashtu, pse*.

Për etimologjinë do thënë se afrimi me ind. e vj. *pári*, gr. *πέρρι*, *πέρρι*, lat. *per* etj. që bëri së pari Boppi, mbetet i drejtë. Ndërkaq ka shumë të gjarë dhe mendimi i Joklit. që te *për* përveç *-per-it* të ketë përfunduar dhe ndonjë tjetër parafjalë indoeuropiane, e veçanërisht *pro*. Në këtë drejtim duket të dëshmojë edhe *prej* (sh. këtë). Trajta *prë* që ka *për* në shqipen e Greqisë, si parafjalë dhe si prefiks e si preverb (*prë, prëshkonj* etj., sh. dhe Kamarda I 321 e G. Meyer AS V 98, khs. edhe *prëcónëzë*), është vështirë të thuhet nëse paraqet reliktin e një të tille trajte të moçme që pat nisur me *pr-* (*pro, pri* etj.) apo një zhvillim sekundar.

**picërr** «i vogël nga shtati», *picërró* «zvogëloj a mbledh sytë nga dielli ose nga gjumi; vjedh shpesh e nga pak». G. Meyeri 341 e afron me grupin roman it. *picciolo piccino* «i vockël» sard. *piccioccu* «kalama» etj., dhe konkretisht e nxjerr prej ven. së vj. *pizzolo* friul. *pizzul* «i vogël»; aty ai vendon dhe *pëci* «kacan» bashkë me abstraktin përkatës *pëcillëk* që gjinden te Rossi; *picá* m. «kalë i vogël, kalush» (te Mitko) ai e spiegon nga gr. e mesme *πικρός* «herr». Ky spjegim i *picërr*-it prej gurrave romane pranohet te Meyer-Lübke REW 6550.

Hyn në një grup të tërë fjalësh, kufitë e të cilit ndërkaq është vështirë të caktohen më prerë: Luma ka *pic* m. «majë» (ER, Manni), Kavaja *picë* f. «vajzë e vogël» (Kristoforidhi), geg. veriore pas Bashkimit përveç i *picërr* «piccolo» edhe emrin *picërr* f. «shkëndijë e vogël» me verbin *picërroj* «zvogëloj», pastaj *picrrák* m. «Salamandra» (Salamandra maculata, pikëlore), pas Cordignanos me *picatë* «me vjedhë me pakicë, me brace», pas Gazullit *picël* f. «nji të ngulun gjylpane» me *picëlim* *piculim* m. «të qendisun t'imë; të veshun me shije» e *me picëluë*, *me piculuë* «me veshë petka të zgjedhme», *me picërruë* «me vjedhë kah pak e shpesh», *picórr* fem. *picorre* «voglak, voglar, fëmi i vogël» e *picû-ni* m. «miclim, kërthi sa i lëm, i vocërr fort» pas Mannit Dibra *picerroke* f. «sledge, sajë»; le të shtojmë dhe *picërruk* *picërruk* fem. -uke «i vockël» të geg. popullore. Në pikëpamje etimologjike është vështirë të mendohet që një grup fjalësh me përhapje kaq të madhe e me kaq degëzime trajtash e kuptimesh ta ketë burimin e tij në ven. *pizzolo*. Kemi të bëjmë me një trajtë bazë *pic-*, e cila te *picërr* paraqitet e zvogëluar me -ërr (si p.sh. *kokërr*, *i vocërr*), te *picël* me -(ë)l, -lë (si te *zogël*, *pikël*), te *picórr* me -orr (*kotórr*, *kaçórr*); *picërr* vetë te *picrrák* është zgjeruar më tej me -ak, te *picerroke* me -ok fem. -oke (si *bardhók*, *madhók*), te *picërruk* me -uk (*marrúk*, *majúk*), te *picû* me -û (si te *kalbû*, *koshû*); sh. për këto formante Xhuvani-Çabej Prapashtesat 42, 65v., 79, 10vv., 72v., 99, për -û Gazullin f. 36. Kuptimi i bazës *pic-*, në të cilën bashkohen këto fjalë, gjan të jetë diçka si «majë, majuk, pikë»; këtë na e tregon nga një anë *pic* «fund, majë» e «grimcë» te Manni, pastaj emrat topike *Picâr* në Jugë e në Veri, *Picrragë*, *Picáll* pranë Petrelës, *Kodra e Picallit* etj. (Seiner 96, A Gazetteer of Albania, 1946, f. 130), nga ana tjetër *picrrák* «Salamandra» dhe *picërr* «pikalosh» (*zog picërr*, *pulë picërr*) te FGS. Aty duket se hyjnë dhe mbiemrat e ndajtojvet e përngjitura me *pic-* të gegërishtes, si *picërrgatë* «i hollë e i gjatë» (*kumbull picërrgatë*) e *picërrmáj* *picërrmájthi*, *picërrngul* *picërrngulthi*, me variacion *picá*-*picërrngulthi* (sh. për këto Xhuvani-Çabej BSS 4, 1956, 90), në të cilat *picërr* u muar si formant më vete duke u shkëputur prej trajtash së tjera si *picërruk*, ku u ndie (gabimisht) si *picërruk*. Aty duhet të hyjë, si një formë me ndrim c:z, edhe *picërr* f. «grimë e vogël qi s'shifet a mezi shifet me sÿ, atomon» e Gazullit, një deminutiv më -lë dhe si e tillë e barasueshme me *picël* që u dha më sipër. Kjo trajtë bazë *pic-* e dëshmuar kështu në leksik e në toponimi, si një «krijim elementar» në kuptim të W. Oehlit, është e afrueshme me *pits-* «majë, sqep» të gjuhëve romane, it. *pizzo* «majë, sqep, mjekër me majë» *pizzicare* «me piskue» (sh. *piskoj*), engad. *piz pizza* «majë, majë mali», romak. *pizzarda* «shaptore» etj., për të cilat sh. Meyer-Lübke REW 6545, Migliorini 421. Veçanërisht nga fusha e rumanishtes do afruar për krahasim *pitigoiu pitiguş* «Parus maior, çinërr» te Meyer-Lübke REW

6494 e te Puşçariu EW 1304. spiegimi i të cilës nga it. *pizzicare* te DLRM 622 nuk na duket i goditur. Po nga ajo gjuhë mund të hynte aty dhe *pitârâu* «kalama që vete derë më derë natën e kolendrave», të cilën DLRM 622 e bie të ardhur -a me të drejtë? -prej magj. *pityergö* «cicërues». Me shq. *picërr* e *picërrúk* *picirúk* afrohet ndërkaq sidomos gr. e re *πιτσιρίκος* «kalama i vogël», një fjalë të cilën Andriotis 193 nuk na duket se e spiegon mirë nga it. *pisciare* «përmjerr». Edhe ajo fjalë, ashtu si fjalët e rumanishtes, do të ketë një «afëri elementare» me shq. *picërr*, *picirúk* etj. — në qoftë se nuk është drejtpërdrejt një huazim i greq. së re prej shqipes. — Pas G. Meyerit 341 kal. *pic* «sqep» rrjedh drejt it. -kal. *pizzu* «majë, sqep»; dhe pas Lambertz-it KZ 53,305 *picari* «një zog» në Molize buron po prej asaj fjale dialektore t'italishtes, lat. mesjetare *venerunt aucelli... habebant pizum e grifes, qui habebant pizos*.

**pikë** f. «cirkë, gjerbë e shtëpisë; apopleksi; pullë e vogël e me tjetër ngjyrë në një pëlhurë, një shami etj.; pikël a shenjë në fytyrë, shpeshherë pas ndonjë sëmundjeje si lia: *pikë lie*; shenjë pikësimi; shenjë mbi zanoren i o mbi ndonjë tjetër zanore»; *pikó* «stërpik», intrans. *më pikojnë djersët, pikon shtëpia*; *pikohem* :mos u piko «mos u bë, mos u ndy me pika»; *stërpik*; *stërpik* m. «bilashnjok, pinjuell, filiz» (edhe figurshëm); *pikëlór*, në Greqi *pikëluar* «me pika-pika». G. Meyerit (f. 337, Alb. Studien IV 108, V 98) e bashkon përbrenda shqipes me *pik* «hidhëroj, pikëlloj», *i pikët* «i hidhëruar; i idhët», *njeri i pikur*, *pikëlló* «hidhëroj shumë, helmoj» *pikëllim*, e me *shpik* «bëj një shpikje, trilloj, shpif», e më tej e afron me grupin roman it. *piccare* «me therë, me shpue», span. prov. port. *picar* frgj. *piquer* «me therë, me thumbue» se *piquer* «me u fye», rum. *pic* «pikë, cirkë» *un pic* «një çikë, pakëz», *pică* «aigreur, animositë» arom. *chicu* «pikoj»; për *pikë* «apopleksi» ai krahason me të drejtë turq. *damla*, serbokr. *kap kaplja*, it. *gota* frgj. *goutte* me të dyja kuptimet, etj.; *pikún* m. «majth i hekurt» të shqipes së Greqisë ai e spiegon prej it. *piccone*. Pokështu gjykon për *pikë* edhe Weigandi 69, i cili me të drejtë afron me *pikë* edhe *pikrrón* «pikon shi, bie shi me pika të mëdha e të rralla». Tagliavini 221 jep prej Borgo Erizzos *me pik* «gocciolare, trapelare», *vena po pikën* «il vino gocciola», dhe parapëlqen një afrim me grupin roman rum. *pic* «pikë», *pică* *picura* «me pikue», it. *piccolo* «i vogël» *piccino* «i vockël» vegliot. *petzla* «pikon» etj. Khs. dhe Puşçariu EW 1304, 750, Battisti 67.

Fjalë e mbarë gjuhës. Budi (DC 178a) *thuose u bie pikë*; Bardhi Gut(t)a, *goccia Pikë*, Guttatim *Pikë-pikë*. Është bërë shumë pjellore në gjuhë. Prej verbesh khs. *pik* «zë vrimën e një ene me kallaj», *pik shtëpinë* «zë pikat e çatisë», intrans. *pik shtëpia* «pikon shtëpia», *pikás* *pikata* «stërpik», *të pikat era* «të pret era». Prej emrash, mbiemrash e ndajfoljesh *pikël* f. «pikë e vogël; njollë a shenjë e vogël rrotullare mbi lëkurë a mbi një stofë» bashkë me *pikëlór* *pikalór*, *i pikëluar*, *pikalásh*, *pikalí*, *pikalósh*, *i pikalosur*, *pikalarmë* «me pika në fytyrë (për njerëz) a në trup (për shtazë)», *pikëlore* f. «*Salamandra maculata*» e *pik(ë)lój*, *po piklon shi* «po rignon shi i hollë», te Gazulli ka *piklue kështëja* «i kanë rënë frytet kokrra-kokrra», në të *piklofte gjá në dorë, me bán me dijtë*; emri *pikës* m. «ai që pik enët, teneqexhiu», *pikësore* f. «dërrasë kalorë», *ra pikëgjáll* «ra e vdiq aty për aty, mbeti pikë në vend». Si kompozite khs. edhe *peshk pikakúq* «koran», *pikërenë* (mallëkim). Neologjizma janë *pikërisht*, *pikësim* m. e kompozitet *pikënisje*,

*pikëmbërritje, pikëmbështetje, pikëpamje, pikëpresë, pikëpyetje, pikësynim, adverbij pikësëpari. Shprehja e pikuar nga qielli «e bukur shumë» del që te Bogdani (II 7, 7); jo possikur t'ish kreatyrë e shekullit, po pikunë n'qiellshit për mrekullë gjithëkuj ta soditën «non come se fosse creatura mondana; ma discesa dal Cielo per miracolo, à chiunque la mirasse»: pikoj, pik për «zbres nga qielli», prandaj e afër me arom. *chicat di cer. rum era frumoasă de pică*, interpretuar jo drejt te Pușcariu EW 1304, khs. rum *a pica* «a cadea» te Pușcariu Limba română I 202. Në lidhje me këtë le të shënohet se te V. Stratigoi nga Lungri i Kalabrisë (sh. Ferrari-Kamsi, Bul. i Univ. Shtet. të Tiranës, Seria Shk. Shoq. 1, 1959, 88) *pika* është «rrufeja».*

Kjo fjalë gjen vendin e natyrshëm të saj në përbrenda shqipes si një postverbal i *pjek* «takoj; prek, çik, qok (dorën)», *përpyjëk* «godit pas një sendi të fortë», *përpiqem* «ndeshem, has; sillem me trup andej e këndeje nga dhimbjet, përpëlitem; mundohem, orvatem, rropatem, bëj çmos». Si e vuri re Pederseni (f. 178) mbi dëshminë e çam. *j u poq filxhani për dheu* «ἐκτυπήθηκε», *poqi këmbën, dorën, kokën* «përpoqi, vrau», kuptimi i parë i këtij verbi është «godit, i bie». Sidomos në dialektet shqiptare të Greqisë ruhet ky kuptim: *poq dérënë* «i ra derës». Aty *pjek* përdoret edhe për «pikoj»: *Ljakoje s'e mbaj fare shinë, po e vij tuti mbërda. Piqej nga tuti méretë* «Ἔσταζε ἀπ' ὅλα τὰ μέρη»; *Shtëpia nga të pjekuritë ish bënë pelk* «Τό σπίτι ἀπ'τό στάξιμο εἶχει γίνει λίμνη»; të tjera shembëlla sh. te *pjek*. Kështu *pikë* ka dalë nga *pjek* «godit, i bie», poashtu si gjerm. *Tropfen* «pikë, gjerbë» nga *treffen* «godit, i bie». Morfologjikisht *pikë* është një zgjerim i *pjek* me sufiks -ë, i shpeshtë në postverbale, e me monoftongim të *je-së* në *i*; khs. *pritë: pres, dergjë: dergjem, veshë: vesh*; për *je: i sillë: sjell, rrip rryp: rjep*. Rum. *pic pică* me arom. *chică* rrjedhin prej shq. *pikë*, me të cilën piqen në kuptim, sh. dhe Papahagi 600, 840. Prej shqipes dhe *pika* «tache» e Sarakaçanëve, Höeg II 185. — Me *pikoj* me gjalpë përsipër (petët e një hullimi a të një tëmble) mund të gjejë spjegimin gr. *πικέριον* «gjalpë». Khs. për këtë Bul. i Univ. Shtet. të Tiranës. Seria Shk. Shoq. 4 (1962) 127 e 143, Sh. Alb. I 1. 81. — Sh. edhe *pjekë-t*.

**pilás-të** mpl. «qerpikët e syve». E jep Pederseni 177 për anët e Çamërisë, po pa spjegim etimologjik. Kuptimi i parë «qime». Shumësi *pilas* (me -as) paravendon një *pil* si formë të mirëfilltë të fjalës. Kjo nga gr. e re (ose e mesmja) *πίλο* «lesh i rrahur për plisa, plis». Jo i pamundur ndërkaq një burim latin, nga *pilleum* «plis». Një nga ato fjalë të shqipes, për të cilat nuk mund të ndahet mirë a burojnë prej greqishtes a prej latinishtes, Sh. për to Rev. de Ling. VII 1 182 vv. Përyjash-tohet një burim nga lat. *pilus*, për punë të karakterit jo-velar të likuidës në *pilas*. Përyjash-tohet gjithashtu çdo burim prej rumanishtes (aromunishtes), sepse këtu refleksi i lat. *pilus* është me -r-.

**pilë** f. «dy arra një mbi një, a tri arra dhe një përsipër, me të cilat lozin kalamanjtë»: *i vuna pilë* «cip mbi cip», *i vuna paret pilë* «i vuna turrë» (Tiranë); «majë, naltësi; faqe mali», si adverb «për së kithi; tërthori»: *ka marrë malin me dy pila; kopshti im vjen në pilë e jo shesh; mos i bjerë drejt, po bjeri pilë*; në Seman *ballona ngrihet pil* «pjerrët», J. Thomaj, Bul. i Univ. Shtet. të Tiranës. Ser. Shk. Shoq. 4 (1961) 150; *prerë pil* «coupé en biseau»; tra që i vihet murit për së gjati e që shërben për mbështesë për trarët që vijnë tërthori, në Curraj

t'Epër «trarë të mëdhenj me të cilët ndërtohen urat e drunjtja»; «brez muri»; *e ndbqa (i gjimova) pilë më pilë* «këmba-këmbës, gjurmë më gjurmë»; *pilój* «vë pilë, vë grumbull»; *i pilohem* «i vihëm mbrapa, i gjimoj, e ndjek pilë më pilë»: *piloju përmbropa*. Në Dibër të Madhe *pilas* adv. «plot e përplot», në Malsitë e Shkodrës *pil'e për majë* po me atë kuptim. — Mungon te G. Meyeri. E ka sëpari Kristoforidhi e Bashkimi, po te ky *pilój* jepet për «mettere l'un dietro l'atro, (metafor.) disordinare, avventarsi dietro uno per arrestarlo», kjo e fundit, si duket, për *i pilohem*. Me *pilë* lidhet pas gjase dhe *pilcë* f. «lloz», te Bashkimi pl. «stecchi coi quali si sostiene la pietra sollevata per prendere uccelli», me verbin *me pilcue* «me qitë, me vù pilcën; me qitë nënkambëca, me bâ pusina, me veprue tinëz kundra dikuj»: *desht me më pilcue, po iu kujtova*, e me emrin abstrakt *pilci* f. «veprimi i pilcimit, nënkambëca», *me bâ pilcina* «me veprue tinës për sherr të dikuj, gjerm. Heimtücke, it. perfidia» te Gazulli; *pilcë* me sufiks -cë të geg. veriperëndimore, që përfaqëson -zë-në e gjithmbarshme. Etimologjikisht *pilë*, për punë të l-së palatale të saj, nuk mund të rrjedhë prej lat. *pila* «shtyllë, këmbë», po rrjedh prej it. *pila* «colonna di molti oggetti sovrapposti», *una pila di libri*. Në këtë drejtim flet dhe përhapja dialektore e fjalës, që është e gegërishtes, sh. për këtë kriter Rev. de Ling. VII 1 175. Një me atë është dhe *pilë* «kazan o enë e ujit të bekuar»: *e urdhnoi drejtin të hyjë në pilën e ujit të shenjtë që kishte sjellë prifti për kungim* (Bleta 1944, Nr. 5, f. 8), nga it. *pila* (dell'acqua santa). Fjala italiane ka hyrë në shqipen edhe një herë tani rishmë, si term i elektricitetit, *pilë elektrike*. M'anë tjetër *pille* f. «pilë, brez muri, e çilmja e murit ndër-mjet brezit e gërshanëzavet; hatull» që jep Gazulli për Pukë e për Spaç, me l-në velare të saj në mund të jetë refleksi i lat. *pila* «shtyllë, këmbë».

*pilikuri* «lakuriq». Këtë fjalë të çamërishtes Pedersen 177 e spiegon nga *lakur* «lakuriq» e nga *pi-* «për», duke marrë -*likuri* si një gjindore të varur nga kjo *pi-* «për». Spiegim në thelb i drejtë. Më drejtë ndërkaq është të shohim te *likuri* çam. *likurë* «lëkurë», si na del dhe te *likurishtë* «polip» për të cilën sh. po Pedersenin 152. Për zhvillimin kuptimor nga «më lëkurë» në «lakuriq» khs. *me likurë* «lakuriq» te Skirô i Ca. trad. 64. Dhe *lakuriq* vetë lidhet me *lëkurë*, sh. *lakuriq*.

*pilivesë* f. «Libellula vulgata». Fjalë e gegërishtes, toskërisht këtij insekti i thonë *kumahark*. S'e ka G. Meyeri, e jep sëpari Junggu me trajtën *pilivoes-a* «libellula». Siç shënohet në Bul. për Shk. Shoq. 2 (1954) 34 dhe te Xhuvani-Çabej (Bul. për Shk. Shoq. 4, 1956, f. 91), e më parë te Gazulli 322, është një kompozim i fjalës *ve voe* me *pili-*, si te *piliherdhe*, *pilipizgë*, *pilipuç* (khs. *kolopuç*), *pilivrom*, sh. dhe *pilikuri* e *Pilivore* te Vorë. Fjala *ve* hyn dhe në formimin e një tjetri emër insekti, *veme*, sh. këtë fjalë.

*pillë*, *pille* f. I. «koritë e gurtë e katërkëndshe, e madhe e e thellë. që shërben për të mbajtur vaj të mirë; qyp i madh për vaj». Fjalë kryesisht e Shqipërisë së mesme e jugore, që mungon te G. Meyeri. E ka si *pille* e me kuptimet më sipër. Fjal. i gju. shqipe. Më parë Kristoforidhi (pa ubikacion) *pille* «koritë guri për të vënë vaj brenda». Vis. e Kombit XIII 176 për «qyp». Manni prej burimesh së ndryshme «stone trough; spring-basin; watering-trough; square-shaped stone jar for wine or oil». Tani rishmë J. Thomaj (Bul. i Univ. Shtet, të Tiranës).

Ser. Shk. Shoq. 4, 1961, f. 150) *pill-a* «qyp i madh prej balte për konservimin e zarzavateve, djathit etj.», për Seman të Fierit. Sipas Kartotekës së Fjalorit të shqipes, në Kavajë *pillë* «magryp guri me formë vezake; futet fundi, qi â si me majë, në dhe; kjo s'â kurr balte, po vetëm gurit». Në krahinën e Beratit në Arëzë (Ura Vajgurore) *pillë* «enë guri në formë kubike, ze 200-400 kg. vaj ulliri», në Vokopolë «qyp i madh balte për vaj», në Palikësht *pille* «qyp i madh për djathë, turshi etj.»; *pillë* «qyp i madh për vaj» dhe në Elbasan. Në Kuç të Labërisë *pillë* «qyp i madh balte, ardhur nga jashtë», në Përmet (pas P. Tases) «enë guri për të mbajtur vaj ulliri, gur i gdhendur gropë në trajtë katrore» etj. Kolea e ka dhe për «abreuvour» e për «bassin de fontaine». Vjen nga lat. *pīla* «enë për të shtypur, havan; govatë dërstile, govatë, magje», që në gjuhët romane ka dhënë ndër të tjera dalm. (Veglia) *paila* «govatë e gurtë», it. *pila* «govatë, havan», friul. *pila* «govatë e gurtë», span. *pila* «govatë» etj., sh. Meyer-Lübke REW 6496. Për punë të karakterit velar të likuidës të *pillë*, si burim i kësaj më pak vjen në vështrim ven. *pila* «una specie di vaso in cui si pongono le ulive per infrangerle per cagion di far l'olio» (te Boerio), e cila përndryshe kuptimisht do t'i përgjigjej mirë fjalës së shqipes. Fjala latine ka hyrë dhe në greqishten e Italisë jugore, me kuptimet «shkelës rrushi», «mulli vaji», «govatë ku derdhet mushti i shtrydhur», «gropë ku derdhet vaji që shtrydhet nga ullinjte», «govatë», sh. Rohlf's EW 1702. LG 402. Në Shqipëri të mesme e në krahinat jugore që kanë ullishta pillat janë më fort enë vaji, prej guri a prej dheu.

*pillë* f. II. «vegël me të cilën krehin lirin». Nuk e ka G. Meyeri, e jep Kristoforidhi për të folët e Beratit. Jokli (Studien 68v.) e afron me gr. *πέκτω* lat. *pecto* «kreh», lit. *pësti* «me ndukë, me shkulë (flokët)», gjerm. e lartë e vj. *fahs* «flok, lesh» etj.; baza e fjalës shqipe sipas tij \**pek-lā*, me *i* prej *ie* para dy konsonanteve, e me sufiks *-lā* të emrave t'instrumentave. Spiegim i pranuar te Walde-Pokorny II 16, Walde-Hofmann II 270, Pokorny I 797, Hofmann GEW 258.

Në të folët e Lushnjes dhe *pillonjë* f. «maja e fqollës së lirit», me sufiks *-onjë*, për të cilin sh. Xhuvani-Çabej Prapashtesat 75. — Etimologjia indoeuropiane e fjalës ndesh në vështirësi fonetike. Përveç asaj do pasur parasysh se emrat e veglave në gjuhën shqipe, me përjashtim të *vegël*, neologjizmit *përdorse* e ndonjë tjetri, janë të burimit të huaj. Kuptimi i *pillë-s* në Berat «vegël për të rrahur lirin» (kumtim i L. Dodbibës) e spiegimi i Kristoforidhit «*ἐργαλείον τι μέ τό όποίον κτενίζουσι τόν λινόν*» tregojnë se kjo fjalë është një me *pillë* I. nga lat. *pīla* «enë për të shtypur; govatë dërstile, govatë», e cila në gjuhët romane ka dhënë kryesisht kuptimet «havan» dhe «govatë», sh. Meyer-Lübke REW 6496. Në dialektet greke t'Italisë jugore fjala latine ka dhënë ndër të tjera reflekse me kuptimet «vegël për të shtypur rru-shin, shkelës», «mulli vaji», Rohlf's EW 1702. LG 402.

*pillë* f. III. «gur i vogël që e hedhin kalamajtë në të lojtur». Këtë fjalë G. Meyeri 337 e shkruan me një *l* as velare as palatale, dhe e spiegim nga lat. *pila* «top, toph», bashkë me *pilë* në Siqeli (pas Skiróit, Raps. alb. 302) «la più bella e ben levigata pietruzza di fiume, di forma ovale... con esse le fanciulle giocano gittandole in alto e raccogliendole poscia nelle mani» e me *pilëzë* «guraçok» në Greqi (te Reinholdi). E kundërshton Pedersen (KZ 33,538), me arsyetimin se lat. *pila* do të kish dhënë shqip \**pellë*. Për punë të kësaj vështirësie Vasmeri (Studien I

51) mendon për një huazim të shqipes nga ndonjë dialekt i italishtes. Këtë mendim e lëfton Tagliavini 221 (te *pilk-a* «ciottolo»), me arsyen se në dialektet e italishtes jugore nuk ka refleks të lat. *pila* me ndonjë kuptim të afër me të shqipes.

Te kjo fjalë *l*-ja «neutrale» e G. Meyerit është një *l* velare (*ll*), se në Shqipëri kjo fjalë thuhet *pillë*, ashtu si e ka Fjal. i gju. shqipe. Trajtat e dialekteve shqiptare të Italisë, Greqisë e Dalmacisë na shpiten një *l* palatale. Një burim nga italishtja nuk vjen në vështrim: jo sepse mungon fjala në italishten jugore, po sepse ai dialekt që është burimi kryesor i italianizmeve të vjetra të shqipes, venecianishtja, në një periudhë të mëparme këtë fjalë e ka pasur *pela*, sh. Meyer-Lübke REW 6498. Edhe përhapja mjaft e madhe e fjalës përbrenda shqipes është një indic më fort për një huazim latin sesa italian. Kështu do të kthehemi te spiegimi i G. Meyerit nga lat. *pila*. Karakteri i likuidës është i rregullt për trajtën *pillë*. Sa për *i*-në e shkurtër e të hapët të latinishtes, kjo vërtet ka dhënë *e* në shqipen, po rregullisht vetëm përpara një konsonanti dyfish, sh. Meyer-Lübke Gröbers Grundriss I<sup>2</sup> 1045. Përpara konsonantit të thjeshtë ka mjaft rase me reflektim të *i*-së së shkurtër e të hapët me *i*, sh. *ilqe*, *qiqër*, *shtrigë*. — Kjo fjalë është një nga ato huazime latine të shqipes, me të cilat kjo shkon bashkë me gjuhët romane perëndimore: it. e vj. *pillotta*, span. port. *pella* etj., e me keltishten: kymr. e re, korn. *pel*, breton e re. *pellenn*, për të cilat sh. Walde-Hofmann II 302. Khs. tani vretjet tona në Revue de Linguistique VII 1 174v.

**pingrón:** *pingron zogu* «këndon zogu»; *pingron zana* «këndon, sokëllin zana»; *më pingron veshi* «më kumbon»; *pingrim* m. Fjalë e gegërishtes (veriore), që mungon te G. Meyerit. Weigandi (BA I 261) e merr prej Lahutës së Fishtës (II, Besa e lidhme): *N'Veleçik po pingron Zâna*; dhe e spiegon me të drejtë si një fjalë onomatopeike.

**pingul** «kryengulthi, picingul; në drejtim vertikal»; *pingule* f. «vijë e pingultë, vertikale»; *i pingultë* (vijë e p.); *pingulthi* «pingul». Mungon te G. Meyerit, e jep sëpari Bashkimi si *pingul* «a capitombolo». Të tjerat forma janë neologjizma të gjuhës shkollore. Është një kompozit *për-ngul* e verbit *ngul*, me *për-* që në silabë paratheksore ndryshoi *ë*-në në *i*, e përveç kësaj humbi *r*-në në një grup tri konsonantesh. Zhvillim njëloj si në *pilikuri* (për lëkurë), *pisputh* (për-sputh), *pizilë* (për zili), *Piburg* (Për burg) te Xhuvani-Çabej, Bul. për Shk. Shoq. 4 (1956) 90.

**pip** «pipëti, nxjerr zë». Për këtë fjalë Kamarda (I 143, 145, 175) jep (pas Hahnit) formën *pipin*, për arbërishten e Italisë *pipilin*, për Siqeli *pëpës*, gjen te *pipilin* një zgjerim me sufiks verbal *-l* (*-ll*) dhe i krahason të gjitha këto me osk. *pipatio* «clamor plorantis lingua Oschorum» që jep Paul Festi; kal. *pip*-i *pipp*-i «gjel deti, pulkë» e afron me gr. *πίππος* «zog, zokth» *πιπώ πιπούς* «një lloj qukapiku» etj. G. Meyerit 338 përveç *pipin*, *pipilin* e *pëpës* sjell edhe format geg. *pipllë*, kal. *pipyn*, *pipilin*, *pipëryn*, *pipitarin*, kal. te de Rada së *pipi* «s'nxori zë, s'tha një fjalë», dhe i shpie të gjitha te lat. *pipire* e *pipilare* «me ciatë, me këndue zogu»; po *pishónj* «pëshpëris» e *picëllôj* «*γογγύζω*» të Kavaliotit i afron me it. *pissi pissi* «pëshpëritje» *bisbigliare pispigliare*, gjerm. *pispehn* «pëshpëris», magj. *pisszen* «nxjerr zë, pipëti» etj., duke gjetur te ky i dyti grup fjalësh formime onomatopeike. Për *pipilj* edhe Weigandi 59 mendon një burim prej lat. *pipilare*.) Kris-

toforidhi jep për Kavajë *pip*, për Itali *pipínj*, për Përmet *pipëllíj*, për Berat *pipëlónj*, për Elbasan *pipílj*, për Krujë *pëplój*, bashkë me shprehjen *mos pipëló* «mos nxir zë, dhe i krahason këto me gr.  $\pi\pi\pi\lambda\zeta\omega$  «ciat, këndon zogu», po pa u shprehur a mendon për një afëri a për një huazim.

Fjalë e mbarë gjuhës, e cila paraqitet me trajta të ndryshme, po të afra në mes të tyre, baza e përbashkët e të cilave është *pip*. Pre; kësaj është formuar më një anë, me *-inj pipínj*, me *-ëtínj -ëtíj pipëtiój* «nxjerr zë» (*s'pipëtin* «s'bën gëk, s'ndihet fare»), ashtu si *vetëtiój*, *shkrepëtiój* e sidomos disa folje që shprehin zhurma a kumbime, si *oshëtiój*; më anë tjetër, me *-ëllíj pipëllíj*, ashtu si *fërshëllíj*, me *-ërinj -ëriój pipërinj* (sa gjësendi *s'pipërinte*, N. Frashëri Ist. e Sk. III v. 451), me *-ëliój pipílj*, me *-ëlój pipëlój*, këto të gjitha zgjerime me sufiks më likuidë, sikundër e vuri re Kamarda. Në këto rrethana është vështirë të nxirret e të izolohet një trajtë e këtij grupi homogjen, *pipëllíj* a *pipëlój* goftë, e të spieget nga lat. *pipilare*: analiza morfologjike tregon se një e tillë trajtë nuk paraqet veçse një formim sekundar të bazës *pip*. Kësaj i shtohet fakti që lat. *pipilare* s'ka veçse një përhapje të kufizuar në botën romane (it. e Sigelisë, spanisht, portugisht, Meyer-Lübke REW 6522). Prandaj te *pip*, *pipínj*, *pipëtiój*, *pipëllíj*, *pipëlój* etj. kemi një fjalë vendi me gurrë onomatopeike, e krahasueshme si e tillë me lat. *pipire pipilare*, osk. *pipatio*, gr.  $\pi\acute{\iota}\pi\omicron\varsigma$   $\pi\acute{\iota}\pi\pi\omicron\varsigma$   $\pi\acute{\iota}\pi\acute{\omega}$   $\pi\acute{\iota}\pi\omicron\upsilon\varsigma$   $\pi\acute{\iota}\pi(\acute{\iota}\lambda\zeta\omega$ , serbokr. *pipa* «një sëmundje e pulave», gjerm. *piepen* «me ciatë», lit. *pỹpti* «me fishkëllue», ind. e vj. *píppakā* «një zog» etj., ku vendojnë edhe *bibë-n* e shqipes. Sh. për këto fjalë sidomos Boisacq 786, Walde-Pokorny II 70, Ernout-Meillet 771, Walde-Hofmann II 309, Kluge-Goetze 445, Vasmer REWII 363, me literaturë. Format *pip pipínj pipëllíj pipëlój pipëtiój* të shqipes paraqesin një paralelizëm morfologjik të shënueshëm -me gjithë se sigurisht spontan e të pavarur — me lat. *pipare*, *pipire*, *pipilare*, *pipitare*. Trajta *pépés* e Sigelisë na del dhe në Greqi, si *pepés pepét*, në shprehjen *mite flet mite pepét* «as flet as pipëtin» (për një fëmijë), të cilën G. Meyeri (AS V 98) drejt e gjykon si një fjalë të gjuhës së fëmijëve, po nuk e përkthen saktë me «er schläft nicht und sagt nicht papp». Kjo është një nga përkimet e veçanta të arbërishtes së Greqisë me të Italisë. — Formime onomatopeike janë — sikundër e vuri re G. Meyeri — dhe *pishój* e *picëllój*. Të dytën, si u pa, e jep Kavalioti, të parën për toskërishten dhe Kristoforidhi. Në gegërishten mbizotërojnë zgjerimet me *-(ë)lloj*, *pishllój* «pëshpëris» te FGS e me *pishkullye* «me folë kadalë, me zâ t'ulët, me folë në vesh» që jep Gazulli për të folët e Pukës. — Në këtë grup fjalësh mund të vendohet dhe gr. e re  $\pi\pi\pi\lambda\zeta\omega$  «thith; quk», të cilën Andriotis 198 jo fort me të drejtë e nxjerr nga it. *pipilare*, po që Korais ("Ατακτα 2,87) e spiegon nga gr. e vj.  $\pi\pi\acute{\iota}\lambda\zeta\omega$  «ciat». Nga  $\pi\pi\pi\lambda\zeta\omega$  rrjedh *pipilís* «ha krejt» e shqipes së Greqisë, G. Meyer AS V 98v.

**pirí** f. «hinkë». Fjalë e geg. veriore, që mungon te G. Meyeri. E ka sëpari Junggu e Bashkimi; Gazulli jep dhe *piritë e hundës* «birat e thella të hundës». Ose nga gr.  $\pi\acute{\epsilon}\iota\sigma\iota\alpha$  «hinkë» ose nga ven. *peiria* «hinkë», për burimin e së cilës khs. Meyer-Lübke REW 6597. Oksitonia te *pirí* duket të jetë kryer përbrenda shqipes. E ka dhe serbokroatishtja si *pirija* po me këtë kuptim. Drejtpërdrejt nga greqishtja vjen tosk. *piro* «fyt i fuçisë». Nga një kryqëzim i fjalës greke me *qiri*

«hell akulli» rrjedh *pirinj-pirinj* «si hej akulli» (sidomos për flokë) në Labovë të Kryqit afër Libohovës në Jugë (E. Lafe).

**pispùth** m., fjalë poshtërimi, në shprehje si *ai pispùthi i mutit*. E ka Tase. Është *për-sputh, për-spurth*, duke shkuar me *spurdhíq spurdhjakës* «kalama i vogël, mistrec» (për sharje), *spurdhís* «flas palavi». Lidhen të gjitha me *purth* m. «diaré, lëbarke, të hequrit bark», *purthem përpurthem* «ndragem», e në analizë të fundit me *pjerdh*. Rënia e *r-së* së dytë të *pispùth* u bë ashtu si të *përpùth përputhem* për «përpurth, përpurthem»; *i-ja* nga një *-ë-* në silabë paratheksore, si shpeshërë, sh. më lart *pilikuri, pingúl*. Për emërtimin e fëmijëve të vegjël nga fjalë të kësaj sfere, përveç *spurdhíq spurdhjakës* khs. *fancúk, shurdhjés*. Prej gjuhëvet romane ndër të tjera zvic. etj. *ekreme* «*kërthi, foshnje*» (*excrementum*), frgj. jugore *petún petót*, romanjol. *pet* «fëmijë i vogël», Meyer-Lübke REW 2989, 6358.

**pjalm** m. «miell i situr imtë; majë e miellit, ëndë», *pjalm bore* «borimë që çon era përplotë». Mungon te G. Meyeri. Etimologjia e drejtë në thelb gjindet te M. E. Schmidt KZ 50 (1922) 243 e 248: *pjalm* nga \**pelm*, e afër me lit. *pelenai* pl. «hi», let. *pèlni* «hi» etj. Pranuar me rezervë te Vasmeri REW II 365. Jokli IJ X VII 122 kufizohet në shënimin që kuptimi «*tym pluhuri*» që jep Schmidt nuk është i plotë.

E njohim gjer më sot vetëm për gegërishten. Pekmezi (Lehr-und Lesebuch d. Alb. 158) e ka për «*Staubwirbel, pjalm a shakull pluhuri*». Logoreci *pjalm* «*pjesa e pluhunit mâ e imta; pjalm bore, fijet e para e mâ të vogla të borës kur fillon me reshë; pjalm mielli, pjesa mâ e imta e pra mâ e mira e miellit; pjalm lulesh, endi, pluhuni mbi nosh-tulla të lulevet*». Cordignano *pjalm* «*farina scelta per le vivande, maje*», *plajm* m. «*la farina più scelta, o fior di farina; pjalm bore* «*neve minutissima, nevischio*» *pjalm* «*neve come a granellini*», Cordignano<sup>2</sup> te *nevischio*, poashtu dhe Bindoni. Mjedja (Juvenilia 1917, f. 67) *Qet balkoni pjalm e borë*. Gazulli jep për Pukë *pjalm* e *plajm* «*pluhun i imë fort; plajm mielli* «*miell paskaj, paskaq; plajm bore* «*borë e imë qi hyn ndër plasa*», për Malsi të Madhe *me hung RUE ujku në pialm* «*m'u ankue kot, me lehë si qëni në hanë*». Një përdorim sekundar duhet të jetë *pjalm i tamlit* për ajkën kokrrizë të qumështit, prej së cilës, me të tundur të qumështit në tundës, nxiret gjalpët. — Si bazë e *pjalm-it* do të vendoset një \**pelm-*, po jo — si mendon M. E. Schmidt — një \**pelma*, sepse kjo do të kish dhënë një fem. \**pjalmë*. Etimologjikisht e kuptimisht fjala e shqipes afrohet veçanërisht dhe me lat. *pollen* «*miell i imtë shumë, majë mielli, ëndë*», duke qëndruar ndaj kësaj në raport të një apofonie kualitative (*e: o*), po ndaj fjalës lituane në shkallë vokalike të barabartë (*e: shqip ja*). — Rum. *pielm piemn* «*miell gruri që i shtihet brumit ngjeshur me miell misri, për t'i dhënë këtij një ngjeshje më të mirë*» Tiktini III 1158 bashkë me ret. *pelma* «*ëmbëlsirë e shtruar hollë*» Iomb. etj. *pelma* «*hoje mjalti, pite mjalti, pite mjalti*» andal. *pelma* «*top, shuk, grumbull*» span. *pelmazo* «*ngjeshur fort, rrasur*» e spiegon nga gr. *πέλμα* «*shuall*», Meyer-Lübke REW 6364 nga gr. *πήγμα* «*trup i ngjeshur, i mbështjellë*». Scribani (Arhiva XXXI 46, XL 109) e afron me shq. *miell*. Jokli (IJ XX VII 138) vren me të drejtë se shqipja ka fjalën *pjalm* «*miell i imtë, borë kokrrizë*», duke menduar sigurisht që fjala e rumanishtes ka dalë prej kësaj të shqipes. Më saktë do të themi se rum. *pielm* rrjedh prej trajtës dialektore (më fort të geg. jugore e të mesme) *pjelm*, kjo pas Shp. Bardhit (HD XI 463) «*pak*

miell qi qulltonet me ujë të nxehtë e mbasandej shtrihet përmbi bukën e gatueme qi çohet në furrë për t'u pjekun; pak miell qi kuqet, kavurdiset në zjarm me voj a me tëlyen e mbasandej i hidhet edhe pak ujë i nxehtë për t'u bâmë qull për mish: pjelm buke, pjelm mishi». Në Shqipëri të mesme është edhe qulli në trajtë tophash që ahahet bashkë me pulë, gjel etj., po *pjelm* i thonë dhe paskaqit të miellit që bie rreth gurit të mullirit. Sikundër shihet, fjala rumune piqet më së miri, në formë e në kuptim, me këtë *pjelm* të shqipes. Prandaj ajo duhet të ndahet nga fjalët e italishtes e të spanishtes. Këmi të bëjmë me një element dialektor të shqipes në rumanishten, me një huazim nga sfera shtepiake e baritore. Kjo është një nga ato rasat ku rumanishtja jep një dëshmi për ndrime fonetike mjaft të mocme përbrenda gegërishtes, këtu për *a : e*. Sh. për këto ndrime Rev. Shkencore e Inst. Pedagog. dyvj. të Shkodrës 1 (1964) 55vv., Z. f. Balkanologie II 7v., 11v., 26v. Më e re është metateza në distancë që dha *plajm*-in e geg. veriore.

**pjekë-t** fpl. «qerpikët e syrit (njëjësi nuk përdoret). Këtë fjalë që ka mbetur pa spjegim te Pedersen 178, Jokli (Studien 69) e vendon te grupi gr. πέκτω lat. *pecto* «kreh» gjerm. e lartë e vj. *fahs* «flokë» etj., duke e bashkuar përbrenda shqipes me *pillë* «vegël për të rrahur lirin» e më tej me ind. e vj. *paksman-* «qerpikë, flokë». Vihet në dyshim te Walde-Hofmann II 270 e sidomos te Walde-Pokorny II 16, për punë të guturalit palatal të rrënjës indoeur. \**pek'*-, e nuk përmendet më te Pokorny I 797.

Fjalë e një pjese të Çamërisë. Margëllëçi p.sh. thotë *cínura* (greq. e re, G. Meyer 441), Filati me rrethe (Spatar etj.) *pjekë-t*. Rrjedh nga *pjek* «takoj; prek, çik, qok (dorën)», që ka pasur një kuptim «godit, i bie» e «përpjek». Qerpikët janë quajtur në shqipen pas së përpjekurit të tyre kur mbyllim ose kur kapsallitim sytë. Prej gjuhësh së tjera khs. lat. *palpebrae: palpor, -ari* «me prekë lehtë me dorë, me fshikë», it. *in un batter d'occhio*, bullg. *klepač* kapak i syrit»: *klepa* «me rrahë, me i ra tokës» (Weigand Bulg. Gram. 64, Mladenov 240); aty hyn mbase dhe span. *pestaña* kat. *pastanya* «qerpik», e cila pas Meyer-Lübkes REW 6536 përbën vështirësi formale e kuptimore. Nga iranishtja khs. pers. *mīza* «qerpik»: lat. *mico, -are* «përpëlitem», te Lidén IF 19,333. Morfolojikisht *pjekë* është një nga postverbalet e shpeshta më -ë, si *dredhë mërzitë* (Budi SC 26,81), *kullosë kullotë* (Bardhi 84), *pritë, sillë, shpurë*. Kështu kjo fjalë është identike me *pjekë* «takim, ndeshë, pjekje», e cila ndërkaq largohet nga kuptimi; një emër abstrakt si ky i fundit është edhe *pjekë* «e keqe, shuplakë (morale)», në shprehjen *aty e muer pjekën*. Me këto tri *pjekë* lidhet dhe mashk. *pjek-u* «shkopi i madh në lodrën kut e cingël, kuti» te Kristoforidhi (f.324, 440) e te Tase (f. 25), bashkë me kompozitet *pjekacingthi* e *cingulapjekthi* «kut e cingël». Me *pjekun* vrëngëllijnë nga gropa cingëlin e i bien atij sa pa rënë në dhe, pra *pjek-u* «goditës». Gjithë këto trajta me *pjek-*, si *pjekë* f. me të tria kuptimet, si *pjek-u* me grupin e tij, janë postverbale të *pjek* më të reja se *pikë* me -i-në e saj.

**Pjetër** m. Emër burrash, nga emri i apostullit. Ky del që te Buzuku, p.sh. *qi mā i pari kle Shenjti Pjetrë; e me ata ish edhe Pjetri, tue ngrohunë kambëtë* «erat autem cum eis et Petrus stans, et calefaciens se» (XXVI b, LVIII/2 = LXVIII/2, Gjoni 18,18). Budi (SC 22) zotit shent Pjetrë e zotit shent Pāl, Bogdani (II 132,8) e thoni qish po

*shifëni Dishipujet tina, e ma tepërë Pjetrit.* Fonetikisht mundësitë e një burimi prej lat. *Petrus* ose prej it. *Pietro* janë të barabarta. Po në këtë mes çon peshë kriteri që ky emër përveç se në Veriun katolik rron në disa gjurmë dhe në Shqipërinë jugore, tek elementi ortodoks: *Pjetri* në një mbishkrim të shek. të XVIII-të në Libofsh (Th. Popa, Bul. i Univ. Sht. të Tiranës. Seria Shk. Shoq. XII 1, 229, 245v.); *Pjetri* dikur emër familjeje në Gjirokastër, *Siko Pjetri*, piktor i shekullit të kaluar, prej Nokovës së Lunxhërisë. Këtyre u shtohen dhe vargjet popullore *Po na vjen zoti shën Pjetër e I shën-Gjin e i shë-Pjetër* që këndohen në mbrëmje ditën e shën Gjinit, i pari në Pogradec, i dyti (pas Peder-senit 96) në Lëkurës të Sarandës. Një toponim *Pjëtrash* gjindet në Nivicë-Bubar të Bregut të Detit. Kjo përhapje në mbarë truallin e shqipes flet për një huazim latin, jo italian, sh. dhe Rev. de Ling. VII 1 176. Një i tillë burim është afër menç edhe historikisht, se *Pjetër* duhet të jetë i një periode me *Pāl*, *Mëri* etj., që janë huazime latine. Hipokoristiku *Pjetrûsh*, formuar me *-ush* deminutiv, në Shkodër përdoret më fort me trajtën e shkurtuar *Tush*; *Tuk* nga *Pjetrûk*, po ekziston edhe *Pepë*; sh. për këto trajta Buseti 1148. E sotmja *Petro* e *Jugut* prej gr. së re Πέτρος. Në këtë trevë shtresat onomastike të rejat *Petro*, *Mihal* etj. kanë mbuluar më të vjetrat *Pjetër*, *Mëhill* etj. Këto u tërhoqën këtu në emra familjesh, në toponimi, në hagjoni, në emra muajsh a festash etj. — Për it. *Pietro* sh. tani H. Rheinfelder, *Il nome di Pietro*, Riv. di filologia 91 (1963) 5 vv.

*planós planoz* m. «shpes (turtull, thëllëze etj.) që e mbajnë në kafas për të ndjellë shpes të tjerë; beng i balsamosur». Fjalë e dialektit të Beratit, që s'e ka G. Meyeri. Kristoforidhi 330 pas gjase me të drejtë gjen këtu gr. πλάνος «gënjeshtar». Për këtë e për shpërnguljen e akcentit në huazime greke si πάτος «thellësi»: *Patós* sh. vrejttjet tona në Bul. për Shk. Shoq. 3 (1954) 59. Manni jep për Tomor *blanóz*, emër zogu, sipas tij mbase bengu. Është sigurisht identik me *planós*, me kthim të labialit të pazëshëm në të zëshmin në ballë të fjalës e para një l-je. *pleq*. Në vargun e Lahutës së Malcís *Pse e dau Rusia n'pleq t'Berlinës* për «në Kongres të Berlinit» Weigandi (Balkan-Archiv I 261) te *pleq* gjen refleksin e një lat. të rindërtuar \**placium*, variante e *placitum* «gjq, padi». Si e kemi shtjelluar në Li. Posn. VIII 71v. e në Rev. de Ling. VII 1 193, *pleq* nuk është tjetër veçse plurali i *plak*-ut me kuptimin e arbitrit që thirret për të ndarë një gjyq midis dy palëve kundërshtare e të ndërmjetësit në një pajtim. Khs. *pleqësi* «kshilli i burrave të zgjedhur të një fshati a të një lagjeje që vendosin mbi punët e fshatit a të lagjes; puna që bënte një burrë që e kishin zgjedhur për plak», në Gjirokastër *pleqësitë* pl. «punë pajtimi midis dy palëve kundërshtare»; dhe gr. γερουσία, lat. *senatus*. Ekziston edhe verbi tosk. *pleqësoj* «rrahim një çështje në pleqësi; shkoqitim, bisedojmë në mes tonë një çështje që na përket», *pleqësohem (me)* «bisedoj me një, kshillohem me të» me emrin *pleqësim* «vendim i dhënë nga pleqtë», geg. *pleqnoj* «pleqësoj» e kanë *pleqnue* «e kanë vendosur në kuvend», e «e mendoj mirë një punë», *pleqni* f. në *qe bâ pleqni* «qe vendosur (në mbledhje), *ban pleqni me vedi*, mendohet mbi atë punë». Emërtimi i arbitrit me fjalën *plak* është i moçëm në truall të shqipes. Khs. *Vechi della Comunità di Alexio* (Lezhja), B. Giacomelli, *Viaggio di un ambasciatore veneziano da Venezia a Costantinopoli nel 1591*, te Z. Shkodra Ek. Pop. V 5 f. 78.

**plesht** m. II. «sqtull». Fjalë e paregjistruar; përdoret në Piana dei Gredi të Siqelisë kryesisht prej barinjve, kur prekin berrat në sqetull për të parë a janë të majmë. Pas një kuptimi me gojë të N. Joklit, nga bullg. *plešti* pl. (dikur dual) «sup, shpatull», së cilës i përgjigjet serbokr. *pleć-i*. Sllavizmat e dialekteve shqiptare t'Italisë, me ndonjë përjashim si kal. *opangë*, e cila me -a-në e saj duhet të burojë prej serbokroatishtes, rrjedhin më të shumat nga bullgarishtja, në pajtim me burimin e atyre kolonive kryesisht prej Toskërie.

**plish** m. «Phragmites communis, bimë kënetash me fletë të gjata». Mungon te G. Meyeri. Spiegimi që i jep Jokli (LKU 32v., 215 v., Slavia XII 309) nga rrënja indoeur. \*(s)phel- «çaj, pres», për punë të fletëve me teh e majuke, duke e lidhur përbrenda shqipes me *plis* «bucë», me *palë* e me *popël*, pranohet te Walde-Hofmann II 505 e me rezervë dhe te Pokorny I 986.

Si e pa Jokli, *plish*-it i përket dhe *plizhgë* po me atë kuptim; nga *plishkë*, me sonorizim të gjithë grupit -shk, khs. *zhgul* për *shkul*, *zhgarkoj* për *shkarkoj*, i *vrazhdë* për i *vrashtë*. Emri botanik rron dhe në toponimet *Maja e Plishit*, *Lugu i Plishit*, M. Sirdani HD XIII 357. — Etimologjia e Joklit mund të jetë e drejtë. Me gjith' atë ka dhe një tjetër mundësi afrimi, d.m.th. me lit. *pl(i)ušė plušis* «kallm», edhe kjo një bimë ujëse si plishi. Për fjalën lituane, në lidhje edhe me prus. e vj. *bleusky* «kallm», sh. Walde-Pokorny II 213, Endzelin Z. f. slav. Phil. XVIII 115, Fraenkel 628.

**pluar** m. «umbi i parmendës». Fjalë me etimologji të diskutuar. G. Meyeri 346 i mbahet mendimit të Makuševit, i cili e spiegonte nga një sllav. \**plugar* prej *plug* «parmendë». Meringeri (IF 17, 113; 18, 244) mohon çdo burim të fjalës prej sllavishtes a prej greqishtes, dhe bashkë me Meyer-Lübken gjen aty një huazim nga *pflua*, formë dialektore austriake e gjerm. *Pflug* «parmendë», ardhur në Shqipëri me anën e industrisë së hekurit të Stirisë. E kundërshton Pedersen (Krit. Jahresbericht IX I 217), për arsye fonetike e materiale. Jokli (LKU 130 vv.), duke u nisur nga forma *pëlori i parëmëndës* i Siqelisë (te Z. Skirô, Raps. alb. 94), e zbërthen fjalën në *pë-luar*, ku *pë-* = *për-* e *-luar* = *luer* si në *fluer* «çekmexhe, syzë e tryezës; një pjesë e ndarë e arkës së nuses», dhe e afron brenda shqipes përveç kësaj dhe me *lug* e *lugë*, me *flugë*, *shlor*, me *laj* «paguaj», *përlaj* «marr, rrëmbej krejt», përjashta shqipes me ind. e vj. *lāvah* «që pret», *lavah* «copë», rus. *lava* «bankë për të ndenjtur, vig përmbi një përrua», nord. e vj. *lafi*, *lofi* «lëmë, drithnik» etj. Këtij mendimi Jokli (Archiv. Roman. XXIV 34v.) i mbahet edhe pas kritikës që i bën Tagliavini (f. 229), i cili, bashkë me Oštirin (Archiv za arb. starinu II 377), pranon një afëri të *plori-t* (Borgo Erizzo *prol* me metatezë) me lat. *plovum* «parmendë». Me Joklin bashkohet Walde-Hofmann II 834 e Pokorny I 681. Te spiegimi i Makuševit e i G. Meyerit kthehet përkundrazi tani rishmë më një farë mënyre Skoku (Jugoslov. Enciklopedija I 162), duke gjetur bazën e fjalës te sllav. *plug* + gr. e re -*ἀρι*.

Fjalë e mbarë gjuhës. Del që te Buzuku (XXXI, Isaia 2,4): *e të kthenjënë shpatëtë e tyne e t i banjënë thikë n plori* «et conflagunt gladios suos in vomeres»; Bardhi *Aratrum Umbi, Plori*; Iugerum, *spatio di terra Një ditë mpluer, Vomer Humb, Pluer, thika e plorit*. Sikundër shihet, *plori* te Bardhi — e mbase edhe te Buzuku — shënon

umbin, po dhe parmendën, e në këtë rasë umbi jepet me *thika e plorit*. Për të dyja e jep për Veri edhe Nopcsa 119. — Në pikëpamje semantike *pluar pluer plori* do gjykuar ashtu si *almise*, si një term i detarisë që në rrethanat e shqipes u bë term bujqësie. Rrjedh nga gr. e re *πλώρη* «balli i anijes, bash». Kjo u përdor sëpari po për detari. Një përdorim të tillë e ruan edhe sot Bregu i Detit: *pluar plori* «bashi i barkës», *era në pluar* «il vento in faccia», *deti në pluar* «deti përpara» (L. Dodbiba), *luan varka prim e pluar*, *tundet varka prim e pluar* «fund e krye, mbrapa e përpara», ku *prim* është edhe kjo fjalë greke, *πρόμνη* «pjesa e mbrapme e barkës». Godini jep një fem. *plorë* «bashi i anijes». Në shqipen e Greqisë refleksi i gr. *πλώρη* është *puar pori*, G. Meyer 354v. Fjala *pluar* pastaj pësoi në shqipen një zgjerim kuptimi, duke shënuar ballin, pjesën e përparme të sendeve të tjera. Mënyfund ngushtoi kuptimin përsëri, duke u specializuar për umbin që është pjesa e përparme e parmendës, e që çan dheun ashtu si bashi i anijes çan detin. Një zgjerim semantik vihet re edhe në lat. *prora* nga gr. e vj. *πρόρα*, trajta e moçme e gr. së re *πλώρη* lat. e vonë «prora capitis dicitur pars anterior. Oculi sunt instrumenta visus, de quibus quare sint duo, quare in prora capitis locati. Prora cerebri, et puppis cerebri. Prora colli», Du Cange, Glossarium mediae et infimae latinitatis VI 536. Trajta *pëlori i parëmendës* e arbërishtes së Siqelisë, pra e toskërishtes së vjetër, duket të ruajë bash fazën semantike të ndërmjeme të fjalës, «pjesa e përparme», e njëkohësisht dhe fillimin e specializimit në drejtim të bujqësisë, me atributin *i parëmendës*. Ky pastaj me anë të një elipse u la jashtë, duke mbetur vetëm *plori* si emër i umbit. Nga një përdorim më i përgjithshëm i *plori*-t ka rrjedhur dhe përcaktimi me shtim të *thikë*-s (*thikë n plori*) që ka Buzuku me Bardhin. Trajta më -ë- e Siqelisë (*pëlori*) paraqet anaptiksën e një vokali që është e rregullt në këtë pozitë n'atë dialekt, si te *gëluri* për *gluri*, *këlé* për *kle* lloreve. Për diftongimin e o-së në huazimet nga greq. e re khs. *si* «qe, ishte». Morfologjikisht gr. *πλώρη* hyri në grupin e mashkulloreve. Për diftongimin e o-së në huazimet nga greq. e re khs. *sinuar sinuer, katua*.

**podhë**, *podhjá* f. «përparje, futë», në Siqeli «prehëri i petkave grarishte». Nga gr. e re *ποδιά*, G. Meyer 346, sh. dhe Kamardën II 8. Identike me këtë është *podhiqe* f. «neçe (përparje) leshi e vjetër» në Seman të Fierit (te J. Thomaj, Bul. i Univ. Shtet. të Tiranës. Ser. Shk. Shoq. 4, 1961, 150), me -iqe si *gardhiqe*, khs. edhe *kalique, telique*. Një tjetër formë dialektore është *pëdhite* f. «përparje» të Weigandi 67, te Godini 313 *pëdhete* «Schurz». Pas mendimit tonë -t-ja e silabës fundore te këto dy trajta ka rrjedhur prej artikullit të pluralit të shquar, sh. Li. Posn. VII 190.

**pond** m. «gisht, pëlqyer», si masë gjatësie. Mungon te G. Meyeri. Del që te Buzuku (LXXXVII = CVII, Mateu 5, 18): *një trat o një pont të mos shkonjë n ligjet djerie gjithë mos banenë* «iota unum aut unus apex non praeteribit a lege donec omnia fiant». Sot *pond*, në Korçë *pondë* f. Nga it. ven. *ponto*. Fjala veneciane edhe në greq. e re si *πόντος*, Andriotis 204. Trajta *bondo* f. e tosk. jugore do të ketë hyrë prej kësaj fjale të greq. së re.

**porropí**, *perupí* f. «shkatërrim, greminë, rrokullimë». Fjalë e toskërishtes, që mungon te G. Meyeri. Gjindet te N. Frashëri (Hist. e Skënderbeut 231): *i dha Zoti porropinë*; Tasi *ἀναποδιά prapësi*;

*poropí*. sh. dhe Shp. Bardhi HD XII 243. Tase *porropí poropí perrupí* «greminë, shkatërrim, prishje». Xhuvani e spiegon nga gr. ἀποπέπεια «gjë e pangjarë, e pahieshme».

Në Gjirokastër *rupí* f. «fatkeqësi, gjëmë, mynxyrë», në thelb «tätëpjetë», nga gr. e re ῥοπή «shtysë; pjerrësi». Përdorimi metaforik i prishjes, shkatërrimit nuk është greqishtes, u ka kryer në shqipen. Te *porropí perupí perrupí* kemi pas gjase një kontaminim me *përrëpinë* «rrepirë», që është *për-rëpinë*, si e vuri re dhe Kristoforidhi 319. Po te *porropí* mund të ketë ndërkaq dhe një geminacion ekspresiv.

*posaçë* «veç, veças»; *i posaçëm* «i veçantë»; *posaçërisht* «veçanërisht»; *posë* «veç, posaçë, mënjanë»; përveç, me përjashtim të»: *për-pós* «përveç, me përjashtim të». G. Meyeri 266 jep *mbosë* (drejt është *mbose*) prej Bogdanit e *pos* «më vete» prej Jarnikut, dhe e spiegon fjalën me të drejtë nga sllav. *po se*, serbokr. *napose* «një nga një, veç e veç», *poseban* «i veçuar, më vete». Pa të drejtë mungon te Selisçevi 196v.

Del që te Budi (DC 37):... *veçëse shtatë fjalë, qi eciecia ndë vetëhe kã forcënë e arrësyenë e vet*, me *m*-në shqipen. Trajta *mbosa* e Bogdanit ka asimilim *mp:mb*. Formimi i *posaçë*, prej nga janë zhvilluar më tej *i posaçëm* e *posaçërisht* (me tosk. *-ërisht*), mbetet dorajdorën i errët. — Si fjalë e geg. veriore është një huazim nga serbokroatishtja.

*postiqe* f. «lëkurë berri me gjithë lesh, që përdoret për të ndënjur *mbi* të». Fjalë me një larmi të madhe trajtash nëpër dialekte: Vlora *postogje*, Myzeqeja me Beratin *postaqe*, Elbasani *postiqe*, Tirana *pastiqe*, Dibra *postaqi*. Të gjitha nga turq. *posteki pösteki* «pelle di montone su cui si siede»; *post* m. «postiqe» nga turq. *post*, kjo prej pers. *post* «lëkurë», sh. Li. Posn. VII 199v. Në Borsh *pos-i*. Duke u marrë *postiqe* gabimisht si një plural, u formua singulari i ri *posték* m. që ka Leotti. Te format e tjera kanë ndërhyrë sufikset *-aqe*, *-oqe*, *-iqe*. Te tosk. *posté* f. (*posté kali*) e geg. *postahe pastaje pastë* «mbulesë e leshtë» Jokli (IF 49, 288) gjen bullg. *postava* «astar», dhe andej spiegon ai dhe shq. *postava* «shokë grash prej shajaku» e *postáf* «pëlhurë, cohë». Sh. më parë dhe G. Meyer 349, si dhe Selisçev 174. Në truall të shqipes mund të ketë ndodhur një përzjerje e fjalës turke me sllaven.

*poshtër* (i) «i dobët, i ulët nga karakteri; i poshtëm», *ana e poshtër e lumit*. Kjo fjalë ndihet sot sikur t'ishte vetëm e toskërishtes, dhe përdoret gjithkund pothuajse vetëm me kuptimin e parë, të figurshmin. Monumentet gjuhësore të vjetrat dhe toponimia na tregojnë se është e mbarë gjuhës dhe se ka qenë përdorur me domethënie normale të asaj që gjindet poshtë, të së poshtmes, kështu që kuptimi i figurshëm është sekundar e i vonë; sh. BSS 4 (1955) 121v.: Buzuku (XXXII/2, Danieli 3,55; XXXVIII/2 e XLI/2, Mateu 8,12) *tue pasunë qyrë visetë e poshtëra të ntheta* «qui intueris abyssos»; *E bijtë e regjënise të jenë qitunë ndë t erëtitë m̄ të poshtërë* (*E bijtë e regjënise kanë me klenë qitunë ndë të poshtërat të errëtit*) «fili autem regni eicientur in tenebras exteriores». Bogdani (I 38,30) (tërmeti) *ashtu shterguem ndë shpella të poshtëra të dheut* «(Il tremuoto) così ristretto, nelle concavità inferiori». Edhe sot në emërtime vendesh, si e kundërta e së epërës: *Dushi i epër*: *Dushi i poshtër*, *Curraj-epër*, *Curraj-poshtër*, në Vjerdhë *Qeta e Poshtër* (Folklorë II 179); në anët e Dibrës *Reka e epër*, *Reka e posh-*

tër; veçanërisht në Verisht-Sllovë *Kroi i poshtër*, *Kovaçet e poshtra*, në Dupjakë *Grika e poshtër*, *Gjurma e poshtër*, në Shumbat *Fusha e poshter*, në Suhodoll *Vorret e poshtra* (P. Daka). Ky parim emërtimi është i mbarë gjuhës, sepse çfaqet dhe në viset më jugore, *Zagorie e poshtër* përkundrejt *Zagorie e sipërme* (M. Totoni), në Piqeras të Bregdetit *Fusha e poshtërë* (L. Muçko). Nga *poshtër* në këtë kuptimin më konkret është formuar geg. (Puka) *poshtrák*, fem. *poshtrake* «kush bannon në dhe të poshtër, jugor», me *poshtrënjane* «dheu i poshtes, jugu», te Gazulli. Ky emërtim lidhet me kushtet topografike të vendit, sepse për Veriun viset më jugore janë edhe më të ulëtat; kurse për Jugun (e te Pedersenit) me *poshtë* shënohet veriu, me *lart* jugu, sepse ato vise në veri kanë fushën e Myzeqesë. Nga *poshtër* me kuptimin e figurshëm është formuar verbi *poshtëroj* me emrin përkatës *poshtërim*, i cili ndihet si i dalë prej toskërishtes dhe mund të ketë dalë me të vërtetë s'andëjmi, sikurse ka dalë edhe vetë *i poshtër* me kuptimin e figurshëm. Pas kësaj gjedheje u sajua në gegërishten e re si trajtë *posht(ë)nój* *posht(ë)ním*, me gjithë se gegërishtja e vjetër, sikundër u pa, ka *i poshtër*. Në këto rrethana do të gjykohej si një gegizim i ri dhe *i poshtën* që jep Gazulli për Malsi të Madhe. Nga një kryqëzim i *i poshtër* me *i poshtëm* e pas gjase dhe nën ndikim të opozitit *i sipërm*, ka dalë *i poshtërm*, që përdoret në toskërishten me kuptimin gjeografik o topografik («inferior») e me të figurshmin, te Dozoni «qui est en bas, inférieur, bas». — Mbiemri *i poshtër* në morfologjinë e tij do vështruar në lidhje me ndajfoljet *përpësh* e *poshtë*. Nga këto, *poshtë*, sikundër e vuri re Pedersenit (KZ 36,290, KGr. I 50,181), është rrjedhuar nga *posh-* me sufiks *-të*, pa mundur ndërkaq ta ndajmë a kemi këtu një zgjerim të kohës preetnike apo postetnike të shqipes. Sa për *poshtër*, kjo ose është një zgjerim i *poshtë* me *-(ë)r*, ose një zgjerim i *(për)posh* me *-tër*. I mendimit të dytë është Boppi (f. 487), kur e merr *poshtë-n* për një cungim të *poshtërë*, e ketë vetë për nga sufiksi e krahason me ind. e vj. *-tar* në *antár* «ndër», lat. *-ter* në *inter* «ndër», *subter* «nën», *praeter* «përveç», *propter* «për shkak të», gjerm. e vj. e *lartë-tar* *-dar* në *untar* «nën, ndër», *nidar* «poshtë» *widar* «kundër» Jokli nuk shprehet në këtë mes. Po nga analiza e fjalës *pështjerë* «poshtë, tatëpjetë», të cilën e lidh me *poshtë* dhe e shpie te një bazë *\*péd-s-tero* (Studien 59v.), shihet se ai nuk mendon ndonjë sufiks indoeur. *-ter* për këtë fjalë. Ne te *i poshtër* e te *pështjerë* që mendojmë se lidhet ngushtë me të, sidomos dhe nga puna e përdorimit të fjalës si opozit i *i epër*, *i sipërm* në emërtime vendesh, shohim një komparativ me *-tero-* (*\*pédstero-*) të datës preetnike (indoeuropiane) të shqipes, poashtu si te *tjetër*, sh. dhe Xhuvani-Çabej Prapashtesat 91.

**potina** fpl. «këpucë më fort të gjata». Mungon te G. Meyeri, e ka Manni. Fjalë e vjetëruar, më fort e dialekteve të toskërishtes. Huazim nga turq. *potin* «këpucë», kjo prej frgj. *bottine*. Fjala frenge ka hyrë dhe në të tjerat gjuhë ballkanike e ka shkuar gjer në rusishten; khs. G. Meyer Ngri. Studien IV 63, Andriotis 155, Dict. li. rom. moderne 90, Vasmer REW I 113. Ndërmjetësia e turqishtes në elementet frenge të shqipes është shpeshtë.

**pothujaj pothuë** «gati gati, jo krejt, kështu që pak mungon», edhe *pothujajse*, *pothuëse*. Është një adverb, një nga ato fjalë që kanë dalë prej një fjalie. Nga indikativi i vetes së dytë njëjës të verbit

*thom* u formua *thuase thuese, pothuase pothuase*. Nga imperativi *thua* *thuej* doli *pothuaj pothuajse*. Trajta e thjeshtë, pa *po*, gjindet te Budi (DC 178a): *thuose u bie pikë*.

**práj** «fëlliq me një sëmundje, infektoj»; *prâhem* «fëlliqem me një sëmundje, infektohem». Mungon te G. Meyeri. E ka Bashkimi si *práj*, me *prâ* «infettare», *prâhem*, *m'u prâ* «rimanere infetto»; Cordignano *me gojë të prâjtme* «con bocca immonda, infetta», *i prâjshëm* «contagioso»; Gazulli ka *i prâm* «i përlyem»; edhe *ai âsht i prâm prej lëngatës së thatë*, e *prâjë* f. «të përlyem, infekcion», postverbal më -ë, i shpeshtë në gjuhën shqipe. Pas Leottit e ka dhe toskërishtja, si *prënj* po me kuptimin e geg. *práj*. Sh. edhe *prënjké*. Është një kompozit me *për-i ënj ënjt âj*, fjalë e afër me lat. *aemidus*, «tumidus, inflatus, gr. οἰδάω «ënjtem, fryhem» οἶδος «lungë», arm. *aitnum* «ënjtem» etj., po me një kuptim të fëlliqjes që del dhe në gjerm. e lartë të vj. *eiz* «lungë me qelb», gjerm. e sotme *Eiter* «qelb-i». Nga kjo anë *práj prënj* afrohet brenda gjuhës më fort me *end* «pështyn miza mishin», që edhe kjo hyn në këtë grup fjalësh. Raporti formal midis *práj* e *end* është ai që çfaqet dhe te *dej: dënd, lej: lind* etj. Më anë tjetër *práj* «infektoj» është etimologjikisht identike dhe formalisht e barabartë me *práj* «pushoj së foluri, hesht; pushoj» pa *prâ* «pareshtur, vazhdimisht» tosk. *prej prej* «kënaq, gëzoj» *prehem prëhem* «shlodhem, pushoj; kënaqem»: Edhe kjo fjalë pas mendimit të përgjithshëm lidhet me *âj ënj ënjt*.

**prandáj prandéj** «nga ky shkak, për këtë arsye». Pas G. Meyerit 11 (më parë Kamarda I 306) nga *për andaj*, ku *andaj ndaj* ka kuptimin e *prandaj* dhe lidhet me *andej këndej* etj. E thjeshta *andaj* del pranë *prandaj* që te Bogdani (I 30, 50; II 30,13): *Andaj bijenë lodertivet* «per il che sonano gl'instrumenti»; *Prandaj të përkorëtë e të dëlirëtë janë gëzueshim* «Pero li sobrij, e continenti sono allegri». Edhe në të folët e sotmë të Gjirokastrës pranë kompozitit *pandaj* (nga *prandaj*, me rënie të *r-së*) ruhet e thjeshta *andaj* e *ndaj*. Grigori për *prandaj* përdor *pra andaj* «λοῖπόν» (p.sh. 23, Mateu 8, 11; 616, Galatët 4,21). Me gjith'atë *prandaj* gjan të jetë *për andaj* me *për*; khs. *pasandaj mbasandaj* e *parandaj*, me *pas- mbas-*, *parë- para-*, sot geg. *parandéj* «më përpara».

**prase** «s'ka gjë, s'prish punë» (përgjegje zemërimi për një punë të keqe që na bën tjetri, a për një fjalë të keqe që na thotë). Fjalë e tosk. jugore (Gjirokastrë). Në Myzeqe *pranç*, ashtu dhe në Seman të Fierit (J. Thomaj, Bul. i Univ. Shtet. të Tiranës, Ser. Shk. Shoq. 4, 1961, f. 150): *pranç dhe n'e shave*. Është një nga ato fjalë që kanë dalë nga bashkimi i dy fjalëve në ngërthim të fjalisë, si *druese, mbase, pondë, shklata* etj. Kështu *prase* u formua një fjali si *pra se ma bëre kështu; pra se ma the këtë fjalë*. E *pranç* në fjali si *pra në ma punove kështu; pra në ma the këtë fjalë*; -ç-ja fundore do t'u ketë formuar në fjali që përmbanin dhe përemrin pyetës ç çë. Në Gjirokastrë për «prase» thonë dhe *praseqish*, p.sh. *s'ka gjë, praseqish* (me zemërim a keqardhje). Ka dalë nga *pra se qish*, ose nga *pra se q'ish (ashtu)* etj.

**prashhtë, prazhdë** f. «hobë, bahe». Mungon te G. Meyeri, me gjithë se del që te Danieli (1802) për arom. *ghiulea* «gjyle», sh. Papahagi, Scriitori aromâni 283. Si fjalë e toskërishtes lindore rrjedh nga bullg. *praštva*, bullg. e vj. *prašta* «σφενδόνη», me *št-në* karakteristike të bullgarishtes, serbokr. përkundrazi *prača* (sh. *plesht* II). Fjala bullgare ka shkuar dhe në rumanishten (*praştie*) me aromunishten (*proaşte proaşti*), sh. G. Meyer Alb. Studien IV 112, Rosetti Influença 41, Ist. li. rom. III<sup>4</sup> 65.

**pregjím** m. «festa e lindjes së djalit, poganik». Te G. Meyeri 352 ka mbetur e paspieguar. Endzelini (KZ 45, 230; te Müblenbach-Endzelin I 550) e afron me lit. *gemù gimti* «lehem, lind», let. *dzemu dzimt* «idem», prus. e vj. *gimsenin* «lindje» *gemton* «me le, me pjellë» etj. Pranuar te Pokorny I 465 e te Fraenkeli 151, e me rezervë dhe te Walde-Pokorny I 676; po kundërshtuar te Pedersen, Krit. Jahresbericht XIII I 256.)

Sikundër e vuri re edhe Hahni (f. 105), është fjalë e gegërishtes (Shqipëri e mesme e veriore); Toskëria kësaj feste i thotë *poganík poganíqe* (sh. këtë fjalë). Del sëpari te Bogdani (I 26,10): *e mbassi kjenë mbaruem ato gazëmende të Përgimevet* «e doppo esser finite quelle allegrezze Natalitie». Ky autor duket ta këtë marrë fjalën në Shkodër, ku ruhet edhe sot, si *pergím pergím prgím*, ndër muhamedanë e katolikë. Te të parët, sipas H. Koplíkajt (Illyria I Nr. 44, f. 8), *përgím* i thonë gostës që shtrohet në shtëpinë ku ka lerë një fëmijë, për nder të s'emës së lehonës (në mungesë të asaj, për nder të një tjetre grua të shtëpisë së saj), e cila me këtë rast bën të parën vizitë në shtëpi të të dhëndrit (me përjashtim të ndonjë morti). Pokështu ndër katolikë, ku ndërkaq plurali *përgjímjet* shënon peshqeshet që çon e ëma e lehonës; sh. Xh. te Leka IX 177, dhe Illyria I Nr. 16 f. 8. *pergím* e ka për Veri edhe Kurti II<sup>1</sup> 122. Me këtë rast i vihet edhe emri fëmijës. Prandaj në Shqipëri të mesme, si në Peqin e gjetkë, *përgjím* është festa që bëhet të tretën, të shtatën o të nëntën natë pas lindjes, kur i vihet fëmijës njëkohësisht edhe emri. — Për të arritur te kuptimi i parë e me këtë edhe te burimi i fjalës duan pasur parasysh të dhënat e etnografisë. Në Shqipëri festa e poganikut bëhet më e madhe për lindjen e një djali, e sidomos për lindjen e djalit të parë. Këtë gjë e vuri re mirë edhe Hahni, i cili *pregjím* e jep si «Gastaml bie der Geburt eines Erstgeborenen», pra si «darka që shtrohet me rastin e lindjes të së parit lerë», kështu pas tij dhe G. Meyeri. Prandaj *pregjím përgjím përgím* nuk është gjë tjetër veçse gr. *πρωτογέννημα* «lindja e parë». Si fjalë e gegërishtes, ky huazim, pas kriterëve që ka shtruar Thumbi (IF 26, 7) m Joklin (IF 44,38), është mjaft i vjetër në shqipen; i përket periodës mesjetare bizantine, një faze më të moçme të greq. së re, mbase edhe greq. së mesme. Me këto të dhëna të shqipes pajton dhe kronologjia e fjalës në greqishten: *πρωτογέννημα* del në Dhjatën e Vjetër e të Renë, vijon te Klement Aleksandrini dhe arrin gjer tek Eustath Ponemation (shek. i XII), sh. Dimitrakos VIII 6316. Nga pikëpamja kulturore do përmendur se bash sfera që i përket në shqipen lindjes e martesës është e pasur me huazime greke, shumica gjurmë të sundimit bizantin e të kishës lindore: *mirë, poganík, pregjím, shpërgá shpagër, prikë përqi, shemër, vë kurorë, fis, gjini gjiri* etj. Për formën e fjalës do shënuar se ajo me fundorin e saj *-im* iu mbështet fjalëve me sufiks *-im*. Format me *-g-* të geg. veriore qëndrojnë ndaj *përgjím pregjím* të geg. jugore si *gem* ndaj *gjemb, kingj* ndaj *qingj* etj.; khs. për këto Bul. i Univ. Shtet. të Tiranës. Ser. Shk. Shoq. 1 (1958) 31v. Më në fund trajtat më për- si *përgjím, përgím*, e disa kuptime si *përgím* edhe «gostë» (*s'm'u gjete kurr as në përgím as në mjerim!*) si edhe «vigilia, ndëja natën zgjuet» te Gazulli, tregojnë se fjala në ndjenjën gjuhësore u përzie me *përgjoj prigjoj*, me *përgjím përgím*, khs. e *kthen e rrin në përgím mbas deret* te Kurti I<sup>2</sup> 152. Ky kryqëzim fjalësh ka lidhje me zakonet e festës së poganikut. Në atë natë gjindtë e shtëpisë rrinin zgjuar një copë herë të madhe duke përgjuar mos vinin vitoret (fatitë,

mirat) për t'i caktuar fatin të porsalindurit. Khs. edhe Hahn I 148. — E të njëjtit burim grek, po më e re se *pregjím*, është tosk. *protoene*, sh. këtë. Te kjo fjalë edhe ruajtja e formës dëshmon për një moshë të re përkundrejt *pregjim*-it, që si një huazim i vjetër ka pësuar një ndryshim mjaft të madh të trajtës së hershme.

**prehalohem** «mbarohem shtatit, fytyret, bëhem i hajthëm, ligem»; *prehalic*, *prehaluq*, *prehaluk* «me fytyrë të prehët, të mbaruet». Kjo fjalë që jep Gazulli për geg. veriore është një kryqëzim i *prehem* «ligem» e *halë* me kuptimin e së hollës; khs. dhe *i hajthëm*.

**prehër prëhën** m. «pjesa e trupit prej barku e gjer në gju, pëqi; pjesa e përparme e petkut që i përket prehërit; një *prehër grurë*, aq sa mban një përparje». G. Meyeri (f. 353, Alb. Studien III 68), mbi dëshminë e formave të gegërishtes Rossi *prehende prende*, Borgo Erizzo *prende*), niset me të drejtë nga *prenhen*- si trajtë bazë e nga mendimi që silaba e parë përmbante në krye të herës një *-e-*, po më tej e afron fjalën me sllav. e vj. kishtare *prega* «mbrej, ndjej», serbokr. *pregača* «përparje». Ky spjegim nuk shohim të jetë pranuar gjëkund nëpër fjalorët etimologjikë krahasimtarë.

Fjalë e mbarë gjuhës, një neutër i vjetër, sh. Bul. për Shk. Shoq. 3 (1955) 41. Buzuku (XIII, Psalm 128,7) *e n si aj qi vë me e ndukunë s mundë mbushnjë dorënë e ti, as aj qi bân duorzëtë s mujti me mbushunë prehënitë e ti* «de quo non implevit manum suam qui metit, et sinum suum qui manipulos colligit». Budi (CD 215b) *E mbë prehënë e vū*; Bardhi Sinus *Prehëni*. Vokalin nazal e tregon qartë *prenhën*- «seno» e Bogdanit (II 95,8). Në Atikë *prëhërë* (Weigand, Balkan-Archiv II 179), në Kalabri *ndë prëhërin* «in grembo» (Kamarda II 114). Për nga forma *prëhën* *prehër* paraqitet si një emër më *-ën -ër* i tipit të *dimën dimër*, *gjarpën gjarpër*, më të vjetra forma më *-ënë -ërë*, për të cilat sh. G. Meyer Alb. Studien I 54 v. — Afrimi me fjalën sllave, të cilën e përqasin me lit. *springstū* «mbyt», gjerm. *Sprenkel* «laku i gjatarit për të zënë zogj», nuk përlligjet aspak nga ana e kuptimit dhe paraqet vështirësi për nga forma. Më afër menç është që *prehën* *prehër* të përmbajë një kuptim më të vjetër «pjesë e fryrë e trupit, fryrje». Kështu *prëhën* *prehër* lidhet përbrenda gjuhës me *âj ënj ënjt*, *âhem ëhem*, ku vendojnë edhe *prâj prëj prehem*, e ku hyn edhe *prâj* «infektoj», sh. këtë fjalë.

**prësnik** m. «kulaç i misërt». Fjalë e dialektit të Dibrës, e paregjistruar gjer më sot. Për arsye dialektgjeografike nga bullg. *prësnik* «i ndormë, pa tharm». Për fjalën bullgare sh. Mladenov 534, Vasmer REW II 429. Edhe *kulaç*, *pogaçe* e *karvele* janë huazime sllave; sh. për këto Selishev 155.

**prëcônëzë** f. «lëfyti i një ene». Këtë fjalë të shqipes së Greqisë, që e ka Reinholdi 52, G. Meyeri Alb. Studien V 99 e lë të paspieguar. Është postverbali i *përçoj* «prij, udhëheq» me kuptimin e *çoj* «shpie, përcjell». Pra lëfyti është quajtur nga të përcjellurit e ujit që përmban ena. Në dialektet shqiptare të Greqisë *për* si parafjalë e si preverb paraqitet shpesh në trajtën *prë*: *prë*, *prëshkonj* etj., sh. G. Meyer 408, Alb. Studien V 98. Te *prëcônëzë* ndrimi i ç-së në c (në qoftë se fjala është dëgjuar mirë) i detyrohet ndikimit të rrethit grek, ku ndodh rregullisht ky ndrim. Sufiksi *-zë* është shpesh në emra veglash e përdorsesh, sh. Xhuvani-Çabej Prapashtesat 108.

**prime** fpl. «mjekime të mjekësisë popullore, me yshtje e të tjera

mjete kësodore». Mungon te G. Meyeri. E kanë ligjërimet gege kryesisht të Shqipërisë së mesme; në Elbasan *prime plakash*, te Shp. Bardhi (Leka VII 482) *shkrime e prime* për «nuskat e hoxhëvet a të dervishëvet dhe për frymën e magjit e shortarëvet». Etimologjia e drejtë gjindet te Logoreci f. 94 e njëkohësisht dhe te Shp. Bardhi HD XI 464 : *prim* m. postverbal më *-im* i *me prue*, *pruej* «ruaj nga një sëmundje», *më e prue prej shitës, prej shplakës*; te Gazulli *proftët Zoti! të proftë* «të ruejtët Zoti», *me prue këndin* «m'u ruejtë si, gjerm. auf seiner Hut sein, it. stare all'erta». Te Budi (RR 275) ruhet emri verbal: *E ashtu ende këto kongjuracione e të pruojtuna thotë se prifti duhetë t'i zgjedhë bukur dëlir, e hieshim*. Verbi *me prue* paraqet trajtën e re të përvojës që ka Buzuku (nga lat. *parare*), e cila sot përdoret përgjithësisht si *mbroj mproj*. Emri *prime* shënon mjetet konkrete të mjekimit popullor, ashtu si *mjekime-t* te G. Meyeri 282. Si fjalë është më e re se të *pruojtuna-t* e Budit. Nga *prime* u degëzua mënyfund *perime* si një fjalë më vete, sh. *perime*.

**prish** «shkatërroj, rrenoj; shpenzoj, harxhoj, thyej (pare); dëmtoj; vras, zhduk»; *prishës* m. «ai që harxhon shumë e pa nevojë»; *prishje* *prishële* f.; *prishë* f. «shkatërrim i një shtëpie»; *i prishur* «prishës»; *të prishura* fpl. «shpenzime»; *prishalësh* m. «ai që rreh leshin e pambukun me hark»; *prishaplangas* m. «plangprishës»; *prishaqefas* «kundra dëshirës, çartakandas»; *shprish* «shkriftoj, shtie (leshin)»; *shprish tokë* «çel tokë të re», *shprish* intrans. «ha mëngjes»; *shprish* në Itali për «prish», në Molize «përhap, pështjelloj», Lambertz KZ 53,300; *shprishem* «shkul flokët, gris petkat në vaj e sipër», në Itali për «prishem»: *u shprish gjaku i Arbërit*; *shprishë* f. «buka e mëngjesit, kafjalli»; *shprishun* «kryejashtë, pa kësulë»; *me flokë të shprishun* «me flokë të ngatërruar»; *shprishalësh* m. «gërhanë, shutër». Te Bogdani *çprish: përse po çprishënte lijnë tyne* «perche guastava loro la legge» (II 28,7). G. Meyeri 353, duke u nisur nga një bazë \**pris-*, e afron këtë fjalë me gr. *πρίω* «sharroj; zgërdhihem», po këtë afrim ai vetë më vonë (Alb. Studien III 61) e gjen të dyshimtë. Pranuar te Boisacq 813, e me rezervë dhe te Pokorny I 846 e te Hofmann GEW 284, ky krahasim gjen kundërshtim te Walde-Pokorny II 89. E pranon ndërkaq edhe Jokli (Studien 72v.), po njëkohësisht e zgjeron duke përfshirë dhe saks. e vj. *frësa* «rrezik, rrezik kreje», got. *fraisan* «me provue, me shqyrtue».

Fjalë e mbarë gjuhës. Budi (SC 101) *kamatnikëtë, kusarëtë, e grabitarëtë, zotënitë e këqit, e të pamëshërier, qi prishnjënë, e rjepënë vobëzënë*. Kuptimi i parë i fjalës nuk duket të jetë ky i sotmi; kështu Bardhi për lat. *destruere* ka *me e renuem, me e çartunë, destructus renuem*. Pas gjithë gjasësh *prish* ka pasur një kuptim më konkret, dhe arriti në këtë të sotmin afërsisht ashtu si *grij* «pres hollë, copëtoj» e «ha, brej, prish; vras» e si *dërmoj* «bëj copa-copa të vogla, thërmoj» e «rrah shumë; shkatërroj». Kështu *prish* ka dalë nga *prisha*, forma e aoristit të *përshij* «thërmoj, bëj (bukën) përsesh», një kompozit i *shij*. Për *përshij* : *prisha* (sot *përshiva*) khs. *gërshas* : *grisha, këlthas: klitha* etj. Shqipja ka dhe të tjera verbe, ku forma e prezentit ka dalë prej aoristit ose prej participit, khs. *njom*. Për kuptimin do pasur parasysh se edhe *përshësh*, i cili është një postverbal i *përshij*, ka arritur në ndonjë përdorim të figurshëm që i afrohet të *prishurit*, si në frazën *gjen shesh pa bën përsesh* që Mitkua (15,134) e jep me « *εὐρίσκεις ἴσιωμα καὶ κάμνεις ἀνώμαλον* ». — Medialin *prishem*

me kuptimin «shkulem, emigroj», te Kristoforidhi «ἐξοδεύομαι», në Greqi ashtu uprishnë edhe këta e vanë ndë dhe të huaj (te G. Meyer-i, Alb. Studien V 32), Jokli e afron më fort me gjerm. e lartë të vj. *firren*, nord. e vj. *firra* «me largue», duke gjetur te fjala e shqipes një mbeturinë të komparativit të moçëm; pra *prish* «shkatërroj, rrenoj» e *prishem* «shkulem, emigroj» janë sipas tij të afra midis tyre për nga rrënja, po të ndryshme për nga forma. Në këtë mes do shënuar se përdorimi «shkulem, emigroj» që ka *prishem* është një «kuptim okazional», që si i tillë nuk është i vjetër. Zhvillimi i konceptit të së lënit t'atdheut e të daljes në dhe të huaj, nga ideja e prishjes, është i natyrshëm, e veçanërisht afër menç për mendësinë e Shqiptarëve, një popull që edhe në dhe të huaj e ka kujtuar ngulas e me mall vendin e të parëve. Edhe te të tjerë popuj vihet re një mendësi e këtillë. Kështu gjerm. *elend* «i mjerë» vjen nga gjerm. e lartë e vj. *elilenti* «mërgim, dheu i huaj», e *Elend* «mjerim» te Luteri përdoret ende për «dhe i huaj», sh. dhe Kluge-Goetze 129v. Anasjelltas gr. *νόστος* «kthimi në atdhe» e afrojnë përgjithësisht me grupin e got. *nasjan* gjerm. *genesen* «shërohem». Kështu pra *prishem* është forma mediale e *prish*. Kjo vetë një nga ato fjalët e shumta të shqipes, të cilat janë formuar nëpër zhvillimin e brendshëm të gjuhës.

**promák** m. «një vend me ujvarë», në Dukagjin pl. *promiqe*-t. Mungon te G. Meyer-i; e ka Sik, Cirka, III (1938) Nr. 55, f. 287. Si fjalë e geg. veriore, huazim krahinor nga serbokr. *promaha* «kalim, rrymë», sh. Li. Posn. VIII 124. Gjan t'u jetë mbështetur emrave më *-ak*. Plurali me metaforë *a:i* (nëpër *e*) është i shpeshtë në Veri.

**prosék** m. «kasolle ku mbajnë bagëtinë». Mungon te G. Meyer-i. E ka Cordignano si *prosék* «tugurio dove si raccoglie il bestiame», pl. *prosiqe* «sono luoghi piani dove stanno (riposano) gli animali, logje gjajet». Pas hetimeve tona *prosék* në Mat «gardh me hunj», *Proseku* emër vendesh atje e në Mirditë, në Mat e në Dibër, Seliščev 346, A Gazetteer of Albania 136, *Prosiqe* emër are në Apripë të Keqe (Folklorë II 62). Një shumë *proseqe* «ashklat e një druri» e ka sipas Mannit Illyria për të folët e Lumës. Godini sjell vetëm *presék* për gjerm. *Fach* «një e ndarë, syzë, fluer, sirtar». Duke u nisur nga kjo, Seliščevi 151 e spiegon fjalën nga bullg. *preseka* «qafë mali, rrugë në mal, kalim; syri i hambarit». Për arsye kuptimore e dialektogjeografike rrjedh prej serbokr. *prosek* «prerje; rrugë e çelur (nëpër pyll), shtek», sh. Li. Posn. VIII 122. Fjalë e jetës fshatare, me përhapje krahinore të kufizuar.

**prozhëm** m. «pyll i vogël ku presin dru; korië». G. Meyer-i 355 e jep pas Rossit me trajtën *proshëm* dhe mendon — me dyshim — për një burim nga sllav. *šuma* «pyll». Barići përkundrazi (I 75, Arhiv za arb. starinu II 84) gjen aty një fjalë vendi të shqipes, e zberthyeshme në *pro-shëm* dhe kështu me pjesën rrënjore *-shëm* e afër me fjalën sllave; baza e saj sipas tij një \**kseu-mā*. Seliščevi nuk e numëron ndër sllavizmat e shqipes.

Formën më të vjetër të fjalës e gjejmë te emri topik *Brostema*, që del te Katasta e Shkodrës e vjetëve 1416-1417 si *posto in luogo dicto Brostema* (Cordignano, Catasto veneto di Scutari e Registrum Concessionum 60) e që do të lexohet afërsisht *Bróshhtëma*. Del pastaj te Bogdani (II 47,4): *Ndë një dhe ishinë do proshma* «In un paese erano due boschi». Vjen nga sllavishtja: serbokr. *brst* «syth, bulë» *brstina* «gjethe», bullg. *br̄s(t)* «gjethe për bagëti», slloven. *brst* «bulë, syth, kar-

thje» etj. Në vokal afrohet me format sllave jashtë Ballkanit, si rus. *brostъ*, sllovak. *brost*. Prandaj rrjedh nga një sllavishte ballkanike pa-raserbokroate e parabullgare; ose, si fjalë krahinore e Veriut, nga një fazë më e vjetër e serbokroatishtes; për një huazim mjaft të moçëm flet edhe ndrimi i s-së sllave në sh. Në toponiminë e sotme të vendit më një anë na çfaqet trajta e re, e dalë nga apelativi, *Prozhmja*, lagje në Shullaz të Milotit; më anë tjetër ruhet trajta e plotë *Broshtan Proshstan* në Toskërinë lindore (Selišček 275 4c), te *Gazetteer of Albania* 18, 110 *Çuka e Mbroshtanit (Broshtanit)*. Sa për reflektimin e sllav. *b* (para *r*-së) me *p*, kjo ka lidhje me ndryshimin që ekziston në mënyrën e artikulimit të okluzivevet në sllavishten e në shqipen, ndryshim që e shënon Weigandi (Alb. Gram. 7) e Jokli LKU 74,299; khs. për këtë edhe *proçëmë* nga serbokr. *broç*, te G. Meyeri 355. Sibilanti i zëshëm te *prozhëm* përkundrejt *proshëm-it* të dikurshëm sqarohet me tendencën e ditur të dialekteve veriore; këtu përveç kësaj ka ndikuar dhe afërsia asimiluese e *m*-së. Më në fund, për morfologjinë e fjalës do shënuar se sufiksi *-m* duket se u ka shtuar në shqipen. Te *Broshtëm (Brostema)* ra *t*-ja rregullisht në një grup tri konsonantesh, duke u arritur kështu te *prozhëm-i* i sotmë.

**prozhmój** «marr nëpër gojë një njeri, flas keq për të»; *prozhmím* m. «bigoni». G. Meyeri 355 e gjen në shkrimet e Propagandës dhe e spiegon nga sllavishtja: sllav. e vj. kishtare *šumъ* serbokr. *šum* «kris-më, zhurmë» *šumeti* «me ushtue, me gjëmue, me murmurue», duke afuar për kuptimin it. *mormorare* që do të thotë dhe «me pëshpëritë, me folë keq». Seliščeku nuk e shënon ndër huazimet sllave të shqipes. Kamarda (I 322) jep për Shkodër *proshimój* «io mormoro, calunnio» dhe e krahason këtë me një gr. *προσιμώω (σιμόνω* është «afroj»!).

Një vështrim i formave dialektore shpie në një tjetër gjykim të kësaj fjale. Te një studim më i vonë i G. Meyerit (Alb. Studien VI 52), në një këngë popullore prej Veriu gjindet *Çati Hyseni po prezhmoin: ç'ke ti Hysen që nuk martone?* Gjithë këto trajta: *prezhmoj, proshmoj, prozhmoj, proshimój* pihen te *përçmoj* «përbuz, s'e vë në hesap, s'i jep vlerë një gjëje a një njeriu; shëmtoj», te G. Meyeri 416 «shnderoj», te Lambertzi 149 «schätze gering», te Kamarda (I 134) *përçëmtoj* «io disonoro», një kompozit i *çmoj*. Në këtë kuptim negativ të një kompoziti të *çmoj* me *për* mund të kenë ndihmuar verbe semantike të afra, si *përbuz, përqell, përqesh*, për të cilat khs. Xhuvani-Çabej, Bul. për Shk. Shoq. 4 (1956) 88v. Po *përçmoj* me kuptimet e saj është e spjegueshme dhe me mjete të veta, pa ndërhyrje të ndonjë analogjie. Vetë primitivi i saj *çmoj* mund të ketë arritur në ngërthim të fjalisë te një dobësim i kuptimit, në shprehje si *me e çmuem pr asgjë* te Budi SC 101, e krahasueshme me lat. *parvi aestimare*; prej andej *Po e shājnë e çmojnë* DC 193b. Nga një primitiv me të tilla kuptime u formua *përçmoj*, ku preverbi *për-* funksionin e tij intensiv e ushtroi dhe më në këtë drejtim të përbuzjes. Edhe në gjuhët romane lat. *aestimare*, nga e cila rrjedh në analizë të fundit dhe shq. *çmoj*, ka dhënë ndonjë kuptim të këtij lloji, si *adaestimare* ven. e vj. *asmar* «shtihem, shtirem» (Meyer-Lübke REW 139). — Për formën e *proshmoj, prozhmoj* përkundrejt bazës *përçmoj* do shënuar se zëvendësimi i elementit *për-* me *pro-* te *prozhmoj* rrodhi nga një ndikim i *prozhëm-it*, ose me analogji pasçiftesh së tilla si *përshut, proshut, përvanue, provanue, përvoj, provoj*. Për fonetikën do vënë re se afrikata *ç* zbutet shpeshherë në *sh zh* përpara një konsonanti, khs. *shklata* nga *ç kle ata, zhdo*

nga çdo. Kthimi i *sh-së* në *zh* te *proshmoj*: *prozhmoj* ndërkaq spiegotet ashtu si te *prozhëm*. — Shoh tani se spjegimi i drejtë i *prozhmoj* nga *përçmoj* gjindet sëpari te Xhuvani Bul. për Shk. Shoq. 1 (1956) 106, Stud. gjuhësore 119v.

**pulláz** m. «çati»; **pullazinë** f. «dërrasë që shtrohet në çati përmbi qepra, hartosë». G. Meyeri 356 e lë pa spjeguar, vetëm shënon se Rossi ka *lëpozë* për «pullaz, çati». Një lidhje të së dy fjalëve pranon edhe Jokli (LKU 86 vv.); sipas tij *pullaz*, te Kristoforidhi *pulas*, ka dalë nga *lëpozë* me metatezë, me ndrim të *-ë-së* në *-u-* në silabë paratheksore e me *-az* si te *unazë*, pra përfutur me shpërnguljen e theksit në silabë të parafundit.)

Pa dyshim *pullaz* e *lëpozë* janë dy fjalë të ndryshme. Për nga kuptimi *pullaz* është çatia e shtëpisë, *lëpozë* *lpozë* tavani i odës. Formalisht nga *lëpozë* nuk arrihet te *pullaz*, vështirësitë fonetike janë të pakalueshme; likuida e *pullaz-it* është velare kudo, *pulas-i* i Kristoforidhit me *-l-në* e tij nuk vërtetohet gjëkund; edhe silabat fundore të së dy fjalëve nuk pajtohen. Është identike me *pëllas* «pallat», kjo nga lat. *palatium*. Labializimi i *-së* në *u* në silabë para theksit, mbase në ndikimin dhe të labialit *p* që i printe, përveç se te *pullaz-i* i geg. veriore, çfaqet dhe në arbërishten e Italisë: në Kalabri *puγás*, në Molize *puás puasë*, *puγás* (G. Meyer 319, Lambertz KZ 53,296), te Cirese 46 *Njoi puγasë ku t u stis* «Ecco il palazzo dove ti è stato innalzato» (*ku* për «që»). Format e këtyre dialekteve, të cilat nuk mund të ndahen nga *pullaz*, vërtetojnë dy gjëra: e para — me spirantin gutural të *tyren* — karakterin velar të likuidës (*moγa* për *molla*, *dieγi* për *dielli* etj.); e dyta, me kuptimin e tyre «pallat», karakterin sekundar të domethënies «çati» që ka *pullaz-i*. Ngushtimi i domethënies nga «pallat, shtëpi» në «çati» ndeshet dhe gjëtkë: frgj. *dóme* prov. *doma* «çati e ulët, çati me gungë» nga gr. *δῶμα* «shtëpi» (Meyer-Lübke REW 2730). Edhe vetë lat. *palatium* në dialekt të Raguzës ka dhënë *palata* «kupë e qiellit (Pušcariu te Meyer-Lübke REW 6159). Pokështu dhe rus. *polata* «dhomë, sallë» nga gr. *παλάτιον* ka arritur si pl. *polati* te «skele dërrasash, dërrasim nën dysHEME midis furrës dhe murit» (Vasmer REW II 391). Në pikëpamje objektive do përmendur se latinishtja i ka dhënë shqipes një pjesë të mirë të fjalorit që ka lidhje me ndërtimin, si *gëlqere*, *kulm*, *pëllas*, *qepër*, *tjegull*, *tra*, edhe vetë *shtëpi-në*. Më në fund, për fonetikën shënojmë se *-z-ja* fundore te *pullaz*, përkundrajt *-s-së* së *pëllas-it*, ka ndjekur prirjen e geg. veriore për të ndërtuar në të zëshme konsonantet e pazëshme në fund të fjalës.

**punë** f. «vepër; gjë, çështje; bela, ngatërresë; shkak, arsye», *punó*; *punëtór* *puntúer* m., edhe mbiemër; *punëtó* «shërbej»; *punëbardhë* «fatmirë, i lumtur»; *punëzi*, fem. *punëzëzë* «fatkeq, fatzi»; *punëbukur*; *punëpastër*; *punëherë* f. «epilepsi»; *punësë* f. «tokë buke»; si neologjizëm «punë, vepër», neologjizma edhe *punëdhënës* m., *punëtor* f., *punishte* f. Kundra mendimit të mëparmë (Hahn I 251 e të tjerë) që kjo fjalë afrohet me gr. *πόνος* «punë e rëndë, mundim, brengë», që nga G. Meyeri (f. 357, Alb. Studien II 28) e këtej pranohet pothuajse përgjithësisht që kjo fjalë, si refleksi i një baze \**spud-nā*, afrohet me gr. *σπεύδω* «nxitoj, shpejtoj; përpiqem, mundohem, jam i zellshëm, synoj» *σπουδή* «nxitim, të ngutur; zell, përpjekje, orvatje». Khs. Pedersen KZ 38,200, Boisacq 895, Walde-Pokorny II 659, La Piana (Studi ling. alb. I 73, Studi ling. alb. Varia 23), Hofmann GEW 328, Vasmer REW II 461, e me rezervë dhe Pokorny I 998, që vendos

si bazë një \**puđnā*. Mendimin e Bugges që këtu paskemi një huazim të shqipes nga *πόνοσ* e greq. së vjetër (Bezenbergers Beiträge XVIII 188v.) e kundërshton G. Meyeri vetë (Alb. Studien IV 45) si dhe Thumbi IF 26,2. Krahasimin e *punë*-s me lat. *opus* «vepër» që bën Barići (I 86), e lëfton me të drejtë Tagliavini 232. Poashtu bie, për arsye të kuptimit e të formës, dhe afrimi me gr. *πυγμα* «grusht», lat. *pugno* «lëftoj» *pungoj* «thumbuj, shpoj, ther» që bën Treimeri KZ 65,94.

Fjalë e mbarë gjuhës. Për përdorimet e saj sh. Pedersen 181v., A. Sirdani Leka VI 128vv.; për kuptimin «punë»: «gjë» në gjuhët ballkanike Sandfeld 138, për «punë e madhe» po në ato gjuhë P. Papa-hagi, XIV. Jahresber. d. Rum. Inst. Leipzig 119. Del që te Buzuku, p.sh. (LXXIX = LXXXIX, Marku 6,17) e shtiu ndë burg nlidhunë, për punë të Herodianësë «et vinxit eum in carcere propter Herodiamdem»; Budi (SC 313v.) *vrānē një nierī natēnē ndē shtëpi të vet, e mbas disa moti si u ndje e u provuo puna, mb ate ças qenē zanē të dy e gjukuom mbē mortē shemptuome*. Bardhi Arare Me *punuem*, Bogdani (II 108/2) *Qish anshtë këjo punē qi më thonē për tÿ? «Che cosa è questa, che di te mi viene detta?»* Si e kemi spieguar shkurt dhe në Bul. për Shk. Shoq. IV (1953) 31v., koncepti i punës në shumë gjuhë ka dalë nga ai i mundimit, i barrës; khs. lat. *labor* «mund, mundim; barrë, brengë» që në disa gjuhë romane ka dhënë emërtimin e zakonshëm të punës (it. *lavoro*), lat. *tripaliare* «me torturue»: frgj. *travailler* «me punue» (Meyer-Lübke REW 8911); nga gjuhët sllave rus. *trud* «punë, mundim», në të tjerat gjuhë sllave më fort «mund, mundim»; serbokr. *teža* «të rëndët» *težina* «peshë, rëndësirë, barrë»: *težak* «bujk». Khs. dhe got. *arbaiPs* «mund, mundim» e «punë»: e nga shqipja vetë *punon e rëndon* «punon shumë, punon rëndë», ku *rëndon* ka dhënë kuptimin e punës. Në këtë sferë semantike hyn edhe *punë*, të cilën e gjykon kështu dhe C. Racoviță, Bull. Ling. VII (1939) 98, sh. II XXV VII 251. Në këto rrethana *punë*, si «të rëndët, mundi» e si refleksi i një baze \**puđnā* «peshë, rëndësë», afrohet me lat. *pendo* «peshoj, çmoj, paguaj» *pondus* «peshë»; ose lidhet, si \*(s)*puđnā*, me gr. *πόνοσ* «punë e rëndë, mundim, brengë», fjalë gjer sot etimologjikisht e pasqaruar. Kështu spjegimi i kësaj fjale të shqipes kthehet më një farë mënyre te mendimi i Hahnit. Te *punë* n-ja që nuk pësoi rotacizëm në toskërishten, ka rrjedhur nga -nn-, kjo nga asimilimi progresiv i grupit -nd- ose (më lashtë) -nt-; -un- është refleksi shqiptar i nazalit sonant.

**push** m. «qimet e holla e të buta që mbulojnë një stofë; qimet e imta e të buta që mbulojnë lëkurën; fijet e imta që mbulojnë gjethet, e disa pemë, si pjeshkën, ftuan etj.»; *pushem* «më del pushi»; *pushaták* «që është i mbuluar me push» (për një njeri). Ndërsa Kamarda (I 345) e afronte me gr. *πόξ πόκος* «një bashkë lesh», G. Meyeri 359 e spiegon nga turq. *puş* «mbulues, mbulesë», e cila sipas tij ka dhënë dhe bullg. *poš* serbokr. *poša* «shami krepit, çallmë», gr. e re *πόσι* «çallmë».

Fjalë e mbarë gjuhës, edhe e kolonive të Greqisë e t'Italisë. Për Molize (Itali) e dëshmon Cirese 22: *njëja dishë i bëja sakonën me pusht* «all' una vorrei fare un materasso di lanugine». Për pushin e mbretëreshës së bletëve khs. I. H. Hyseni (Kop. letrar I 2): *kur ásht e ré trupin e ka të veshëm me push e krahat të mbushme e të pa çqerme*. Godini jep dhe një *pushajijë bushajic-i* «Badmantel». — Burimi turk përjashtohet a priori, huazimet turke nuk kanë pësuar në shqipen ndry-

shime kuptimore të forta. *push* është fjalë e fondit të trashëguar, e afër me rus. *push* «push», *pušiskъi* «pushatak», pol. *push* «avull që çohet përpjetë, push», lit. *paustis* «qime shtazësh» *paustele* «push (i shtazëve)». Dikur me fjalën balto-sllave krahasonin dhe ind. e vj. *pūchas* «bisht, vishkull», grupin e gjerm. *Fuchs* «dhelprë» etj., sh. Walde-Pokorny II 82v., Pokorny I 849. Tani kufizohen më fort te një barazim midis sllavishtes e baltishtes; khs. Endzelin Ann. Acad. Scient. Fenn. 27 (1932) 22vv., Vasmer REW II 470, Fraenkel 554. Në këtë konkordancë parciale do venduar tani si pjestare e tretë edhe shqipja, e cila merr pjesë disa herë në barazimet balto-sllave. Si bazë të fjalës sllave caktojnë një \**peukso-*, \**poukso-*. Shq. *push* ka dalë nga një \**pukso-* ose \**pusk-*, me ndrim të grupit *ks* ose *sk* në sh. Sh. për këtë dorajdorën shënimet tona në Li. Posn. VII 182. — A është një me këtë edhe fjala *push* «karthje pishash» e shqipes së Atikës (Laographia II 111), kjo gjë mbetet fort e dyshimtë.

*pushtój* «marr një vend me armë, zптоj; rrok me krahë (p.sh. një dru, një pemë); rrok në qafë, përqafoj»; *pushtohem* «rrokem, përqafohem me një»; *pushtim* m. «të pushtuarit e një vendi, zptim»; i *pushtueshëm* «i fuqishëm, omnipotens». Për këtë fjalë mendimi i G. Meyerit (f. 359, Alb. Studien IV 10) që kjo i përket *pushtet*-it nga lat. *potestātem* nuk shohim të ketë ndeshur në ndonjë kundërshtim. Weigandi (Balkan-Archiv I 261) te *pushtoj* gjen një denominativ të *pushtet*-it më -oj, e spiegon pra nga një \**pushtëtoj*. I padiskutueshëm bashkimi i *pushtoj* me tosk. *poshtroj* te Kristoforidhi 339, në qoftë se *poshtroj* nuk është një gabim shtypi. Për *pushtoj* «pështet» që trajton Jokli (LKU 250) sh. *pështet*.

Fjalë e mbarë gjuhës. Buzuku (LXXXVI = CVI, Mateu 5,4) *Be-kuom të butëtë, përse ata të pushtonjënë dhenë* «Beati mites quoniam ipsi possidebunt terram»; Budi (DC 201b) *Ndër të tjera regjënī Ke magjypëtë pushtojnë*, intrans. për «zotërojnë, sundojnë»; Bardhi *Invictus I pāgallēnjyeshim, i pāpushtueshim, Possidere Me e pushtuem*, Possessor, Praetor *Pushtues*; Bogdani (I 181 Ligj. VI; II 28,6) *Çezari pushtoj e munjti Pompejnë ndënë Gjytet të Durëcit nd'Arbënë* «Cesare superò Pompeio sotto la Cittā di Durazzo in Albania», ... *Ottaviani... pushtonte gjithë Shekullinë* «Ottaviano... possideva tutto il Mondo»; prej teje *mue ka me lēm aj qi të pushton Israel* «ex te mihi egredietur qui sit dominator in Israel». Kristoforidhi e ka për «ἐξουσιάζω, κυριεύω, κατέχω», *pushtoi gjithë dhenë ἐκυριεύσεν ὅλην τήν γῆν*, *pushtoi gjithë gjën'e tī κατέχευ ἅπασσιν τήν περιουσίαν*, *pushtoj rrápinë* «pushtoj drun'e rrapit». Kuptimi «përqafoj» te Danieli (sh. Papahagi, Scriitori aromāni 176), te Mitko 169 *u pushtuan të tre* për «u përqafuan», emri *pushtim* «përqafim» te Kavalioti (G. Meyer, Alb. Studien IV 10).

Etimologjia latine, e drejtë për *pushtet*, nuk mund të qëndrojë për *pushtoj*. Vetë forma e verbit nuk ka si spiegotet prej atij emri, se nuk ka analogji në sistemin verbal të shqipes; edhe kuptimisht emri nuk arrin të spiegojë domethëniet e ndryshme të këtij verbi. *pushtoj* është fjalë vendi, një zhvillim i *pushtroj* «mbuloj», me rënie të r-së pranë një konsonanti, si shpeshherë; khs. *gak*, *kezë*, e për pozicionin pas një t-je (si te *pushtoj*), *përtyp*, *tokë*, *tendelinë*. Forma *pushtroj* ruhet në dialektet e Greqisë e t'Italisë; për Greqi khs. *pushtro të ligatë* «bedecke die Schamteile» te Reinholdi (Glosari 18), *të më push-*

*trosh me sisë* (Hobhouse te G. Meyer Alb. Studien V 66), në Atikë *malet ishin pushtruarë me re të zeza*, Weigand Balkan-Archiv II 174; te Laographia I 102 e kështu *pushtroj tuti kúrminë asāj* «καί ἔτσι σκέπα σε ὄλο της τό σώμα». Prej Italie e ka N. Figlia, te vargu *E pushtro vilë Vasilën* «Il velo ricopre il Re» (Marchianò, Poesie sacre albanesi 104); de Rada (Skanderbekku i pafaan V, libri IV, hist. IV III 83): *ljëvdīs e i pushtruar kuventit; pushtroj pranë pushtoj* e ka dhe tosk. jugore pas Hahnit («ich umarme, umringe, hülle, schliesse ein»), pra është një nga ato fjalë që i ka të përbashkëta ky dialekt me ato të kolonive të Greqisë e t'Italisë. Forma *pushtroj* nuk është veçse një variante dialektore e *pështroj* me të njëjtin kuptim, si e vuri re sëpari Kamarda I 44. Furikis Αθηνᾶ 45, 143, 168, 56) jep prej Greqie *pështronj ἐπιστρώνω καλύπτω, σκεπάζω* » për Salaminë (Kulluri), atje dhe *Lehona... pështruarë me një plaf të vjetërë* «'Η λεχῶνα... σκεπασμένη μ'ἕνα πλάφι παλιό», *pushtronj* për Kaliven e Kuvarait, Koropin, Menidhin. Në Itali mbizotëron sot *pështronj*. Kështu e ka këtë fjalë Piana dei Greci në Siqeli; ashtu dhe te P. Skirói (Fiala e t'in Zoti II Nr. 26, f. 4, Mateu 17,5; II Nr. 25 f. 4, Luka 8,17) edhe *ish e flisëj, shi' se një rë e ndriçme i pështroi* «Adhuc eo loquente, ecce nubis lucida odumbravit eos», *Pse ngë isht gjë të pështruam çë ngë kat jët sbëluar* «Non enim est occultum, quod non manifesteretur»; *pështroj* edhe te G. Dara. Nga *pështroj* doli *pushtroj* me labializim të ë-së në u në pozicion para theksit, i shpeshtë sidomos para një tingulli labial, khs. *pullaz*. Morfologjikisht *pështroj pushtroj* «mbuloj, mbështjell, qerthulloj» është një kompozit i *shtroj* me *për-* (sh. G. Meyer 418), me rënie të -r-së së preverbit, si te *përshkoj pëshkoj, përse pse, përlej* — te Budi (DC 181a) *të pëlân*. Nga «shtroj përsipër» u arrit në «mbuloj», nga «mbuloj» në «pushtoj». Për kuptimin «mbuloj» khs. gr. e re *ἐπιστρώνω* «shtroj mbi diçka; mbuloj» nga *στρώνω* «shtroj»; prej gjuhëvet romane, në Arbedo *stern* «mbuluar (me diçka), plot» nga lat. *sternere* «me shtrure», Meyer-Lübke REW 8248. Zhvillimi i kuptimit «mbuloj» në «pushtoj» është i shpeshtë. Vetë *mbuloj* përdoret me këtë vështrim; khs. jo vetëm *na mbuloi tymi, po edhe mbuloi gjithë botën* për «pushtoi» në Gjirokastër e në Çamëri, në Elbasan e *mbuloi fukaralleku*, te Çajupi (Baba-Tomorri 24) *Botën me gjak e mbuloval*! Khs. me këto përdorime shprehjen e *pushtoi dhenë* (dimëri) te N. Frashëri, Ist. e Skënderbeut 52 Ndërkaq në përdorimin ushtarak e politik «zaptopj» që mori me kohë *pushtoj*, do të ketë pasur pjesë dhe emri *pushtët*, me anë të një etimologjie popullore. Kjo shihet që te *i pushtueshëm* «i fuqishëm» që del së pari te Bogdani (II 94,5): *tue u dhanë pushtet me shekruem: me ata të njimendë pushtet pra Hyji pushtueshim, me të sijët krijoj Qielltë, e dhenë* «dando loro potestà di consacrare con quella medesima potestà, con la quale Dio onnipotente creò i Cieli, e la Terra». *Me j'zá t'pushtueshëm*, edhe Fishta, I Kryqzuemi. Po Bardhi ka *Potens I pushtetshim, Omnipotens I pushteshim*, që edhe kjo do të lexohet më fort *I pushtetshim*.

*puth; puthit, puthtoj* «pjek bashkë, puq mirë një gjë me një tjetër», edhe *puthós, pëthtoj*. Këtë fjalë G. Meyeri (f. 356, Alb. Studien III 13), duke e çuar te një bazë \**pukō*, e afron me gr. *πυκλός* «i dendur, i fortë; i rrasët; i zoti» *πύκν* «rrasët, kuptueshëm». Mendim i pranuar pothuajse përgjithësisht, ndër të tjerë prej Pedersenit KZ 36,333, Walde-Pokornyt II 82, Pokornyt I 849, Hofmannit GEW 290, e me rezervë dhe te

Boisacq 826. E kundërshton Tagliavini 233, duke krahasuar *puth* me një tok fjalësh të dialekteve romane (ladine) e gjermanike (bavaro-tiroleze) si *bussé* «me puthë» në Comelico, gjerm. *Busserl Buss* «të puthur», angl. *buss* «me puthë» etj. Khs. dhe II dialetto dé Comelico f. 102 të këtij dijetari. Për fjalët dialektore gjermane sh. dhe Kluge-Goetze 89.

Fjalë e mbarë e gjuhës. Buzuku (XLIX/2, Gjenezë 27,26) *E i tha atë Izaku përindi i ti: Afërou tash e më puth, biri em. E u afëruo, e puthi* «Dixit ad eum: Accede ad me, et da mihi osculum, fili mi. Accessit et osculatus est eum». Edhe te Budi SC 387. Bardhi Osculari *Me puthunë*, Osculum Të *puthunë*, Osculatio Të *puthunitë*. Në Pukë *puth ka marrë* dhe kuptimin obscen (në të vërtetë eufemistik) «futuo», ashtu si frgj. *baiser*. Zgjerimi me *-(ë)toj puthtoj*, që ka edhe kuptimin «shtrëngoj, përqafoj», ka pësuar në trajtë e në kuptim një ndikim nga ana e *pushtoj* «përqafoj». — Dyshimi i Tagliavinit në një afërsi midis *puth* e gr. *πυκνός* është i drejtë. Nuk ka asnjë arsye të nisemi nga një kuptim «rrok, pushtoj, përqafoj» e të pranojmë kështu një zhvillim kuptimi në «puth», ashtu si vihet re në frgj. *embrasser* «me përqafoje; me puthë». Nuk dëshmojnë për një gjë të tillë *puthit* e *puthtoj*, se këto e kanë marrë kuptimin e tyre nga «puth»; khs. për këtë it. *conbaciare* «me puthitë», që vjen nga *baciare*. Kështu pra *puth ka atë kuptim që ka pasur gjithmonë*. Është një formim onomatopeik, që jep atë zhurmën pëlçitëse që del nga të puthurit. Me fjalë të përgjashme shënohet të puthurit në shumë gjuhë. Përveç atyre që zë ngoje Tagliavini le të përmendim dhe frgj. *putu(n)* «baiser» (Dauzat, *Essais de géographie linguistique, nouvelle série*, 1938, f. 92), bask. *pot* «puth», po sidomos pers. *pus* «puth».

**pyés pyés.** Fjalë me burim të diskutuar. G. Meyeri (f. 360, Alb. Studien IV 50) e spiegon nga lat. *peto* «lyp, kërktoj», e më saktë nga një bazë latine e paravenduar *\*petio*. Këtë spjegim e kundërshton Pedersen (Krit. Jahresbericht IX I 211), për punë të pranisë së formave *pévés pves pyvés* në gegërishten, dhe duke e zbërthyer fjalën në *\*për-vjes* ose *për-ves*, e afron — me rezervë — me ind. e vj. *pra* — *védavami*. Etimologjinë latine të G. Meyerit e pranon Meyer-Lübke Gröbers Grundriss I<sup>2</sup> 1044, Weigandi (Balkan-Archiv I, 1925, f. 261), Shoku Arhiv za arb. starinu III 169; sh. dhe Philippide II 651. Veçse Weigandi më parë (XVII-XVIII. Jahresber. d. Rum. Inst. Leipzig 1911, f. 234), mbi dëshminë e formës *pévés* të Dalmacisë, ishte shprehur kundër një burimi nga lat. *\*petio* dhe — afërsisht ashtu si Pedersen — rrënjën e fjalës e gjente te *ves*. Diefenbachu I 43 kish menduar një afrim me lat. *posco* «kërktoj». Kundër krahasimit të fjalës me gr. *πυθάνωμα* «hetoj» nga ana e Xhuvanit (Kop. letrar Nr. 2 f. 14) shprehet Jokli IJ IX VII 58; atë mendim kish pasur më parë dhe Kamarda I 44, 55. Tagliavini 217 formën më të vjetër e gjen te *pyés pyét*, te *-v-ja* e *pévés* sheh një shtesë epentetike, dhe kështu lidh fjalën me sllav. e vj. *pytaia* «scrutari, quaerere».

Fjalë e mbarë gjuhës, po me një larmi trajtash nëpër dialekte. Grafia e Buzukut *pues- puetunë* do lexuar *pyes pyetunë*, me vend të paditur të akcentit. Bardhi Interrogare *Me pyetunë*, po Bogdani (I 72, 7; II 108, 3) *pëvesëmë vetë mrekuellitë* «interrogemus ipsa miracula»; *pa mos pritunë tjetër, e pëveti* «senza aspettar la risposta, li domandò». Neologjizma janë *pyetje f., pikëpyetje f., pyetës m.* «gjqyq-

tar hetues» me *pyetësi* f. «zyra e pyetësit, hetuesia», e mbiemri *pyetës* në shprehjet gramatikore si *përemër pyetës*, *fjali pyetëse*.

Për të arritur te forma bazë e fjalës e me atë bashkë te burimi i saj, duan krahasuar të dhënat e literaturës së vjetër me dëshmitë e dialekteve të sotme. Dy janë trajtat kryesore të fjalës: më një anë *peýs pyés* që mori rrugët e veta, më anë tjetër *pévés* me variantet e saj. Forma *pyés* mbizotëron në toskërishten, dhe për punë të shqipitimit të *y*-së si *i* e të theksimit ka përfunduar në tosk. jugore në *pjes* me diftong *ié* (*je*), si në Gjirokastër e gjetkë, te Pedersen (f. 41, 83,100,178) *pjes* e në Lëkurës *pjés*: *e pjëti e i thotë; edhe zun, e pishë vajzën e i thanë; dolla, korba, të pëjesë*; çamërisht në Margëllëç *pjes*, aorist *pjeva*. Ndërkaq tosk. jugore ka dhe *pies* me *ie*, te Grigori (Mateu 2,4; 21,24) e *i piëti ata...*; *do t u pies edhe unë juvet një fjalë*. Kjo trajtë, e cila i përgjigjet më së përgjithshmes *pýes* me alternimin e ditur të vokaleve *y:i*, në dialektet e Greqisë e t'Italisë paraqitet si temë nazale *pienj*, duke bashkuar dy degët dialektore, edhe në këtë pikë: aorist *piëjta*, Reinholdi 37 *pienj piëjta piëjturë*, Kullurioti 88 *të piëjturitë* «τά ζήτημα», në Atikë *pienj piëjti* «pyeti» *piëni* «pyetni» (Sotirios, Laographia I 97, II 107), te Weigandi (Balkan-Archiv II 174, 190) *pienj piëti*, në Salaminë (Furikis, Ἀθηνᾶ 45.62) *Tuke pierë* «Μέ τό ῥώτημα». Në Itali *pienj, piëta piëti*, sh. dhe Kamarda I 52, II 106. Forma *pyés* nis me krahinat në veri të tosk. jugore, si p.sh. me Dukat të Vlorës (po aoristi zakonisht *pyéta*), e vazhdon në gegërishten si *pys pyta*, me monoftongimin e rregullt të *ye-s*, si te Todëri *u kujtua...* *se do t e pysin* «ἔγνω... ὅτι ἤθελον αὐτόν ἐρωτᾶν». Geg. veriore ka *pves*, formë që del që te Leake (Researches in Greece 313, për Jugun?): *pévés, pëveta* «ἐρωτῶ, I ask, inquire». Kështu Shkodra ka *pves*, Zadrima e *pvette* pranë e *bvet i biri*, në *bveçin* edhe Prishtina (Lambertz, Alb. Märchen 11, 43, 103); nahija e Pejës po *pvesen pr ni çik* «Pitaju ga za jednu devojku», *kish pevet* «beše pitao» (Vuka te Jokli, Zbornik Belić 57,60); Kraja *pavés pavét*, po te një këngë popullore të asaj ane (D. Kurti HD XIV 92) *Merre vet-e pá pevetë*. Kjo formë vijon gjer në Borgo Erizzo të Dalmacisë, për të cilin dialekt Weigandi jep, si u pa, *përvés pëvés*, e Tagliavini 217 *me pëvét, me puvét*, ku edhe shënohen të dhanat e fjalorëve sidomos për gegërishten; në një këngë prej Gjakove (Albania VII, 1903, Nr. 8 f. 115) *Vesël Pasha po privetë*. Për nahije të Pejës ndërkaq pranë *pves pevét*, dëshmuar prej Vukës, përdoret dhe *dves*, kështu në një këngë të luftës së Kosovës nga Prilepa e Deçanit *U kam thirrë me u dvetë ju per ket ônder*, T. Dorđević te F. Fishta HD XIV 172; poashtu në Koqa të Gorvokës *Ai nuk dvet, por gjithkon gri* (Jeta e Re, maj-qershor 1955, f. 196). Në ato anë pranë *pves* e *dves* ndihet dhe më e thjeshta *ves veta*: Arbanasi *vetshe, tdvesish*, Elezovići (Arhiv za arb. starinu II 249, 258) *Mor'e miro, shkon me dhen, Vetma djal' ku po i dhëm; Asman Breça ra n Prishtin. Po vet pasha ku e la zaptin?* Prej Rekës së Epër Jokli (Arhiv za arb. starinu I 37) sjell *mo m poietni (mo m'pëjetni)* «fragt nich nicht», e H. Stërmilli (Visaret e Kombit XIV 59) *të të pejsi* «të të pyes», ku *aj* përfaqëson një *i*, khs. *poaty u nejs* për «u nis». Poashtu në Istrië kanë thënë *ka piet* (Bartoli, Studi albanesi I fototipi). Një vështrim i këtyre formave tregon se *pévés pevés pyvés pavés bves* etj. piqen te *përvés*, e cila ruhet pranë atyre, dhe ka arrihur te ato me anë ndrimesh fonetike të ndryshme; *dves* është *tévés*

*tves*, me sonorizim asimilator të okluzivit pranë *v*-së, poashtu si te *bves* ndaj *pves*. Një krahasim i mëtejshëm i *pëvës* me *pyés* *pýes* e variantet e tyre si *pjes* *pějés* *pienj* etj. na dëfton se *pyés* mund të spiegotet nga *pëvës* nëpërmjet të trajtës *pyvés* që jep Kristoforidhi, ku *y* u përftua nga një *ë* në silabë përpara theksit. Kështu pra mendimi i Pedersenit (e i Weigandit) që fjala përfaqëson një *për-ves*, mbetet i drejtë. Si formë bazë që mund të arrihet me mjetet e sotme të gjuhës, del kështu *ves*, e cila pamë se ruhet në Kosovë; formalisht *pëvës* *dves* ndaj *ves* afërsisht ashtu si lat. *perrogo*, *interrogo* ndaj *rogo*, *-are*, si gjerm. *anfragen*, *befragen* ndaj *fragen* etj. Pyetja nëse kemi të bëjmë me një verb me temë dentale (*vet*, *ves* nga *\*vetj-*) apo nazale (*pienj*, *pierë* e kolonive) nuk përbën problem; *pienj* *pierë*, sikundër janë sekundare në punë të vokalizmit të brendshëm (*-ie* nga *-ye-*, kjo nga *-yé-* *-yvé-*), ashtu s'kanë si ruajnë një gjendje të vjetër as në pjesën fundore: *pienj* nga *pietnj*. Kështu pra etimologjia do të niset nga *ves* *vet*. Ndërkaq edhe kjo në historinë e fjalës mund të jetë sekundare, një kompozit *v-es* *v-et*, me preverb *v-* si *vjetem*: *jes*, *vdës*: *des*, *vgjaj*: *gjej*, për të cilat sh. Xhuvani-Çabej, Bul. për Shk. Shoqërore 4 (1956) 101. Në këto rrethana si bazë e fjalës mbetet *es* *et*, e cila qëndron ndaj *ves* *vet* si *enjë* «bërshë, tis» ndaj *venjë* «dëllinjë», si *eshkë* ndaj *veshkë*. Shq. *es* nga *\*aitiō* mund të jetë e afër me gr. *αἰτέω* «kërkoj, lyp, lutem» *αἰτήσ* «lypës, përderës».

## Q.

**qark** m. «rreth, rrotull; juridikcion administrativ, *qarku i Beratit*; rreth, mjedis, *qarqet zyrtare*; edhe ndajfolje, *i ra qark*; *përqark* «rreth e rreth, rreth e rrotull», ndajfolje e parafjalë. Mendimi i G. Meyerit (f. 220, sh. dhe Alb. Studien II 26v): *qark* nga lat. *circus*, duke pararenduar si fazë të ndërmjeme një *\*qerk*, është pranuar nga shumica e dijetarëve: Pušcariu EW 341, Jokl Studien 42 e IF 36, 143, Philippide II 637, La Piana St. li. alb. I 108, Bartoli Italia e Croazia 132 (me literaturë). Poashtu dhe Weigandi 42, i cili me *qark* bashkon me të drejtë dhe *qarke* f. «zorrët e trasha të bagëtisë me gjithë dhjamë». Kamarda (I 38, 162) e afronte fjalën e shqipes me gr. *κίρκος* «unazë».

E mbarë gjuhës. Buzuku ka vetëm *përqark*, si ndajfolje e si parafjalë: *e i qitnë një vestë të kuqe përqark* «et veste purpurea circumdederunt eum»; *Përse aj të jetë pors lisi... qi larg shtie ranzëtë e ti përqark ujit* «Et erit quasi lignum... quod ad humorem mittit radices suas» (LVIII/2 = LXVIII/2, Gjoni 19,2; XLVIII, Jeremia 17,8). Budi (RR 159) ka një të paqartë e të lulëzonenë bukur me *qerket*, e baretazë të *vet*, Bardhi Obversari *Me ardhunë përqark*. Nga zgjerimi *qarkull* m. «qark, rreth», fjalë popullore, janë sajuar neologjizmat *qarkulloj* e *qarkullim* m. Neologjizma janë dhe *qarkore* f. me mbiemrin *qarkór*, *-e*. Po popullore verbet *qarkoj* e *qarkatoj*, ky një zgjerim me *-atoj* *-ëtoj*. Për *qarke* si një shumës i singularizuar e për *gjarkzat* fpl. «grasso che sta tra il fegato e gli altri intestini» (Bashkimi), *gjarkëz-it* «àngrra e zorrvet me vjam, peshqiri i zorrvet» (Gazulli), variante me sonorizim të palatalit nistor në geg. veriperëndimore, sh. vretjtet tona në Li. Posn. VII 188. — Për burimin e fjalës do thënë se *i*-ja latine në asnjë rasë nuk ka arritur në shqipen gjer në *a* (*ja*), përfundim ky vetëm i *e*-së në rasi të tilla si indoeur. *mel-*: *mjalhtë*, lat. *cerrus*: *qarr*. Prandaj etimo-

logjitë *anguilla*: *ngjalë* e *circus*: *qark* nuk mbahen, sh. dhe Rev. de Ling. VII 1 194. Më anë tjetër shkallat e ndërmjeme \**ngjelë* e \**qerk* që paravendohen në këtë mes për të përligjur këto etimologji, jo vetëm që nuk dëshmohen gjëkund, po nuk gjejnë as ndonjë analogji në zhvillimin fonetik të shqipes së periodës pasantike. Te *qark* kemi pas gjasë një fjalë vendi, refleksi i një indoeur. \**ker-k-*, e si e tillë e afër me lat. *circus*, gr. κίρκος κίρκος.

*qê-ni qê-ri*, *qeth qêth* m. «dërrasë rrotullare e e lëmuar ku hullojnë». Për këtë fjalë G. Meyeri 224v. jep format tosk. *qê-ri* m., *qê-ja* f., geg. *qê-ja* f., si dhe deminutivin *qeth* m., dhe mendon për të si bazë një \**qen-*, për këtë një më të vjetër \**klen-*, duke pranuar me rezervë një afëri me turq. *oklagi*, fjalë sipas tij e huaj në turqishten. Edhe Vasmeri (Studien I 34v.) nisat prej një baze \**klen-*, veçse e spiegon fjalën nga një refleksi i lat. *clava* «çomangë», e pikërisht nga një \**clavanus*, respektivisht \**clavaneus*, \**clavanea*. Sh. dhe Philippide II 666. Si e kemi shënuar shkurt te Bul. i Univ. Shtet. të Tiranës, Seria Shk. Shoq. 1 (1958) 60, nga këto dy spjegime, dhe krahasimi i parë dhe interpretimi me anë bazash latine të rindërtuara e që sigurisht nuk kanë ekzistuar gjëkund, bie a priori: Kjo fjalë nis me *q-*, jo me *kl-*, edhe në çamërishten (*qê-ri*) dialekt që dihet se grupin *kl* e ruan.

Fjalë e mbarë gjuhës, po me degëzime të shumta trajtash e përdorimesh. Sëpari kemi çiftin geg. *qê-ni* tosk. *qê-ri*, në Gjirokastrë *qer-i* m., pastaj fem. geg. *qê-ja* tosk. *qe-ja*, e deminutivin geg. *qêth* tosk. *qeth* m. Këto shënojnë ku dërrasën rrotullare (si sofër e vogël, me bisht) ku hullojnë e ku gatitin petën (tanuer, astragaç), ku një farë lopatë me bisht të gjatë, me të cilën shtien bukët në furrë, ku një palare a limbë të drunjte që çojnë në kishë me grurë të zier për një përshpirtje. Khs. për këto trajta e kuptime *qê* e *qeth* te Kristoforidhi, *qêni* «Brotbrett, Walgerbrett» e *qêth* «Schiesser» te Weigandi, po te Lambertzi 163 «Brotranft, Brotkanten; kothere buke» (?). Në Kelmend *qeth* pas Nopcsas f. 100 i thonë dërrasës si rrotullare me të cilën marrin bukën e papjekur e e vënë nën saç për ta pjekur. Dërrasës ku vënë bukët e i çojnë në furrë, në Krujë sipas Kristoforidhit i thonë *qêzë* (femërore me *-zë*). Në Tiranë *qêhën qêhni* m. shënon dhe këtë dhe dërrasën rrotullare të hullimit. Morfologjikisht kjo trajtë ka dalë nga singularizimi i *qêhna*, që është plurali i *qê-së*, e s'është refleksi i një baze të lashtë \**kênkhan-a* \**kêkhana* si mendon La Piana (Sul riecheggiamento delle liquide e dei nasali nell' albanese, 1952, f. 25), sh. Li. Posn. VII 164. Baza e gjithë këtyre trajtave, si e pa dhe G. Meyeri, është *qen*; kjo dha rregullisht geg. *qê qeni*, tosk. *qê qëri*, poashtu si *fren* (lat. *frenum*) që dha *frê freni* e *frë frëri*; *qer-i* i Gjirokastrës e ka *r-* në nga trajta e shquar, pra do gjykuar ashtu si *drër drëri* i Siqelisë. Në pikëpamje materiale do shënuar se *qê qê* me gjithë variantet e saj, në thelb shënon një të vetme përdorse të ekonomisë shtepiake: një dërrasë rrotullare për hullim, e cila vise-vise shërben dhe për të çuar petën ose bukën në furrë, e që kur është më e vogël e vjen si gjatore, përdoret dhe për ta hedhur atë në furrë që të piqet. Në këto rrethana shq. *qen-* në *qê qê* mund të jetë e afër me fjalën keltike gal. \**cantos* «rreth i hekurt, anë, qoshe», bret. *kant* «qark, rreth», irl. e mesme *cét* «shtyllë rrotullare e gurtë». Për këtë fjalë e për lidhjet e saj më një anë me sllav. kishtarë *кѣтъ* rus. *kut* «kënd, qoshe» e me gr. *κανθός* «bisht i syrit», më anë tjetër me lat. *cantus* «rreth i hekurt i rrotës, gavyell» si refleksi

i fjalës keltike sh. Pokorny I 526v. me literaturë, Vasmer REW I 705. Khs. dhe Meyer-Lübke REW 1616, Rohlfs EW 889 e LG 208v. Për *qen* (*që që*), në bazë të afërisë me kelt. *kant-*, do të mendohet një formë bazë *\*kan-* që pësoi metafoninë; me fjalë të tjera, që ky emër është një plural i singularizuar, sikundër e kemi shënuar në vendin e cituar më sipër.

**qeft** m. «gotë, kupë për të pirë». G. Meyeri 221 e jep fjalën me këtë kuptim dhe me tjetrin «bateri, pilë në çark të pushkës», dhe e lë të paspieguar. Mendimi i Dozonit (f. 40) e i Kristoforidhit (f. 187), që e lidhin me gr. *κεῦθος* «vend i fshehtë, thellësi» (për fjalë greke e merr dhe Manni 412), nuk është i drejtë.

Fjalë krahinore e toskërishtes, sot e vjetëruar. Identike me *qeft* «sqep» që jep M. Totoni për Sheper të Zagorisë (Bul. i Univ. Shtet. të Tiranës. Seria Shk. Shoq. 1, 1962, f. 211). Pra kuptimi i parë ka qenë «sqep, fyt». Prej kësaj, për punë të gjasisë së trajtës, u zhvillua kuptimi i fytit të një ene, krejt ashtu si në gjerm. *Schnabel: Schnabel eines Gefässes*. Ky kuptim pastaj me anë të një sinekdoke u zgjerua duke shënuar një enë me fyt, e mënfund çdo kupë a gotë për të pirë ujë.

**qendrat** fpl. «grushte, shuplaka». Del si një *ἄπαξ εἰρημένον* te Buzuku (LIV/2 = LXIV/2 Mateu 26,67): *Ashtu atëherë e përshtynë ndëfaqe të tî, e por i binjinë (me?) qendrat* «Tunc expuerunt in faciem eius, et colaphis eum ceciderunt», Kristoforidhi (geg.) «me grushta», Xanoni e i *râne grushta*. Me gjithë se germa *κ* te Buzuku shënon herë tingullin *q*, e herë *gj*-në e *g*-në, kjo fjalë ka më të gjarë që të jetë *qendrat*, me *q*-. E krahasueshme me verbin *qëndronj* «godit» te Budi, DC 213b *Mbë zemërë i qëndroi*, e me të sotmet *qandërr* «polmonit» që thuhet në Mirditë e që jepet si e tillë te Junggu, te Bashkimi e te Donisa (Cirka II 148). Në këtë rasë *qendrat* paraqitet si plurali i *qandërr-s*. Kështu fjala është një me *qendër qëndër qandër* nga lat. *centrum* (kjo prej gr. *κέντρον* «thumb, majë, gozhdë»). Për kuptimin e fjalës së Buzukut khs. it. e Kalabrisë *centratu* «uomo colpito da sciagura» te Rohlfs EW 975 (Dorsa).

**qengj** m. Fjalë me etimologji të diskutuar. Ndërsa G. Meyeri 222 e linte pa spjegim, dijetarët pas tij kanë kërkuar një burim prej latinishtes. Bugge (Bezenbergers Beiträge XVIII 178) nisat nga një bazë latine *\*agnunc(u)lus*, deminutiv i *agnus*, formuar si *avunculus*. G. Meyeri (Alb. Studien IV 20) s'e kundërshton këtë etimologji, vetëm se ai zhvillimin e mendon nëpër shkallët *\*(a)gnunclus*, *\*glunclus*. Skoku (Arhiv za arb. starinu II 344 vv.) vë për bazë lat. *agniculus*, e cila sipas tij dha me metatezë *\*aginculus* e kjo në shqipen mënfund *qingj*. Këtë etimologji e parapëlqen Tagliavini (f. 96) nga të tjerat. Po Jokli (IJ XI VII 219) vren me të drejtë se baza latine *\*aginculus* që mendohet në këtë mes, çamërishtes *qingj* i mjafton vetëm në punë të guturalit nistor, po jo në atë të fundorit (pritej *-kl*). A priori i gabuar afrimi që bën Barići (I 95) me *shilég*, sepse një bazë *\*klengj* *\*klingj* që paravendohet në këtë mes kundërshtohet nga të dhënat e dialekteve.

Fjalë e mbarë gjuhës. Te Buzuku *qengj*, p.sh. (XXXII, Isaia 40, 11) *Porsi barî e me krahë të tî të mbëljedhë qengjatë* «Sicut pastor gregem suum pascet: in brachio suo congregavit agnos». Bardhi *Agnus Kingj* (?), shkruar *Chingj*; Bogdani (I 44,15) *mishi i kingjavet e vjetavet njomë* «della carne di vittella, et agnelli» Forma origjinale e fjalës

është ajo me *q-* (*qengj*, *qëngj*, *qingj*), siç e ka edhe sot pjesa më e madhe e gjuhës: mbarë toskërishtja me dialektet e kolonive, dhe gegërishtja e Shqipërisë së mesme: Labëria *qëngj*, Gjirokastra *qengj*, Çamëria *qingj*, geg. jugore *qîngj* (Weigand 44); *qëngj* dhe në Itali, në Atikë (Weigand *Balkan-Archiv* II 191) *qengj qengji*; *qengjrrë* në Apuli (G. Meyer, *Alb. Studien* IV 20) është një plural i singularizuar, Li. Posn. VII 194, VIII 105. Në geg. veriore me degët e saj të ndryshmet mbizotëron vërtet trajta me velar (*kingj*, *kinxh*, *kî*), po ekziston në krahun perëndimor dhe ajo tjetra me palatal, në Shkrel te një këngë popullore (Leka VI 169) *Merre qigj e bjere dash*, në Arbënesh të Dalmacisë pas Weigandit (XVII-XVIII. *Jahresber. d. Rum. Inst. Leipzig* 238) *tšindž*, pas Tagliavinit *çinxh*. Variantja me velar do gzykuar ashtu si *kerr kesh kingël lkê shkipët*, zhvillime sekundare të *qerr qesh qingël lëqë shqip* në geg. verilindore, sh. *Bul. i Univ. Shtet. të Tiranës, Seria Shk. Shoq.* 1 (1958) 32,53, khs. edhe *kep*. Në këtë drejtim dëshmon dhe *qengj-i* i Buzukut, trajtë që piqet me atë të toskërishtes e që bashkë me të paraqet bazën e fjalës me sa mund të arrihet me mjetet e brendshme të gjuhës. Kështu gjen spjegimin e saj variantja dialektore me *k-*, në të cilën Pedersen (KZ 36, 327) shihte një nga pikat e errëta në sistemin e guturaleve të shqipes. Duke u nisur nga *qengj* e nga një kuptim i parë «i ri», fjalën mund ta afrojmë me ind. e vj. *kanîna-«i ri» kanyà «vajzë»,* gr. e vj. *καίνος «i ri»,* lat. *recens «i ri, i njomë»,* irl. e mesme *cano cana «këlysh ujku»* kymr. *cenau «këlysh qeni o ujku»,* sllav. e vj. kishtare *čedo «fëmijë»* etj.; sh. për këtë grup fjalësh sidomos Pedersen *Kelt. Gram.* I 126 v., *Walde-Hofmann* II 423, *Pokorny* I 564v. Si bazë e fjalës shqipe mund të rindërtohet një *\*ken-k*, formë me *-k* deminutive. Te *qengj gj-ja* e sotme rrjedh nga një *-q* si zhvillimi palatal i *-k-së* (*\*qenk*): qoftë me rrugë asimilimi, qoftë nga plurali; në këtë rasë kemi të bëjmë me një plural të singularizuar. Semantikisht specializimi i një kuptimi të përgjithshëm «i ri» për të shënuar qengjin është i kuptueshëm për Shqipëri, një vend ku rritja e mbajtja e dhendet ka zënë në gjithë kohët një vend me rëndësi në ekonominë shtepiake e në jetën baritore. Edhe në greq. e re ζῶον «gjë e gjallë, bagëti» nëpër dialekte përdoret dhe për delen ose dhinë, sh. G. Meyer *IF* 6,110, *Rohlf's EW.* 759, *LG* 174.

**qerm** m. «anë, buzë, qenar»; sidomos *qermi i arës* (Tirana «ana disi e ngritur e arës, që e ndan atë prej arës tjetër», në Shkodër *shko qermit e jo mesit* (scil. të arës); në Peqin *qermi i votrës* «pjesa e ngritur e votrës anëve, mbi të cilën vihen drutë» (*Illyria* I Nr. 22 f. 8); sipas Xhuvanit (Kritikë për fjalorë të shqipes 15) edhe *qermi i rrugës* e *qermi i pusit* «goja e sipërme e grykës së pusit». Fjalë e gegërishtes, që mungon te G. Meyeri. Logoreci e ka për «kufi, cak, skâj», *mos i bje arës për mjedis, por qermit*, Leka VII 482 për «nji rryp i ngushtë djerri qi lêhet anës së nji are i mbushun me ferra, shkurre, bashnje; sidomos ndërmjet arës e nji rrugë». Cordignano jep *qerm* «fossato, hendek» me verbin *me çermue* «far solco, scavare (delle ruote dei carri)», këtë me ç- të gabuar. Xhuvani e bie si fjalë të afër me gr. τέρμα «cak, fund, mbarim; pushtet epror».

Me këtë duket të lidhet një tjetër fjalë e gegërishtes: *mqer* m., *mqere* f. «cak, afat»: Bashkimi *mqere* f. «dilazione, shtyrje afati», Godini *mqer* m. «Frist, Termin, Zahlungstermin, Ziel, Zinstag», *ra mqeri* «kaloi afati», sh. edhe Mannin. Për etimologjinë do thënë se

*qerm* është një nga ato fjalë të shqipes, për të cilat nuk mund të ndahet në mënyrë të prerë a janë huazime greke a latine, sh. Revue de Linguistique VII 1 182. Duke përfaqësuar fjala një \**tjerm*, si geg. *qetër* «tjetër» etj., si burime të saj vijnë në vështrim : më një anë gr. e vj. *τέρμα* «cak, fund, mbarim; pushtet epror» *τέρμων* «cak, kufi», më anë tjetër lat. *terminus* e *termen*, *-inis* «gur kufiri, kufi; fund, skanj». Prania e *mqer*-it me kuptimin e afatit do të fliste më fort në të mirë të një huazimi latin. Po përhapja e fjalës në gegërishten flet më shumë për një burim nga greq. e vjetër, më saktë nga dorishtja. Khs. për këtë *τέρμων* «*ῥος*, kufi» (në punë arash) në një mbishkrim të dorishtes së Siqelisë (Halaisa) te Thumb-Kieckers Handbuch d. gri. Dialekte I 207. — Te *mqer* ka prefiks *më-* (Xhuvani-Çabej, Bul. për Shk. Shoq. 4, 1956, f. 80), po njëkohësisht edhe rënie të *m*-së fundore, duke u marrë kjo në ndjenjën gjuhësore gabimisht si një sufiks.

**qerpë çerpë** f. «flokë, balluke, perçe, tutël flokësh». G. Meyeri 224 e jep pas Rossit dhe e lë pa spjegim etimologjik. Është një me *çerpe* f. «tutël flokësh në majë të kresë së burrave», te Kujunxhiçi 46 *çerp* m., pokështu te Arbanasi 65. Kjo është baras me tosk. *çepë* «perçe, tutël flokësh në majë të kresë». Janë të gjitha trajta metateze të *perçe*-s. Sh. *perçe* e *çepë*. Ndryshimi i vendit të theksit te *çerpë* — *çepë* është ashtu si te *hile hilé*, *hise hisé* etj.

**qesim** adv. «për një marrëveshje a sipërmarrje me çmim të prerë e brenda një afati të caktuar». G. Meyeri (Alb. Studien V 90) e jep për shqipen e Greqisë, pas Reinholdit, me kuptimin «*ἀποκοπή*, prerje», dhe kështu bashkë me *qesëndis* «tallem me një, e përçesh» e spiegon nga turq. *kesmek* «me pre». Këtu do shënuar se *ἀποκοπή* Reinholdi pas gjase e ka përdorur me tjetrin kuptim që ka, «çmim i prerë» (*κατ' ἀποκοπήν* «me çmim të prerë, me akord, qesim»). Prandaj fjala vetëm tërthori rrjedh prej turq. *kesmek*; burimi i pandërmjemë i saj është turq. *kesim* «prerje, formë; akord, me akord». Prej rrjedhøjave të turq. *kesmek* rrjedhin dhe *qesat* *qesatllëk*, *qesër*, *qesme*, *qesemër*, *qesqín*, *qesëndis* *qestís*.

**qesme** f. «vegël argjendarësh për të prerë arin e argjendin». Fjalë e argjendarëve të Tiranës, shënuar dhe te Fjal. i gju. shqipe. Nga turq. *kesme* «gërshërë e madhe; e prerë», prej *kesmek* «me pre». Me *qesme* duket të shkojë edhe *qesemër* m. «vegël sahatçish porsi dara» te Fjal. i gju. shqipe, fjalë e sahatçive të Tiranës.

**qeshqék** m. «grurë i rrahur, me copëza mishi brenda, që zihet, e hahet si përvëlohet me gjalpë». Mungon te G. Meyeri. E ka sëpari Jungu për Veri, si *çeshkék* «vivanda fatta di grani di frumentone», po është e mbarë gjuhës. Prej turq. *keşkek*, e cila ka hyrë dhe në rumanishten, sh. dhe Lokotsch 1167. E dyshimtë trajta *qeshqé* f. që jep Manni 415, njëkohësisht duke e cilësuar shkurt si fjalë turke.

**qetë** f. «shkëmb me majë të mprehtë; faqe shkëmbi». Fjalë e gegërishtes, që mungon te G. Meyeri. Rron më fort në toponimi: *Qeta* e *Shurqelit*, *Qeta* e *Dhënvët të Birës*, *Qeta* e *Mbas forcet*, *Qetat* e *Ndok Pepës*, *Qeta* e *Molanit*, *Qeta* e *Gomarit*, *Qeta* e *shtjerrave*, te M. Sir-dani (HD XIII 358v.), i cili e spiegon fjalën si «vend i shtirë, i thyeshëm». Del dhe si apelativ në një këngë kreshnikësh, te vargu *kahë po ndiellin dhiët-o qétave* në veprën Skanderbegu mbas gojëdhanash po të këtij autori (f. 214). Dhe te vjersha «Shqypja arbnore» e Nd. Mjedjës, me kuptimin «shkrep i thepisur». Në Mat ka një majë mali *Kepi*

i Qetës (kumtim i Dh. Liperit). Si e kemi shtjelluar në Li. Posn. VIII 79v., *qetë* është plurali i singularizuar i mashk. *qye qeni*, pl. *qejt* «majë» e i fem. *qye-ja* te Gazulli (f. 96), i cili pa edhe lidhjen e *qetë-s* me *qye*; Cordignano *qye qeu* «falda (o piede di monte); fianco o punta o svolta (sull' erta di un monte)»; B. Palaj (HD XIV 255 shën. 10) *qye-ni*, pl. *qejt* «thep, shkrep n'veti» (Kelmend); te Logoreci në *qye të malit*, në *qye të gurit*. Pra plurali i *qye-s*: *qejtë qetë*, dha femëroren e re *qetë*.

**që qi** 1. përemër relativ i palakueshëm, që përdoret njësoj për të gjitha gjinitë e rasat, në njëjës e në shumës, zëvendësuar sot në gjuhën e ngritur shpeshherë me *i cili* e format e saj; në gjuhën popullore dhe për «ku» e «kur, në të cilin», në fjali vendore e kohore; në *sokak të ngushtë që na mblodhi hera*; 2. lidhës në fjali subjektive, objektive, finale, konsektive e koncesive; në fjalitë objektive në disa rasa të caktuara ndrohet me *se*; 3. parafjalë kohe («qysh») e vendi: *që dje*; *që kur erdha këtu*; *që në Vlor'e Tepelenë*. Për përdorimet e funksionet sintaktike të fjalës sh. Hahn 54v., e sidomos Pedersen 147vv., Lambertz IF 34, 111vv., 113vv., për analogjitë ballkanike Sandfeld 106, 107, 135, 176. Për shprehjen e totalitetit me anë të *që-së* me funksion hiperkarakterizimi të artikullit prepozitiv të (*që të gjithë, që të tre, khs. të pesë bashkë* për «që të pesë»), sh. vrejttjet tona në Studii shi Cerc. lingvistice X 4 (1959) 548, Bul. i Univ. Shtet. të Tiranës. Seria Shk. Shoq. XVII 3 (1963)88; edhe Hahni e vuri re, në shprehje si *se që të shtatë e patnë atë grua* « *οι γὰρ ἑπτά ἔσχον αὐτήν γυναῖκα* ». Një kompozit relativisht i ri është adverbi *qëkur* «motit, qyshkur» (*ka qëkur që ta kam thënë*), formuar nga *që kur* në fjali si *që kur erdhe ti*; me *-thi qëkurthi*, si te *parthi*; edhe më e re është *i qëkurshëm*; një tjetër kompozit është *qëmoti* me *i qëmoçëm*. — Etimologjikisht G. Meyeri (f. 217v. te *kush*) sheh këtu dy fjalë të ndryshme: përemrin relativ e shpie te lat. *qui quem quae*, lidhëzën e parafjalën *që* «qysh» te lat. *quod*. Këtë mendim e pranon për relativin dhe Meyer-Lübke (Gröbers Grundriss I<sup>2</sup> 1051), po duke u nisur nga lat. *quid*, e për parafjalën e pranon me një «mbase» dhe Puçariu EW 245. Pedersen (f. 147, Krit. Jahresbericht IX I 206 vv.) sheh aty një fjalë relative, më lashtë adverb ose përemër i gjinisë neutrale, etimologjikisht fjalë vendi, jo prej it. *che*, po prej një indoeur. \**qid* për \**quid*.

Fjalë e mbarë gjuhës. Gegërisht del qëmoti si *qi*, me ndrim të ë-së paratheksore në *i* (fjala përdoret në fjali rregullisht pa theks), në rasa si *që tha*. Buzuku (XLVI/2, Tesalonikasit I 5, 14; LXVII = LXXVII, Gjoni 10,12; L, Luka 15,13; LXXIX = LXXXIX, Marku 9,27; LXXV = LXXXV, Romakët 6, 21; LXXX/2 = LXXXX/2, Korintasit I 1, 7) e të *ngushlloni ata qi janë me zemërë të trembunë* «consolamini pusillanimos»; *E roçetari qi s anshtë barî e qi nukë janë dhentë e tî* «Mercenarius autem, et qui non est pastor, cuius non sunt oves propriae»; *E mbas shumë dit, mbëljedhunë qi pat gjithë kafshëtë* «Et non post multos dies, congregatis omnibus»; *Qishse qi na nukë mujtim me e nxjerë?* «Quare nos non potuimus eicere eum?»; *Qish frujt patë atëherë nd ato të bame, qi tash ini turpënuom?* «Quem ergo fructum habuistis tunc in quibus nunc erubescitis?»; *ashtu qi ju nukë mëngoni as ndë ndonjë dhunëtie* «ita ut nihil vobis desit in ulla gratia»; në fjali finale ky autor përdor vetëm përse «ut», ka të gjarë pas it. *perchè*. Budi (RR 183) e jo tjerëtë *qi janë mā për së largu; o do shtekëtarë e t ardhunë, qi plang e*

*shtëpī s u dihetē. Bardhi Qui Gji. Bogdani (I 17,24) këto të trī Dritta janë nd atē qi anshtë i patēzanē e të sosunē «Queste tre luci sono nell' Infinito». — Si e kemi shtjelluar edhe gjetkë (Bul. për Shk. Shoq. 1, 1956, f. 142 shënim; Bul. i Univ. Shtet. të Tiranës Seria Shk. Shoq. 1, 1961, f. 71), që është identike me çë ç, dhe dallohet nga kjo vetëm në punë të tingullit nistor, poashtu si *qish qysh* nga *çish*, si *qoj* nga *çoj*. Kjo gjë shihet nga rrethana që në dialektet e Greqisë e t'Italisë si përemër relativ e si lidhës për «që» përdorin kudo çë: në Atikë çë «që, i cili, e cila, çë; ku», çë të «që të» (në fjali finale), *çëkúr* «qëkur», *çë atëherë* «që atëhere» (Weigand, Balkan-Archiv II 207). Për Itali khs. vrejttjet e Kamardës I 212,312. Edhe në geg. jugore ç = që për të shprehur një terminus a quo, si kohësor si lokal: ç prej asaj dite; ç prej Elbasani e deri në Tiranë. Pokëtë gjë dëshmon edhe përemri *taç* «ajo gjë që, atë gjë që, ato që» i Buzukut (p.sh. *nukë lypën taç anshtë të tītē* «non quaerit quae sua sunt», XL/2, Korintasit I 13,5), që është *ta ç* «ata (neutër) që», ku ç është relativi. Identitetin e që-së me çë e vuri re sëpari Kamarda I 212, 312, sh. edhe Hahn 53, Bopp 517. Edhe në të tjera gjuhë përemri pyetës i neutrit ka kaluar më një anë në lidhorin përkatës, më anë tjetër në lidhëzën «që» në fjali objektive. Për të parën khs. gjerm. dialektore *das Mädchen, was* (në vend të *das*) *heute gekommen ist* «vajza që erdhi sot»; për të dytën lat. *quod* «çë», e cila u bë dhe pjesëz lidhëse (Ernout-Meillet 846), e në lat. vulgare, sidomos në biblikën, u përdor si «që» dhe në fjali komplete (subjektive e objektive): Korintasit I 9,24 *Nescitis quod hi qui in stadio currunt, omnes quidem currunt* (shqip te Buzuku LXL/2 *as nukë dini se shumë rjedhënë mbë palit, ma një e e mer pālinē?*). Këtë rrugë ka marrë edhe *quia* «sepse», te Petroni *dixi quia mustela comedit*, sh. Ernout-Meillet 840. Poashtu në rusishten çto «çë, ç» është bërë edhe lidhës me Kuptim «që».*

**qëllój qilloj** «godit me grusht, me shuplakë, gjuaj me një armë a me gur»; *ja qëlloj* «arrij ta godit, ta zgjidh mirë (një punë)»; intr. «ndodh aty, gjindem»: *qëllova dhe unë aty; qëlloi që ndodha dhe unë aty; a të qëllojnë? «a të ndodhen?»* (të holla etj.); në Itali *i qëγ οί γjumē* «e zuri gjumi», *qël(l)onem* «më zë gjumi». Emri *qëllim* m. «synim, pikësynim», në tosk. jugore (Gjirokastër) «kujdes, vemendje», *mbai këpucët me qëllim* «ruaji mirë, mbai me kujdes, mos i gris»; *me qëllim* «nergut», tosk. jugore «me kujdes»; *qëllimthi* «me qëllim, nergut»; në Tomorricë *qëllatë* f.: *me qëllatë* «me kujdes, me qëllim, me vemendje» (Illyria I Nr. 40 f. 8). G. Meyeri 225 nuk i jep dum kësaj fjale. Më një anë largon vetë mendimin e një afërie me friul. *chalâ* vegliot. *calá* ladin. *čaré* «me shique»; më një anë përsjat një afrim me lat. *cello* «godit, qëlloj» në *percello*; më anë tjetër afron për krahasim *qell* «sjell, bie». Lambertzi (KZ 52,66) e lidh me *kle* «qe» e me *participin klenë* «qenë».

Fjalë e mbarë gjuhës. Del sëpari te Budi (SC 131, 342, 267): *e aty nd u gjetë ashtu qëlluom; e se ndō n u gjetë disaherë qëlluom me ndōnjë mpkat murtār; tue qëlluom me të marrë zemërënë e shpirtinē tand*. Bogdani (I 100,13) *ma Sauli... kish qëlluem tue shtim m patërshanē me vrām* «ma Saul... li havea tirato la lancia per ucciderlo». E sotmja *qilloj* e gegërishtes, dalë nga ndrimi i ë-së në i në silabë para theksit, sikundër shihet nga dëshmia e Budit, është e re në këtë dia-

lekt; e ka edhe të folët e Kosovës: *Ni rek ngat ish kon çillue* (Elezović, Arhiv za arb. starinu I 57). Në Siqeli në një këngë *Eja gjum'e m'e qëló* «Vieni, o sonno, e me lo addormenta», në Kalabri *Plakut i qëloi gjumë* «Al vecchio sopravvenne il sonno» (Kamarda II 186, 114), te V. Stratigòì prej Lungrit të Kalabrisë *Dhèlprës gjumi i qëllon nën dhé*, G. Ferrari — K. Kamsi, Bul. i Univ. Shtet. të Tiranës. Seria Shk. Shoq. 1 (1959)86. — Kuptimi abstrakt i qëllimit në gjuhën letrare ka dalë nga konkreti; khs. gjerm. *Zweck* «qëllim», në të parë «rrotulla ku marrin nishan e gjuajnë».

Nga krahasimet etimologjike i drejtë mbetet vetëm afrimi me *qell*, që në Itali ruhet me kuptimin «sjell, bie». Kuptimi «godit, qëlloj» del shpeshherë nga «sjell, bie». Khs. *bie* «sjell me vete nga larg afër»: *i bie* «rrah, godit, qëlloj», *sjell* «bie, shpie, çoj»: *i sjell* «i bie, e qëlloj», *i sjell me gur*. Morfologjikisht *qëlloj* është një zgjerim i *qell* me *-oj*, si *zbutoj*: *zbut*, *qulloj*: *qull*. Për errësimin e *e-së* së pathekse në ë khs. *thëllim fëllim*: *thellë fellë*, *bërrúc*: *berr*, të *këqí*. — Me *qëlloj* afrohet *qollít* «del mirë; rastis, ndodh, qëllon, godit», te Godini e te Manni edhe *qollój*, *qollí* f. *qollím*, *qollimas qollímazi* «me të qillueme». — Sipas Puçariut (Dacoromania II 592v.) rum. dialektore *acerà* «me pritë; me i vu re» është një huazim shumë i vjetër nga shq. *qëlloj*, me ndrim të likuidës velare në *r*.

**qore qorre** f. «gropë a vend i thellë në mal» (janë ato gropat e natyrshme e të mëdha nëpër male gurore, të cilat gjatë dimrit mbushen me ujë shiu e i shërbejnë bagëtisë si lugje për të pirë ujë në verë). Fjalë e Labërisë, që e jep sëpari Fjal. i gju. shqipe. Del dhe në toponiminë e asaj ane, si te *Qore*, *Mali i Qores* që është mali i Dukatit të Vlorës. Si e kemi shtjelluar në Li. Posn. VIII 81, është singularizimi i *qore*, plurali i *quar quer*, *qori* «katua, burg; bodrum, bimsë, qilar; vend ku ruhet zahireja e bulmeti». Kjo fjalë ka dhe kuptimin e një vendi të thelluar në dhe. Kështu në Mokër një varr i kohës antike gdhendur brenda në shkëmb quhet *Qorri i Begos* (H. Ceka, Bul. i Inst. të Shk. II Nr. 2-3, 1948, f. 67v.); në Pukë *kuri*, me *k-* që i përgjigjet *q-së* (të dyja nga *kl-*), shënon një vend të thelluar në dhe; në Qerret të Pukës *kori* është një çarranik a thark për bulmet përpara shtëpisë. Në Nikaj-Mertur ka një emër mali *Korja e Merturit*, e midis kësaj kra-hine e Krasniqes një mal *Korja e Rajës* (E. Lafe); në Curraj Eper *Koret e Mavriqe* janë banesat nëndhëse që thuhet se kanë qenë të fisit të shuar të Mavriqet (Q. Haxhihasani). Këto përdorime të *quar quer qori-t*, të cilat janë të mbarë gjuhës, tregojnë dhe nga ana semantike lidhjen e *qore qorre-s* me këtë fjalë. Te *qorre*, *Qorri i Begos* *r-ja* e fortë rrjedh nga kryqëzimi i fjalës me *qorr* «i verbër». — Sh. edhe *kluar*.

**qos** «mbaroj, kryej, rregulloj»: *ai qos punë*; *ai s'qos punë*; *s'qose gjë* «s'mbarove punë, s'gatove gjë»; *e qose!* (iron.) «e kreve mirë, na kënaqel»; *qosem*: *s'u qos* (gjë) «s'u gatua, s'doli gjë dhe ky». Në shqipen e Siqelisë *qos* «pasuroj», zakonisht *qosem* «pasurohem», *i qozmë* «pasunar», *qozmë* f. «pasuri». G. Meyeri (f. 228, Alb. Studien V 91) jep vetëm format e kuptimet e Siqelisë, e prej Greqie *qomë* f. «προκοπή, mbarësi, dobi», dhe e lë fjalën të paspieguar.

Është një nga ato fjalë që tosk. jugore ka të përbashkëta me dialektet e Greqisë e t'Italisë. Pas gjase një «shkurtim i brendshëm» i *qullo* me kuptimin metaforik që ka kjo në shprehje si *s'qullose gjë* «s'bëre gjë, s'gatove gjë», kuptimisht e barabartë me të sipërmen *s'qose*

gjë. Prej fjalish negative të këtij lloji fjala kaloi pastaj edhe në fjali pozitive me kuptim ironik, si *na e qose!* «na e rregullove mirë këtë punë!» Prej andej u zhvillua më në fund përdorimi pozitiv pa ironi (*ai qos punë*) si dhe kuptimi i pasurisë. Fjalë ekspresive e gjuhës së përditshme, relativisht e re e me përhapje dialektore të kufizuara. Trajta *qomë* e Greqisë nga një *qullomë*, prej *qulloj*. Po në Mëndrë të Atikës ka *Plaka e qósurë*, sh. Furikis, 'H év Ἰ'Αττικῇ Ἑλληνοαλβ. διάλεκτος, 126, te Lambertz *Lehrgang des Alb.* III 266.

**quar quer qori** m. «katua, burg; bodrum, qilar; vend ku ruhet zahireja e bulmeti». Këtë fjalë, që del si *Chiuer* (*kjuer*) «Promptuarium, dispensa» që te Bardhi, G. Meyeri e shënon pa të drejtë në dy vise të ndryshme: f. 4 te *ahúr*, e f. 228 te *qivúr*, duke e marrë për një gabim shtypi, sipas tij për *qilér*. Jokli (LKU 95 vv.) nga *kiuer kiori* «dispensa, appartamento per conservare generi commestibili» e Bashkimit, nga *kuhur \*kūr* «qilar për zahire» e geg. lindore, nga geg. *quer* «κατώγειον, κλεπτοδόχος» e Kristoforidhit e nga tosk. *quar* «katua, burg kuajsh», si formë bazë të fjalës nxjerr me të drejtë një *\*klōr*; këtë e afron me fjalën sllave rus. *kletъ* «qilar, bodrum, hambar», bullg. *klet* «kafas, qilar, quar», serbokr. e vj. *klijet* «cellarium, cubiculum», të cilën e afrojnë me lit. *klaimas* «drithnik» e m'anë tjetër dhe me gr. *κλισία* «kasolle, çadër», lat. *clitellae* «samar», irl. *cliath* «crates», got. *bleiPra* «çadër» gjerm. *Leiter* «shkallë» etj. (sh. për këto fjalë sëfundi Vasmer REW I 569 e m'anë tjetër Pokorny I 602). Këtë etimologji e gjen të pasigurtë Walde-Hofmann I 236, e vë në dyshim dhe Pedersen, *Philologica* II 112.

Sikundër shihet dhe nga të dhënat më lart, është fjalë e mbarë gjuhës. Dibra e Madhe i thotë *cūr*, me ndrim të palatalit në afrikatë. Kuptimi «κλεπτοδόχος» që jep Kristoforidhi, është i figurshëm, «jatak, strehë» për një që ndiqet. Për kuptimin e parë do pasur parasysh *kuri* «vend i thelluar në dhe» që ka Puka (B. Palaj), *kori* «çarranik a thark për bulmet, përpara shtëpisë» në Qerret të Pukës, *Koret e Mavriqe* «banesat nëndhese që thuhet se kanë qenë të fisit të shuar të Mavriqet», *Qorri i Begos*, emri i një varri të kohës antike gdhendur brenda në shkëmb (Mokër) e pluralin e singularizuar *qore qorre* f. «gropë a vend i thellë në mal» në Labëri (gropat e natyrshme e të mëdha nëpër male gurore, të cilat gjatë dimrit mbushen me ujë shiu e i shërbejnë bagëtisë si lugje për të pirë ujë në verë»), sh. për të gjitha këto te *qore qorre*. Këto fjalë na japin për *quar quer* një kuptim të mëparmë «thellësi, gropë; vend i thellë i gërmuar»; edhe qilari është një vend i gërmuar në dhe. Në këto rrethana për *quar quer*, *kuri*, *kori* nga një *\*kluor \*kluor \*klori*, jepet një afrim me fjalën keltike irl. e mesme *claidim* «gërmoj», kymr. *claddu* bret. *claza* «me gërmue», irl. e mesme *clad* kymr. *cladd* «hendek», kymr. *clawdd* korn. *claud* «hendek», kymr. *cleddyf* «shpatë» etj. Fjalën keltike e krahasojnë me gr. *κλαδαρός* «i brishtë; i thyer» *κλάδος* «degë», lat. *clades* «lëndim; dëm, mynxyrë, humbje në luftë», got. *halts* «i çalë», sllav. e vj. kishtarë *klada* «tra» etj., sh. Pokorny I 546. Për shq. *\*klor* jepet mundësia e një baze *\*klādr-*, me formant *-ro* si gr. *κλαδαρός*; kjo bazë, me reduktimin e rregullt të grupit *dr* në *r* e me ndrimin *ā: o*, dha *klor* e më tej *\*kluor \*kluar quar quer*. Baza *\*kluar* e paravenduar në këtë mes duket se ruhet te *klúar* «mullëz për të zënë djathë» e shqipes së Greqisë (sh. këtë fjalë).

**Qudohem** «ngul këmbë». Del te Bardhi: *Obstinare Me u qudue, Offirmare Me u quduem, Pertinacia Qūd, Pertinaciter Qudueshim, Pertinax I quduem* (shkruar *qihudueshim, i qihuduem*). G. Meyeri 229 e spiegon nga it. *chiudere* «me mbyllë», dhe këtë spieгим pranon dhe Helbigu 72.

Gazulli jep për Spaç *qud-i* m. «kryeneçesi»: *të madhin qud kishte!, qudi ti!* «i forti kryeneçë je ti!»; e shënon dhe prej Bogdanit, me kuptimin «zakon, doke». Si fjalë e geg. veriore nuk është gjë tjetër veçse *çudë* «çudi», *çudohem*. Në këto dialekte, me ndrimin e shpeshtë të guturalit *q* në prepalatalin *č* e vise-vise edhe në mediopalatalin *ç*, ndodh dhe dukuria e përkundërt, shqiptimi (individual ose lokal) i *ç*-së si *q*. Kalimi kuptimor nga «i çuditshëm» në «kryeneç» kuptohet; i *çuditshëm* përdoret me shumë kuptime, dhe mund të marrë domethënie të veçanta. Edhe Manni (f. 420) me shënimin (*te qud*): «(or *çud?*)» duket se e pa që fjala në thelb është *çudë*.

**qull** m. «miell i zier, i cili, si trashet pak, përvëlohet me gjalpë a me vaj, skrop; një lëng i trashë; lëng i trashë që shërben në gatim gjellësh»; *u bë qull* «u lag shumë, gjer në palcë»; *qull, qullój* «e lag e bëj qull»; *qullem, qullohem* «lagem bëhem qull»; *përqullem* «më mbushet goja me pështymë duke folë»; *qulltohet* «bëhet si qull»; *qullác* m. «lakror me prasë e me ve», si mbiemër «i qullët»; në Pogradec *qullník* m. «lloj pete me vaj e me djathë»; *i qullët* «që është si qull» (për pemë e për njerëz); *qullós* «lag, qulloj», fig. *s'qullose gjë* «s'bëre gjë, s'gatove gjë»; *qullopitë* f. (:*qull-pitë*) «një lloj lakrori; një lloj bukë e hollë» (*qollopitë*). G. Meyeri (f. 228, Alb. Studien III 4,28) sheh këtu refleksin e një baze \**kludlos*, fjalë e afër me gr. *κλύζω* «shplaj», got. *hlūtrs* «i dëlirë». Këtë etimologji e kundërshton Peder-seni (KZ 33,547), me arsyetimin e drejtë që *kl gl* ruhen në shqipen e që *qull* m'anë tjetër është një nga ato fjalë që në asnjë dialekt nuk paraqiten me *kl*-. Poashtu kundra shprehen dhe Boisacq 473, Walde-Pokorny I 496, Walde-Homann I 240. Dhe G. Meyeri vetë më vonë (Alb. Studien V 91) trajtën *qiu* «qull» të shqipes së Greqisë e mendonte të dalë nga lat. *chylus* prej gr. *χυλός* «lëng». Më parë Kamarda (I 69) e afronte *qull*-in me gr. *χυλός*, po pa u shprehur për karakterin e afërisë së tyre, farefisni apo huazim.

Rrjedh nga gr. e vj. *χυλός χύλος*, po nga një dialekt me shqiptim të *v*-së si *u*, pra prej dorishtes ose prej dialekteve greke veriperëndimore; pas gjase prej dorishtes së kolonive të bregdetit shqiptar; sh. Bul. i Univ. Shtet. të Tiranës, Seria Shk. Shoq. 1 (1961) 225, 4 (1962) 130, 132; 145, 147, VII Congr. Internaz. di studi onomastici Firenze-Pisa 250, St. Alb. I 84, 87. Është një nga ato huazime greke të shqipes që dëshmojnë për autoktoninë e Shqiptarëve të pakën që nga epoka antike. — Sh. edhe *qos*.

**qurra qyrra** fpl.; *qurrásh qyrrásh qyrrák, qyrranjós, qyrra-véc*, në Greqi dhe *qurramán; qurrój qyrrój* «bëj me qurra», figurshëm «katranos». G. Meyeri (f. 230, sh. dhe Alb. Studien IV 87, V 91) gjen aty — me dyshim — një huazim nga turq. *kir* «ndyrësi, lerë», nga e cila sipas tij rrjedh me siguri *sqir* m. «lerë, glebë e syve» që jep Rossi. Sh. dhe Tagliavinin 99.

Fjalë e mbarë gjuhës. Forma me *-u-* është e një pjese të mirë të toskërishtes dhe e kolonive të Greqisë e t'Italisë; dhe në Borgo Erizzo të Dalmacisë pas Tagliavinit *çur-i* m. Nga dy variantet e fjalës, kjo

më *-u-* pas gjithë gjendjes duhet të jetë primarja, *qyrra* sekundarja; dhe meqë metafohia *u : y* çfaqet në plural, *qyrra* pas gjase është trajta e pluralit të singularizuar, ashtu si *bërrýl* ndaj *bërrúl*, *gjynj* ndaj *gju* (sh. këto fjalë). *r-*ja e fortë do të rrjedhë nga një geminacion ekspresiv, i kuptueshëm te një fjalë kësodore. Kështu trajta origjinale e fjalës është *qur qurë*. Kjo mund të jetë refleksi i një baze parashqip-tare *\*kr- \*kōr*, me një zhvillim të sonantit *or* (shkalla e reduktuar e *or-it*) në *ur* si te *hurdhë hudhër*; sh. për këtë lloj sonanti Jokl LKU 230 e në Festschr. Kretschmer 1926 f. 78 vv. Si e tillë kjo fjalë e shqipes, si emri i një mase të qullët, mund të jetë e afër me lit. *krenkū krēkti* «mbështillem, piksem», *krekenā* «kulloshtër, toptha qumështi ose gjaku të piksur», *krecumi* «mbeturina, ve bretkosash, papastri, lerë, zgjyrë», *kurkulaī krakulai* «ve bretkosash», rus. *(u)krjuk* «ve bretkosash», serbokr. *o-krijek* «myshk uji, leshterik», gjerm. *Rogen* «ve peshku», kymr. *crogen cragen* «guaskë e gocës së detit» etj. Sh. për këto fjalë Pedersen Kelt. Gram. I 381, Berneker I 613v, Walde-Pokorny I 483, Vasmer I 647v., Fraenkel 293. Turq. *kir*, me gjithë se *ka* hyrë në gjuhët ballkanike, nuk mund të jetë burimi i *qurrë-s*, si për arsye kuptimore si për arsye formale.

*qytét, qutét* m. Nga lat. *civitātem*. Khs. G. Meyer 229, Puşçariu EW 349, Bartoli Das Dalmatische I 269, Skok Časopis Mod. Fil. 1914 f. 403. Vështirësitë që paraqet metafohia *a : e* te *qytét, pushtét, shëndét, vullnét* etj. Meyer-Lübke (Gröbers Grundriss I<sup>2</sup> 1043) përpiket t'i kalojë me hipotezën që sufiksi *-āte* i latinishtes u ndrua në shqipen me një sufiks vendi që përmbante një *-et*. Jokli (IF 36, 148 e 160) e pranon këtë, veçse mendon që ky lloj sufiksi i shqipes që ndikoi më lat. *-āte* është *-esë* nga një *\*-atia*, sufiks që çfaqet krahas me *-ét* në fjalë si *vullnesë vullnét*; te forma më *-e qytete*, ashtu si te *mende, vullnete* etj., ai gjen plurale të singularizuara. Mënfund Ribezzo (Riv. d'Albania II 335 v.) metafoninë te *qytét pushtét* e spiegon nga një *-i* fundore në bazat *ciu(i)tati, potestati* që ai paravendon për latinishten ballkanike. Bariçi (Hymje 64) kthehet te hipoteza e burimit dalmat që pat shtruar dikur Meyer-Lübke (Mitt. d. Rum. Inst. Wien I 31) për metafoninë *a : e* të shqipes.

Historia e kësaj fjale të mbarë gjuhës duhet të rimerret. Përse i përket pikësëpari gjinisë, si e kemi shtjelluar dhe në Li. Posn. VIII 113 vv. e në Revue de Linguistique VII 1 190, *civitātem* bashkë me të tjerat emra femërore latine të lakimit të tretë, në shqipen e vjetër, e për një pjesë të mirë dhe në shqipen e sotme populloren, paraqiten rregullisht si femërore, po me hiferenzë të *-e-së*: Buzuku (XLIV, Mateu 21,10; XLVII, Mbretërit III 17, 10) gjithë *qytetja u ngriti* «commota est universa civitas, e erdh mbë derë të qytetsë» «Cumque venisset ad portam civitatis». Bardhi *Civitas Gjytet, Civis Gjytetës, Urbes Gjytete, e Alta civitas E naltë gjytet*. Bogdani (II 4, 11, I 119,4). *Ngushullime janë thanë për tÿ o Gjytetja e Hyjit* «Gloriosa dicta sunt de te Civitas Dei», assedio la Città di Gierusalemme, li assediati non si assicuravano di giorno». Këto femërore të tipit *qytét qytetja, short shortja*, me fundorin konsonantik të trajtës së pashquar më njerën, me fundorin *-ja* të së shquarës më tjetrën anë, i paraqiteshin ndjenjës gjuhësore si një anomali, gati si nomina ambigena. Prandaj kategoria e tyre me anë të një sinkretizmi u eliminua si *domos* në gjuhën e re të shkrimit, duke shkuar pjesërisht me mash-

kulloret (*qytét qyteti*), pjesërisht me femëroret më -ë e më -e (*qytetë qyteta, shorte shortja*). Prandaj mashk. *qytét-i* nuk është një nominativ i ri nxjerrë nga akuzativi (fem.) *qytetë*. E një fem. *qytete gjytete*, nga sa shikohet, nuk ka; duket të jetë një konstrukcion i gramatikanëve e leksikografëve, ndërtuar llogjikisht pas së shquarës *qytetja*; kjo vlen dhe për *qyteteja e madhe* që përdor Kristoforidhi te Shbulesa (Apokalipsa) 16, 19; 18, 16; 18, 18 e 18, 21. Sa për alternancën *u:y, i-ja* e pathekse e silabes së parë të lat. *civitātem* duhet t'u ketë reduktuar brenda shqipes në -ë-, e kjo t'u ketë zhvilluar në silabë paratheksore në -u-, si shpeshherë. Prandaj *qutét* pas gjase është trajta primare, *qytét* një zhvillim sekundar. Budi e Bardhi e Kuvendi i Arbënit kanë *qytét*; Bogdani (I 101, 19), Grigori (f. 246) e Boçari (f. 85) *qutét*. Prandaj  $\frac{1}{\lambda}$  *utet* e Buzukut si një fjalë e gjuhës letrare transkribohet *qytét*, me gjithë se leximi *qutét* është i mundur. — Përsa i përket mënfund metafonisë, trajtat *Kalaja Kiudatsë* e *Qudát Skanderbegut* me kuptimin «fortesë, kështjellë» (sllav. *gradъ*), *qudát* «lagje» në Mat, që dëshmon Hahni (Reise durch die Gebiete des Drin und Wardar 20, 21, 73, Sagwissenschaftliche Studien 62 shën. 4), na shpion dhe për shqipen te një *\*qutát \*qytát*, e cila shkon me rum. *cetate* e vegliot. *cituot* si vazhdime të lat. ballkanike, me it. *Civitavecchia*, span. *ciudad* etj. Skema prandaj ka qenë *\*qutát \*qytát*: plurali *qutete qytete*, e cila u uniformua në *qytét*, pl. *qytete*. Me fjalë të tjera, *qytét* është një plural i singularizuar. — Në lidhje mënfund me kuptimet e fjalës, deminutivi *qytezë* f., i cili ruhet dhe në emra vendesh — mbledhur në Gasetteer of Albania 140 — bashkë me *Qudat Skanderbegut* që jep Hahni, dëshmon për këtë fjalë dhe një përdorim «fortesë, kështjellë, kala» pranë atij të *qytetit*, e me këtë e afron fjalën dhe semantikisht me rum. *cetate* «kala, kështjellë». — Neologjizma janë *qytetár, -e* (emër e mbiemër), *qytetas* m., *qytetëroj* me emrin *qytetërim* m., kjo dikur *qytetëri* f.

## Résumé

### ÉTUDES D'ETYMOLOGIE ALBANAISE XVII

#### P

për «pour; à cause de; en guise de, au lieu de; au sujet de, concernant, quant à: en, dans l'espace de, dans; par, à» L'idée d'une origine latine a cédé la place à celle du caractère indo-européen de ce mot, gr. περί πέρι «tout autour; par-dessus de; autour de, en vue de; contre, vers», anc. ind. pári «tout autour, autour de, lors de», lat. per, etc., caractère envisagé déjà par F. Bopp. On doit reconnaître pourtant, avec N. Jokl. que dans cette préposition de l'albanais ont conflué plus d'une préposition indo-européenne, notamment pro.

picërr «petit, minuscule», comme nom fém. «petite étincelle.» Pas un emprunt au vénit. pizzolo «petit». Radical d'une extension relati-

vement large, en s'y rattachant entre autres *pic m.* «pointe», *picë f.* «petite fille», *picrrák m.* «salamandre», formes issues d'un *pic-* au sens de «pointe, pointu; point, tache.» Parenté «élémentaire» (au sens de W. Oehl) avec le roman *pits-* de l'it. *pizzo* «pointe, bec, barbe à pointe», *pizzicare* «picoter», engad. *piz pizza* «pointe, cime», etc.

**pikë f.** «goutte (d'un liquide); apoplexie; point», avec *pikój* «dégoutter, tomber goutte à goutte», *stërpik* «asperger», etc., n'est pas du groupe roman de it. *piccare*, esp. *picar*, frç. *piquer*. Appartient plutôt à *pjek* «rencontrer, toucher», en albanais de Grèce aussi «frapper» (à la porte) et «dégoutter, tomber goutte à goutte», comme une forme postverbale en -ë. Dès lors, le roum. *pic* «goutte» provient de l'albanais. Le même vaut pour *pika* «tache» du saracatsan (K. Höeg II 185). L'anc. gr. *πικέριον* «beurre» rappelle le mot albanais.

**pilás-të mpl.** «cils». Ou du néo-gr. *πίλος* «laine battue usitée pour faire des calottes de feutre», ou bien du lat. *pilleum* «bonnet d'homme».

**pilë f.** «deux noix mises l'une sur l'autre; quatre noix dont l'une est placée sur les trois autres», *pilój* «empiler, entasser». De l'it. *pila* «pile». De ce même mot dérive le terme moderne *pilë* «pile électrique».

**pilikuri** «nu». Un composé de *për* et de *lakur* «nu» (H. Pedersen), et plus précisément de *për* et *lëkurë* *likurë* «peau».

**pilivesë f.** «libellule». C'est un composé *pili-vesë*, de *ve* *voe* «oeuf» (Gazulli), en tant que «larve».

**pillë, pille f. I.** «grand récipient rectangulaire de pierre pour l'huile, grande jarre de terre pour l'huile». Plutôt du lat. *pīla* «mortier» que du vénit. *pila* «una specie di vaso in cui si pongono le ulive per infrangerle per cagion di far l'olio». Le mot latin a donné des dénominations de récipients semblables dans les langues romanes et — d'après les données de M. G. Rohlf's — dans les dialectes grecs de l'Italie méridionale.

**pillë f. II.** «outil pour carder le lin, affinoir». Pas un mot des sources indigènes, apparenté au gr. *πέκτω* «je peigne, je tords», lat. *pecto*, -ere «peigner, carder», lit. *pësti* «tirer par les cheveux, tirailleur», mais au fond le même mot que le précédent.

**pillë f. III.** «petite pierre, caillou que jettent les garçons en jouant.» Pour ce mot il faut retourner à l'opinion de G. Meyer, qui le reporte au lat. *pila* «balle, boule». Les difficultés phonétiques ne sont pas insurmontables.

**pingrón**, se dit du chant des oiseaux, du cri (imaginé) des fées, du tintement des oreilles, etc., le nom respectif *pingrím m.* Mot onomatopéique, comme l'a bien remarqué G. Weigand.

**pingúl adv.** «la tête à terre et les pieds en l'air»; verticalement». Un composé *për-ngul*, de *ngul* «mettre, ficher; planter, fourrer; établir, coloniser».

**pip, pipínj, pipëtíj, etc.** (surtout dans des propositions négatives) «faire entendre un faible son». Plutôt que le reflet du lat. *pipire* et *pipilare* «pépier, piauler», ce mot présente une onomatopée, rapprochable comme telle au mot latin, à l'all. *piepen* «piauler, piper, pépier», gr. *πίπος* «oisillon», *πιπιζω* «piailler», etc.

**piri f.** «entonnoir», *piritë e hundës* «les narines». Ou bien du gr.

**πείρια**, ou du vénit. *peiria* même sens.

**pispúth** m., terme injurieux. Un composé *për-spurth*. où *-spurth* appartient, avec *spurdhíq* «gamin, moutard, polisson, à purth «diarrhée» *përpúrth* «salir».

**pjalm** m. «farine fine, fleur de farine», *pjalm bore* «tourbillon de neige», *pjalm lulesh* «pollen». A rapprocher, comme \**pelm*, au lit. *pelenai*, letton *pèln* «cendre» (M. E. Schmidt), mais notamment au lat. *pollen* «fleur de farine; poudre très fine». Le roum. *pielm piemn* «farine de froment qu'on joint à la pâte de maïs» dérive du mot albanais (N. Jokl), mais plus précisément de sa forme dialectale *pjelm* qui a ce même sens spécial.

**pjekë-t** fpl. «les cils». Non pas un mot du groupe de gr. **πέκτω** lat. *pecto* «peigner», anc. ind. *paskšman-* «cils, cheveux». C'est un postverbal en *-ë* de *pjek* «rencontrer, toucher; frapper». Cfr. pour le sens lat. *palpebrae* «paupières»: *palpor*, *-ari* «toucher légèrement de la main, tapoter, caresser, flatter; tâter, palper».

**Pjetër** «Pierre.» En raison surtout de son extension dans tout le territoire de l'albanais, ce nom propre dérivant de l'hagionyme, continue plutôt le lat. *Petrus* que l'it. *Pietro*.

**planós** *planozi* m. «tourterelle, perdrix ou autre oiseau qu'on enferme dans une cage pour attirer le gibier». Probablement du gr. **πλάνος** «trompeur», comme l'avait remarqué K. Kristoforidhi.

Dans **pleq** au sens de «congrès, décision prise dans une assemblée» il ne faut pas supposer une base latine \**placium* pour *placitum* (G. Weigand). C'est simplement le pluriel de *plak* «veillard», employé au sens de gr. **γεροντία** lat. *senatus*. Cfr. aussi *pleqësi* «médiation dans un conflit», *pleqësój* «être un des archontes, avoir de l'influence comme tel, commander dans sa maison» chez Dozon.

**plesht** m. «aisselle» (des brebis), mot local de l'albanais de Sicile. Du bulg. *plešti* pl. «épaule, omoplate» (N. Jokl). Par contre, dans la forme *opangë* de l'albanais de Calabre on a à faire à un serbisme de l'Albanie du nord.

**plish** m. «Phragmites communis, roseau», *plizhgë* f. même sens. Rattaché par N. Jokl à la racine indo-eur. \*(s)phel- «fendre», ce mot peut être le proche parent du lit. *pl(i)ušë plušis* «roseau».

**pluar** m. «soc de la charrue». Ni du sl. *plug* «charrue», ni d'une forme dialectale de l'all. *Pflug*, ni le proche parent de l'anc. ind. *lāvah* «tranchant» *lavah* «morceau» ou du lat. *plovum* «charrue», mais un emprunt au néo-gr. **πλώρη** «proue», mot nautique devenu en albanais terme d'agriculture, tout aussi comme almise. L'emploi maritime survit pourtant encore dans les parlers du littoral: *pluar plori* «proue d'une barque», *era në pluar* «le vent en face».

**podhíq** f. «vieux tablier de laine» et *pëdhite* f. «tablier» sont à rattacher à *podhé* même sens, du néo-gr. **ποδιά**.

**pond** m., *pondë* «largeur d'une pouce», dans Gj. *Buzuku* *një trat o një pont* «iota unum aut unus apex». De l'it. vénit. *ponto*. passé également en grec moderne.

**porropí**, *perupí* f. «contrariété, revers de fortune», se présentant aussi sous la forme de *rupí* au sens de malheur, déclin, ruine», ne provient pas du néo-gr. **ἀπρόπεια** «inconvenance» (A. Xhuvani), mais plutôt du néo-gr. **ροπή** «inclinaison», dans le sens de «déclin».

**posaçë** «à part, séparément», *i posaçëm* «spécial, particulier».

Comme l'a bien vu G. Meyer, mot slave (po se, napose «chacun en particulier»), emprunté au serbo-croate.

**postiqe** f. «peau de chèvre ou de mouton sur laquelle on s'assied», aussi pastiqe, postaqi, etc. Du turc posteki pösteki «pelle de montone su cui si siede», provenant à son tour du persan; post m. même sens, du turc post, ce mot du pers. post «peau». La forme postë «couverture à cheval» du tosque, guègue postahe, pastë, peut être le résultat d'un croisement du mot turc et du sl. postava «doubleure.»

**poshtër** (i) «qui est en bas, inférieur, bas; abject, vilain», poshtë «en bas, de haut en bas», përpósh «en bas», appartient, comme a été établi par H. Pedersen, au groupe de lat. pēs pedis, gr. πούς πο etc., përpósh représentant dans son élément radical un ablatif issu d'un locatif indo-eur. \*pēdsu. D'après une constatation de N. Jokl, à poshtër correspond pështjerë «en bas», variante à accentuation diverse. Toutes les deux formes représentent à notre un ancien comparatif en -tero-, tout aussi comme tjetër «autre».

**potina** fpl. «bottines». Emprunt du frç. bottines. à travers le turc potin.

**pothúaj pothue** «presque», aussi thúase thúese, etc. Mot issu dans la phrase, mot à mot «tu dis (que)», P. Budi (1618) thúose.

**prâj** «infecter», i prâm «infecté», i prâjshëm «contageux». Un composé en pë- të ënj ënjt âj «enfler, gonfler», mot apparenté au lat. aemidus «tumidus, inflatus», gr. οιδάω «je m'enfle, je me gonfle» οίδος «gonflement», arm. aytnum «je m'enfle, je me gonfle», vieux haut all. eiz «abcès, ulcère», etc. Le rapport formel entre prâj et son proche parent end «la mouche crache la viande» est le même que celui de dej «enivrer» à dend dënd «rendre épais; bourrer» et de lej «naître, se lever (du soleil); enfanter, mettre au monde; générer» à lind même sens.

**prandáj prandéj** «à cause de cela, pour cette raison». A côté de ces composés existe depuis P. Bogdani (1685), et encore aujourd'hui dans les dialectes, la forme simple andaj.

**prase** «ça ne fait rien» (réponse de ressentiment). Mot issu d'une phrase, de pra se ... «donc que ...»

**prashtë, prazhdë** f. «fronde». Mot régional, du bulg. prašta praštva, qui a pénétré aussi en roumain.

**pregjím** m. «fête à l'occasion de la naissance d'un enfant». Plutôt que le proche parent du lit. gemù, gimti «naître» (J. Endzelin), ce mot résulte être un emprunt au gr. πρωτογέννημα «première naissance», vestige de la civilisation byzantine dans l'Albanie médiévale. Cependant, une influence de l'alb. përgjím, de përgjój «prêter l'oreille, être aux écoutes», est très probable.

**prehalohem** «maigrir», prehalúc prehalúq prehalúk «maigre (au visage)». De halë «arête, éclat (de bois), écharde, feuille aciculaire, pin», croisé avec prehem «maigrir». Cfr. en outre i hajthëm, i hajmë «maigre», encore un dérivé de halë.

**prehër prëhën** m. «sein, giron», un ancien neutre, forme à suffixe -ënë -ërë, type dimën dimër «hiver», gjarpën gjarpër «serpent». Un rapprochement avec le vieux sl. prega «atteler, tendre» n'est guère probable. Plutôt, comme «part gonflée du corps, gonflement», appartenant à âj ënj ënjt «enfler, gonfler».

**presnik** m. «pain azyme de maïs.» Emprunt régional au bulgare.

**prëcônëzë** f. «bec d'un vase», en albanais de Grèce. Un postverbal de përcój «guider» au sens de «conduire».

**prime** fpl. «remèdes populaires», dont l'application est accompagnée de conjurations et de formules magiques», shkrime e prime «amulettes et sortilèges». Un postverbal de proj prue «protéger (d'une maladie), identique à mbroj «protéger défendre», dans Gj. Buzuku përonj, du lat. parare.

**prish** «gâter, abîmer, ruiner, détruire, dévaster, défaire, gaspiller». Une connexion avec le gr. πρίω «scier; faire grincer» n'est pas soutenable, pas plus que celle avec le got. fraisan «prouver, examiner». C'est un présent issu d'un aoriste, dans ce cas de prisha qui appartient à përs hij «émettre». Le sens abstrait du concret.

**promák** m. «lieu avec des cascades», pl. promiqe-t. Emprunt régional au serbo-cr. promaha «passage, courant».

**prosék** m. «cabane où on tient le bétail; palissade». Plutôt que du bulg. presek (A. M. Selišcev), du serbo-cr. prosek «percée, coupure».

**prozhëm** m. «petit bois, taillis, bocage». Ni du sl. šuma «bois, forêt» (G. Meyer), ni apparenté à ce mot (H. Barić). En raison du vieux toponyme Brostema, emprunt dialectal au slave: serbo-cr. brst «germe, bouton, bourgeon» brstina «feuillage».

**prozhmój** «calomnier, diffamer». Comme l'avait déjà remarqué A. Xhuvani, le même mot que përcmój «ne tenir compte de, mépriser».

**pulláz** m. «toit», pullazinë f. «planchette du toit». Aucun rapport avec lëpozë «plafond» (N. Jokl), mais au fond le même mot que pëllás «palais», du lat. palatium. Le trapas sémantique ne fait pas de difficulté.

**punë** f. «travail, ouvrage, affaire», punój «travailler», punëtôr m. «travailleur. Ni -en tant que le reflet d'un \*spudnā \*pudnā- apparenté au gr. σπεύδω «presser, hâter; rechercher avec empressement; sé hâter; s'efforcer» σπουδή «hâte, empressement; effort; zèle, ardeur; brigue; sérieux, gravité» (opinion, depuis G. Meyer, presque unanime), ni le correspondant albanais de lat. opus (H. Barić). En tant que «pesanteur, fatigue», comme reflet d'un \*pōndā, à rapprocher du lat. pendo «suspendre», d'où «peser; peser de l'argent, payer» et pondus «poids»; ou bien, en tant que \*(s)pōntā, apparenté au gr. πόνος «peine, fatigue, travail fatigant; souffrance physique au morale», en retournant ainsi en un certain sens à l'ancienne opinion de Hahn (I 251), L'actuel -n- de -nn-, et celui-ci d'un groupe -nd-, ou (plus ancien encore) -nt-.

**push** m. «duvet, coton de certains fruits». Ni du groupe de gr. πόνος, «toison (Camarda), ni du turc puş «couvrant, couverte» (G. Meyer). Mot des sources autochtones, provenant d'un \*puks- ou \*pusk- comme forme de base, et comme telle à rapprocher du russe puch «plume légère, duvet, cheveux fins et laineux des animaux», lit. paustis «cheveux des animaux». Une concordance partielle de l'albanais avec les langues slaves et baltiques.

**pushtëj** «occuper, conquérir; embrasser, serrer dans ses bras», pushtim m. «occupation, conquête», i pushtëshëm «omnipotens

**puissant**». Contrairement à l'avis général, ce mot est à séparer de pushtét «puissance» qui remonte au lat. potestātem, et à réunir à pushtró j pështró j «couvrir», qui appartient à shtroj «faire le lit, mettre la table, la servir; préparer les lits». Le passage sémantique est bien fréquent. Une influence de pushtét pourtant dans la modification du sens primitif est bien possible.

**puth** «baiser, embarsser», puthít puthtó j «joindre, emboîter, serrer». Plutôt une onomatopée, comparable au roman (Comelico) bussé, all. Busserl, etc. (C. Tagliavini), qu'un mot apparenté au gr. πυκνός «dru, serré; épais, dense, compact, fréquent; fig. avisé» πύκα adv. «dru, serré», comme retiennent la plupart des savants. A confronter en outre le frç. putu(n) «baiser», basque pot, pers. pus, etc.

**pyés pýes** «interroger, questionner». Ni d'un lat. reconstruit \*petio pour peto «se diriger vers, essayer d'atteindre, gagner; se jeter sur, attaquer; rechercher, solliciter; demander» (G. Meyer et d'autres savants), ni le proche parent du lat. posco «demander» (L. Diefenbach), de l'anc. ind. pra-vēdayami (H. Pedersen), du gr. πυνθάνομαι «s'informer de, apprendre en s'informant» (Camarda, A. Xhuvani) ou du vieux sl. pytaia «scrutari, quaerere» (C. Tagliavini). En raison des variantes pēvés, pves, etc., avec H. Pedersen et G. Weigand il faut reconnaître pēr-ves comme forme de base. En partant de ves, qui subsiste comme tel, on peut envisager dans cette forme un composé v-es à préverbe -v et comparer -es (d'un \*aitiō) au gr. αἰτέω «demander» αἴτης «mendiant».

## Q

**qark m.** «cercle, tour, rond; milieu», adv. «tout autour», prép. «autour de», përqark «tout autour; autour de». Pour des raisons phonétiques, l'étymologie latine, de circus, est insoutenable, l'i latin n'ayant pas abouti en albanais à a (ja), comme c'est le cas de l'e dans certaines conditions. Plutôt apparenté au mot latin et au gr. κίρκος κρίκος «anneau». Forme de base \*ker-k-.

**qê-ni qê-ri, qeth qêth m.** «plateau rond où on planit la pâte; enfourneur». Ni apparenté au turc oklagi du même sens, mot étranger dans cette langue (G. Meyer), ni d'un lat. \*clavānus \*clavaneus supposé, de clava «bâton (nouveaux), massue» (M. Vasmer), Les variantes du mot étant reportables à qen-, cette forme de base peut être le pluriel singularisé d'un \*kan, et comme tel se rapprocher au mot celtique gaul. \*cantos «bandage en fer de la roue, marge, coin», gall. bret. kant «cercle», etc.

**qeft m.** «coupe à boire». L'explication du mot par le gr. κεύθος «lieu caché, caverne, enfers, gorge de montagne», etc. (A. Dozon, Kristoforidhi), est indiscutable. Premier sens «bec» (d'un oiseau, d'un vase).

**qendrat fpl.** «coups de poing, sifflets», dans Gj. Buzuku e por i binjinë (me) qendrat «et colaphis eum ceciderunt», dans P. Budi le verbe qëndrój «frapper, blesser». De même que l'actuel qandërr «pulmonite», du lat. centrum, ce mot même du gr. κέντρον «aiguillon». En italien vernaculaire de Calabre centratu «uomo colpito da sciagura» (G. Rohfs).

**qengj m.** «agneau». Ni d'un lat. supposé \*agnunc(u)lus (S. Bugge), ni d'une variante \*(a)gnunclus \*glunclus \*clunclus (G. Meyer), ni d'une base toujours latine agniculus \*aginculus (P. Skok), ni apparenté à shiléq «agneau de six mois à un an» (H. Barić). En tant que «jeune», peut être rapproché à l'anc. ind. kanīna- «jeune» kanyā «jeune fille», gr. καινός «nouveau, récent; imprévu, étrange», lat. recens «frais, jeune, nouveau», moyen irl. cano cana «louveteau gall. cenau «petit du chien ou du loup», etc. Forme de base \*qenk.

**qerm m.** «limite élevée d'un champ, borne élevée du foyer, bordure élevée d'un puits». Appartient au groupe des mots d'origine incertaine, grecque ancienne: τέρμα «but, extrémité, terme, limite, fin» τέρωω «terme, limite, fin», ou latine: terminus termen «borne, limite, ligne de démarcation; terme, fin, but».

**qerpë çerpë f.** «cheveux, cheveux du front, toupet». Sans étymologie chez G. Meyer p. 224, ce mot résulte être le résultat d'une métathèse de perçe «chevelure longue et flottante des hommes et des femmes», mot turc.

**qesim m.** «forfait». Au fond, du turc kesmek «couper, retrancher» (G. Meyer), mais plus précisément de kesim «coupe, retranchement; forfait».

**qesme f.** «espèce de ciseaux dont se servent les bijoutiers pour tailler l'or et l'argent». Du turc kesme «gros ciseaux; coupé, taillé».

**qeshqék m.** «grain bouilli avec des morceaux de viande dedans». Du turc keşkek même sens, pénétré également en roumain.

**qetë f.** «rocher en pointe; paroi de rocher», fréquent aussi dans la toponymie. Comme l'avait entrevu déjà N. Gazulli, au fond le même mot que qye qeni, m. qye-ja f. «pointe», dont il représente le pluriel singularisé.

**që** 1. pronom relatif, «qui, que»; 2. conjonction, «que, afin que, pour que»; 3. préposition, «depuis», «dès»; 3. avec un nom de nombre, marque de totalité, që të dy «tous les deux». Considéré un emprunt latin par quelques savants (le pronom relatif de qui quem quae ou de quid, la conjonction de quod), ramené par contre par H. Pedersen à un indoeur. \*qid pour \*quid, ce mot se relève être identique à çë,ç «quoi». Dans les parlers de Grèce et d'Italie çë fonctionne en tout comme që en albanais commun. Cfr. pour l'alternance phonétique qish qysh: çish, qoj: çoj. Et pour le sens, l'emploi de lat. quod et quia, le russe čto «quoi» et «que», etc.

**qëllój** «atteindre, toucher, frapper; tirer (des armes)»; impers. qëllon që «il arrive que», en albanais de Calabre Plakut i qëloi gjumë «Al vecchio sopravvenne il sonno»; qëllim m. «but, intention» qëllatë f. «soin, attention». Des étymologies proposées jusque-là, seul le rapprochement avec qell «porter, apporter; retarder» est retenable.

**qore, qorre f.** «grande fosse ou renforcement naturel dans une montagne, qui sert de réservoir d'eau pour le bétail pendant l'été»; mot surtout de la Labëria en Albanie méridionale, mais comme toponyme fréquent dans tout le pays. C'est le pluriel singularisé de quar quer, qori «étable; cellier, cave; garde-manger».

**qos** «être en état d'arriver à bout d'une affaire»; e qose! «tu l'a fait belle!» (sens ironique); s'u qos (gjë) «on n'a fait rien de lui»; en albanais de Sicile qos «enrichir» qosem «s'enrichir», i qozmë «riche», qozmë f. «richesse», en Grèce qomë f. «progrès, réussite» auprès de

plaka e qósurë «la pauvre vieille». Mot commun aux parlars méridionaux et à l'albanais d'Italie et de Grèce. Formation expressive, issue, par un «raccourcissement interne», de qullós «mouiller, humecter» («qull» «bouillie, ragoût, sauce»), employé au sens figuré dans telle expression s'qullose gjë «tu n'a rien conclu», précisément comme s'qose gjë.

**quar quer m.** «étable; cellier, cave, garde-manger», dans F. Blanchus (1635) «promptuarium, dispensa». Reporté à bonne raison par N. Jokl à un \*klōr comme forme de base, a été inclus par ce savant dans le groupe de russe kletъ «chambre aux provisions, magasin, entrepôt, grenier», anc. serbo-cr. klijet «cellarium, cubiculum», lit. klaimas «grange», gr. κλισία «abri pour se coucher; hutte; tente, baraquement, lit», lat. clitellae «bât», irl. clíath «crate, etc. En raison de kuri «excavation sous terre, souterrain» (dans la région de Puka), Kōret e Mavriqe, dénomination de certaines habitations souterraines, actuellement abandonnées, et d'autres données nouvelles, citées ci-dessus sous qore qorre, le sens premier du mot résulte être «enfouissement, fosse; endroit profond, creusé.» Dès lors, quar quer kuri, comme reflet actuel d'un \*kluar \*kluor. \*klori, peut être du groupe celtique de irl. claidim «je creuse» gall. claddu bret. claza «creuser» irl. clad gall. cladd «tranchée», mot qu'on compare aux gr. κλαδαρός «fragile» et κλάδος «branche arrachée, rameau» lat. clades «destruction, désastre, défaite», got. halts «perclus», vieux sl. klada «poutre», etc. Alb. \*klōr- d'un \*klādr-, forme en -ro- comme le. gr. κλαδαρός.

**qudohem** «s'obstiner», dans F. Blanchus i quduem «pertinax». Non pas de l'it. chiudere «fermer», mais au fond le même mot que çudë çudí «étonnement, merveille», çudohem «s'étonner».

**qull m.** «bouillie, ragoût, sauce», aussi «mouillé comme un canard, trempé», qull qullój «mouiller, tremper». De l'anc. gr. χυλός χύλος «suc, jus», mais en raison de la prononciation de l'υ comme u(ou), du dorien des anciennes colonies grecques du littoral albanais, ou bien des dialectes grecs du nord-ouest. A écarter l'idée d'une parenté avec le gr. κλύζω «baigner de ses flots (mer); laver, nettoyer.»

**qurra qyrra fpl.** «morve». Pas un emprunt au turc kir «saleté, ordures, souillure». Mot à gemination expressive de -r-, dont la forme de base est donc qur qurë. Revenant à un \*kr- \*kor-, dont la liquide syllabique a abouti à ur, ce mot peut être apparenté au lit. krenkù krèkti «se coaguler» kurkulai «frai de grenouilles», russe (u)krjak même sens, serbo-cr. okrijek «mousse des eaux, algues», all. Rogen «oeufs de poisson», etc.

**qytét, qutét m.** «ville». Comme on sait, du lat. civitātem. Ancien féminin (qytet-ja), devenu masculin par voie analogique. Par rapport à la voyelle inaccentuée, qutét doit être la forme primaire du mot, dont l'u reflète un ancien ë issu de l'iatone de la première syllabe du mot latin, et qytét représente une évolution ultérieure. Quant à la métaphonie, des données de toponymie comme Qudat Skanderbegut, attestées par Hahn, emmènent à un \*qutát comme forme ancienne du mot. En raison de ces noms et du diminutif qytezë «forteresse» on doit reconnaître enfin que ce nom a désigné aussi une forteresse ou citadelle, comme c'est le cas du roum. cetate.

